


HEJZA



A black and white close-up photograph of a man with long, wavy hair and a beard, wearing dark sunglasses and a dark jacket. He is singing into a silver microphone. The lighting is dramatic, with strong highlights and shadows.

Hektor Gjurgjiali

*Përralla është kënga më e bukur që kam krijuar. Tekstin e këngës e kam shkruar për një kohë të gjatë.
Për katër strofat e fundit më janë dashur 5 muaj kohë që kënga të marrë formën përfundimtare*

VRASËSIT E SHQIPES

Gjuha është një nga komponentët kryesore që e determinon identitetin kombëtar! Gjuha është shkencë formulat e së cilës mësojnë se si të mbushen me ajër mushkëritë e qenies kombëtare. Gjuha e pastër është e vërmja "vaksinë e qenësishme" kundër elementeve kancerogjene në trungun kombëtar. Një shtet dhe një komb i mirëfilltë gjuhën e mbron me ligje dhe me mekanizma adekuate përmbrnjtjen e komponentëve të kombëtarisë. Kombëtarizimi i gjuhës reflekton dinjitet

Nga Avni HALIMI

Nisur nga këto vlerësimet tē pacenueshme që u theksuan në hyrjen e këtij shkrimi, përfaqësuesit shqiptarë që morën pjesë në hartimin e Marrëveshjes së Ohrit, jo vetëm që e mbrojtën gjuhën shqipe por asaj ia siguruan edhe një pozitë të dinjitetshme duke e bindur palën maqedonase që ta pranonjë edhe shqipen dhe alfabetin e saj si gjuhë dhe shkrim zyrtar në tërë shtetin. Më vitin 2002 në pushtet vjen koalicioni LSDM-BDI, liderët e së cilëve gjënë e parë që do ta arrijnë do të jetë parcializimi, deformimi si dhe degradimi i Marrëveshjes së Ohrit. Ali Ahmeti, duke pasur respekt si dhe mirëkuptim përm Branko Cërvenkovskit i cili atëbotë gjendej nën presionin e shërbimeve serbe, hoqi dorë nga shumë pika origjinalë të Marrëveshjes e në të mirë të maqedonizmës dhe të shtetit klasik unitar! Me këtë rast gjuhja shqipe u lejua të flitet vetëm në ato komuna ku shqiptarët përbëjnë njëzet përqindëshin e populatës së përgjithshme lokale. Me këtë rast, pala maqedonas haptazi tregoi një urrejtje ndaj gjuhës shqipe, urrejtje këtë që e zyrtarizozi dhe e normatizoi edhe me ligj në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut të cilin me lezet e votuan që të gjithë deputetët shqiptarët të partisë në pushtet. Pra, partia shqiptare në pushtet nuk zbatoi Marrëveshjen e Ohrit të cilën e garantuani përfaqësuesit e NATO-s dhe të BE-së por zbatoi tek, degradimet, qëndrimet si dhe disponimin e palës maqedonase ndaj gjuhës shqipe.

Po atë kohë nga deputetet shqiptar dikush kumtoi një vendim përm tē punësuar 19 përkthyes shqiptarë që do të merren me përkthim maqedonisht-shqip dhe anasjelltas në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut. I lutti të gjithë shqiptarët që të paraqiten tek ai në zyre e Parlamentit, pavarësisht nëse janë edhe me shkollë të mesme, vetëm tē dijnë që të komunikojnë! Këtu paradoxi zë e lëshon rrëma! Përkthyes me shkollë të mesme! Pavarësisht në e dinë gjuhën shqipe!

Ne të gjithë e flasim shqipen por sa e njohim këtë gjuhë? A e njohim gjuhën e përkthimit dhe cili është ai njohës i shqipes që mendon se di tē përkthejë pa e njohur gjuhën jo vetëm tē përkthimit por edhe tē materies që përkthehet! Përkthyesit profesionistë e dinë fare mire se çka do të thotë gjuhja e materies që përkthehet! Gjuha e përkthimit tē poezisë dallon nga gjuhja e përkthimit tē prozës, e tē mos flasim nga gjuhja e materies së ekonomisë, filozofisë, financave, arkeologjisë, sociologjisë, politikës etj. Nuk është akoma e qartë se cili do të jetë ai kriter sipas tē cilët do tē pranohen përkthyesit shqiptarë në Parlament!

A e njohin shqiptarët shqipen

Ekziston një përshtypje e përgjithshme se shqiptarët janë më tē vetëdijshëm përm sa i përket kësaj zeje!



Nuk i reken me aq lehtësi profesionit të përkthyesit, sepse, ose përm faktin se nuk kanë përvojë profesionale në këtë fushë ose përm faktin se nuk janë njohës tē denjë tē njërsë nga gjuhët nē tē cilën duhet tē përkthejnë. Shqipja është një nga gjuhët më tē vështira nē familjen e saj tē cilën nuk mund ta njohin mirë dhe drejt madje edhe profesorët e sotshëm tē gjuhës shqipe e lëre më studentët apo ata me shkollë tē mesme. Politikanët duhet rreptësish tē përjashtohen nga e drejta përm tē folur nē emrë tē gjuhës shqipe apo përm tē marrë vendime rreth kësaj gjuhe. Pjesa dërmuese e politikanëve tanë, e ministrave, e deputetëve, e funksionarëve, madje, çuditërisht, edhe tē pseudo-analistëve, pseudoshkrimitarëve, pseudo-gazetarëve, tē cilëve përm momentin po ju ecë mirë puna, janë nē nivelin e injorancës nē raport me gjuhën shqipe. Në Maqedoni, përditë e nga pak po vritet gjuhja shqipe, madje, edhe me ligj dhe me vendime zyrtare, natyrisht, si pasojë e injorancës së madhe, si pasojë e mungesës së institutit përm gjuhën shqipe, si pasojë e mungesës së lektorëve profesionistë dhe, si pasojë e lejimit dhe tē publikimit tē materieve pa kurrrarë kontroll gramatikor, pa kurrrarë sintakse dhe pa kurrrarë njohurish me gjuhën e shkruar shqipe.

Kjo injoranacë, madje fatkeqësishet edhe politika shovene e mosdurimit tē shqiptarëve nē administratë, ju ka dhënë tē drejtë shumë maqedonasë që tē mbarojnë fakultetin albanologjik, tē cilët, si dikur kinezët nē Fakultetin e Gjuhës shqipe nē Kosovë, notohen me nota dhjetë. Mbarojnë studimet dhe punësohen si përkthyes, fatkeqësishet nga maqedonishtja nē shqip dhe, përm pasojë kemi doracak përm fëmijë me një shqipe tē bastarduar, përm më keq, kemi edhe udhëzime tē ilaqeve nē tē cilat mund tē gjesh edhe këtë përkthim "dva

tri pati na den" - "dy-tre rrugë nē ditë", nē vend tē "dy-tri herë nē ditë"! Fjalën "pat" ose "put" e përkthejnë nē "rrugë", sepse ky është kuptimi nē gjuhët sllave!

Maqedonasit me tē madhe "po e mësojnë" gjuhën shqipe! Çdo ditë po punësohen si ekspertë tē shqipe, ndërkohë që shqiptarët përfjetojnë orgazëm tek e dëgjojnë një maqedonas se si flet shqip, pavarësish se ajo e folur nē fakt është një atentat klasik mbi gjuhën shqipe! Asnjë vendim, asnjë institucion, apo, më së paku, asnjë iniciativë përm ta mbrojtur gjuhën shqipe nē Maqedoni, ku shqiptarët, përm shkak tē tendencave permanente sllave për asimilim, para se t'i shqiptojnë fjalët janë tē detyryar që së pari tē mendojnë maqedonisht e pastaj tē flasin apo tē shkruanjë shqip. Ndaj dhe kemi një sintaksë hibrilde, tē papranueshme, tē refuzueshme.

Doracak përmbrnjtjen e gjuhës

Nga ana tjetër, ky (anti)standard nuk vlenë përm gjuhën maqedonase! Përveç që përm drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës maqedonase kujdesen institucionet përkatëse shkencore, këtu është edhe ligji! Këtë vit u miratua ligji që e degradoi gjuhën shqipe por u miratua edhe ligji përm gjuhën maqedonase. Me këtë ligj sanszionohen tē gjithë ata që gabimisht e shkruanjë gjuhën maqedonase, sanszionohen tē gjitha ato shtëpi botuese që lejojnë tē bôtohen libra maqedonase pa lekturë, sanszionohen tē gjithë ato redaksi që e shkruanjë apo e flasin gjuhën maqedonase me gabime gramatikore, morfologjike e sintaksore. Përm lektorë nuk mund tē punësohen autodidaktë, lektorë amatorë, apo në variantin më tē mirë, njerëz që kanë kryer letërsinë apo maqedonistikën! Lektorë mund tē punësohen vetëm ata persona që pas studimeve nē fakultetet e gjuhës

maqedonase do ta kalojnë edhe provimin e lektorit i cila mbahet nē Institutin e Gjuhës Maqedonase por që financohet nga Ministria e Kulturës. Përm këtë provim çdo vit kjo Ministri ndanë nga 3 milion denarë (mbi 18 mijë euro) honorarë përm profesorë tē cilët nē çdo afat tē provimeve nuk kalojnë më tepër se një-dy kandidatë, që do tē thotë se kriteri është shumë i rreptë! E çka ndodhë me gjuhën shqipe! Jo që nuk mbrohet tē paktën nga profesorët por as nga mediat e as nga institucionet kombëtare apo shtetërore. Agjensionin përm nepunës shtetërore kishte iniciuar kurs përm tē gjithë nepunësit përm drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e maqedonishtes. Nga viti i ardhshëm duhet që çdo ministri tē punësojë lektorë tē gjuhës maqedonase. Pra, favorizohet një gjuhë hibrilde, një gjuhë që nuk është folur kurrë më parë se 40-50 vjet ndërsa anashkalohet një gjuhë e cila nē grupin e vet familjar tē gjuhëve lirisht mund tē vlerësitet si gjuhë më e vjetra nē rajon, si një trashëgimi kulturore botërore!

Shqipen po e vrasin edhe maqedonasit edhe shqiptarët. Maqedonishten nuk guxojnë ta vrasin! Do tē ndëshkohen tē gjithë ata që nuk do ta shkruanjë mirë maqedonishten! Do tē ndëshkohen sipas ligjit aktual tē cilët i dhanë drithë jeshile edhe deputetë shqiptarë. Jo njëherë maqedonasit, madje që nga premieri e deri te portiri më i thjeshtë tonë se, gjuhja maqedonase është "gjuhë e shenjtë". Sipas kësaj "të shenjtë" do tē anatemohen tē gjithë ata shqiptarë që do tē përdhosin këtë gjuhë! Aty ku nuk kuptohet gjuhja shqipe (edhe nëpër institucion) nuk ka problem nëse nuk përdoret dhe nuk llogaritet si gjuhë zyrtare! Nuk ka ligj që mund t'i sanksionojë, prandaj, shqiptari nëpër ato institucionë shtetërore duhet tē drejtohet vetëm maqedonish!

A JANË TË DOMOSDOSHËM KLUBET DHE SHOQATATE SHKRIMTARËVE?

Askush të mos e konsiderojë klubin si strehë për t'u prehur kryetari dhe kryesia, por si një vend ku të gjithë japid ide dhe gjenerojnë energji pozitive



Agim BAJRAMI

Mbas shembjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, të ashtuquajturat degë të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve, i humbën subvencionet ekonomike dhe benefitet nga shteti, duke humbur kështu edhe peshën dhe rëndësinë e tyre praktike në sytë e krijuesve. Për këtë shkak një pjesë e mirë e krijuesve, nuk u kujtan më për to, duke u mbyllur në vetvete, ndërsa të tjerë nxituan që në vend te tyre të krijonin klubë dhe unionë shkrimtarësh dhe poetësh, pothuajse në çdo qytet të madh.

Por, edhe pse me projekte dhe dëshira të mira, një pjesë e mirë e tyre u shuan pa filluar ende nga puna, një pjesë tjetër vazhdojnë të ekzistojnë sa për inerci, pa bërë gjë prej gjëje, ose shumë shumë, duke organizuar me njëri njëriperiçësi një herë në vit, ndonjë të ashtuquajtur festival poetik rajonal, ku grumbullojnë miq dhe dashamirë të letërsisë, pa ndonjë nivel artistik të dukshëm. Janë aktivitete, të cilët nuk të lënë ndonjë mbresë, por në rrëthanat e krijuara, është e pamundur të bëjnë gjëra më të mira, është argumenti i tyre justifikues. Pa dashur të replikoj me ta, mendoj se justifikime të tilla duhen marrë me rezerva. Unë dhe shumë njerëz si unë, kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se klube të tillë, duhet të shërbenin si një strehë, ku krijuesit të kishin mundësi të takoheshin me miq dhe kolegë të tyre, për të ndarë me njeri tjetrin opinionë dhe vlera krijuese të shpërfaqin pjesë të krimtarisë së tyre, pse jo duke pritur edhe vërejtje dhe sugjerime të singerta, sepse dihet nga të gjithë që gjithkush nga ne, e ka jetike dhe mjaft të nevojshme paraqitjen dhe promovimin e veprës së tij letrare para një auditori sa më serioz dhe profesional. Pavarësisht të metave dhe niveleve të ulëta të analizave letrare,

përsëri auditorë të tillë janë ku e ku më lart se recencat dhe aftësitë e kufizuar letrare të lexuesve të zakonshëm. Dhe për më tepër, një klub shkrimtarësh dhe poetësh, përbën në vetvete një pasuri kulturore për çdo qytet dhe komunitet artistik, si dhe një pikë orientimi për nxënësit e talentuar të shkollave të mesme dhe ato të tetëvjeçare, të cilët i kanë ëndrra takimet me krijuesit. Të gjithë i mbajmë mend nga e shkuara janë se ç'inkurajim na jepet ne fillimet tonë të para, prania dhe fjala e një poeti dhe shkrimtar me vlera. Emrat e dikurshëm të rretheve dhe grupeve letrare, që nxorën disa krijues të spikatur të letrave tona janë të njohur. Por, gjendja në të cilën janë katandisur sot shumica e këtyre klubave letrare që vijojnë ta konsiderojnë veten ende si të tillë, të bën me dhimbje koke. Pa projekte veprimtarish dhe pa ambiente ku mund të mbidhen anëtarët, pa të ardhura ekonomike dhe pa asnjë sponsor, emrat e tyre tashmë të kujtojnë hanet me dy porta, ku mund te hyjë kushdo që ka orekse dhe dëshirë për t'u promovuar, pavarësisht kontributave dhe vlerave letrare të mangëta që zoteron. E rëndësishme është të dijë të gjëjë gjuhën e përbashkët me shefin dhe kryesinë e klubit dhe gjithçka rregullohet.

Sic e kam theksuar edhe në një vëzhgim të mëparshëm, presioni i këtyre njerëzve është kaq i madh dhe këmbëngulës, sa çdo përpjekje për t'i shmangur ata mund të konsiderohet si një mision i pamundur. Ata vijnë në këto klube, jo për të dhënë kontribute (se s'kanë "kontribute" të japid, por për t'i përmbytur ato me lumenin dhe mediokrititetin e tyre. Fodull dhe agresiv herë herë, atyre iu pëlqen vetëm të hapin trastën e mburrjeve personale, duke iu shmangur debatit dhe ballafaqimit me vlerat e vërteta dhe të genësishme letrare. Natyrish që me ta

nëpër këmbë penat e njohura e kanë të vështirë bashkëjetesën dhe janë tërhequr në heshtje, duke iu lënë këtyre të fundit shesh të lirë veprimi. Kjo e ka dëmtuar dhe po vazhdon ta dërmtojë në një masë të madhe klimën letrare në vend, duke sjellë hutim dhe çoroditje. Në klubë të tillë, pa derë dhe dritare, mund të hyjë kushdo që ka dëshirë. Mjafton t'i bëjë një kërkësë me gojë ose shkrim pranë kryetarit të klubit dhe sallën e promovimeve dhe njerëzit i ka gati. Edhe pse shumica e tyre nuk kanë lexuar asnjë rreshth nga vepra e të interesuarit, kjo nuk i prish punë askujt. Autorit jo që jo. Atij i intereson zhurma në publik, ndërsa kryetarit realizimi i një aktiviteti më shumë në planin e veprimitarive të klubit. Sa për dobinë e kësaj veprimitarie, as që e vë njeri ujet në zjarr. E njëjtë gjë ndodh edhe me të ashtuquajturat tubime poetike ose festivalet nëpër rrethe. Shumica e tyre duket se kanë të njëjtën skemë dhe të njëjtën regji. Mediokrit huazojnë nga njëri tjetri skemë te gatshme, ku munong fantazia krijuese dhe risitë. Në to nuk bëhet fjalë për analiza të mirëfillta letrare apo simpoziume për autorë dhe vepra të spikatura. Ose edhe kur është tentuar ndonjëherë, përsëri kanë munguar vështrimet profesionale, aq sa duket sikur pjesa më e madhe e referuesve, sapo i kanë marrë nga rruga dhe i kanë ngjitur si me zor në podium. Edhe në këtë rast të gjithë e kanë në majë të gjuhës justifikimën e mungesës së financave dhe vështirësisë për të gjetur njerëzit e duhur. Po atëherë përsë një pjesë e mirë e drejtuesve të këtyre shoqatave dhe klubave bëjnë gati të pamundurën, për t'i mbajtur në këmbë ato? Ku qëndron interesit dhe vlera e tyre për komunitetin? Përgjigja dihet. Te tendencia e unit. Një pjesë e mirë e drejtuesve të tyre dikur kanë qenë me poste në administratën shtetërore dhe


kanë të pamundur të bëjnë larg podiumeve dhe funksioneve komanduese. Qenia e tyre në krye të këtyre shoqatave ose klubave të letrave, përveçse iu siguron këtë lloj komoditeti krenarie, shërbën për t'i mbajtur ato edhe në lidhje me të shkuarën. Është e sigurt se me këta njerëz dhe logjikë perspektiva e klubave që drejtojnë ata duket e zyrtë. Atëherë si mund t'i shpëtojmë ato nga kjo lloj perspektive? A ka ndonjë ilaç për t'i shëruar? Unë mendoj që ka një zgjidhje dhe klubet e letrave nuk duhet lënë që të mbyllen. Pavarësisht kushteve dhe indiferencë skandalozë të shtetit dhe shoqërisë shqiptare ndaj tyre, pavarësisht faktit që krijuesi është një genie e mbyllur dhe krijimi është një akt më tepër individual, gjëja e parë që duhet bërë në këtë rast, është ndryshimi i mentalitetit dhe koncepteve për vënien në eficencë dhe funksionimin sa më mirë të tyre.

Askush të mos e konsiderojë klubin si strehë për t'u prehur kryetari dhe kryesia, por si një vend ku të gjithë japid ide dhe gjenerojnë energji pozitive. Ndryshtimi duhet të nisë edhe me vendosjen në krye, jo të miqve dhe shokëve, por të personaliteteve dhe njerëzve me kulturë dhe vlera të mirëfillta letrare, të atyre që gjëzojnë respektin dhe simpatinë e të gjithëve, pa prirje bajraktarizmi dhe egoizmi të sëmurë provincial. Ata që duhet të marrin përsipë mbarëvajtjen e klubave të tillë duhet të janë të tillë, që të jetojnë me anëtarësinë dhe problematikat e saj, që kanë përvojë dhe fantazi krijuese dhe që aplikojnë në një masë të madhe punën në grup. Shembujt e mirë të Klubit të shkrimtarëve dhe poetëve "Begir Musliu" në Gjilan, Klubit të shkrimtarëve dhe poetëve në Kërcovë, atij të Tetovës, Prizrenit, Klubit të shkrimtarëve dhe poetëve Jonianë në Sarandë dhe atë të shkrimtarëve dhe poetëve "Bota e re, në Korçë, në kohë kur atë e drejtonte poeti i shquar Skënder Rusi, Klubi "Petro Marko" në Vlorë etj. janë sinjifikativë. Mjafton të kthejnë kokën dhe t'i shohin. Ajo që bie në sy tek ta është serioziteti i punës dhe numri i shumrave të veprimitarive letrare artistike të shtrira në kohë dhe hapësirë, aftësia publike nëpërrimjet revistave "Agrmia", "Antologjia e poezisë joniane", "Netët poetike korçare. Karakteristikë e klubave të porsapërmendorë është uniteti, pasioni, fryma e seriozitetit dhe këmbëngulja për t'i çuar punët e tyre krijuese gjér në fund. Kjo ka sjellë që veprimitaritë e tyre të janë të larmishme, interesante dhe me vlerë për komunitetet e krijuesve respektive. Është kjo arsyaja që organet e pushtetit lokal dhe ato qendor, hera herës janë treguar mirëkuptues dhe të gatshëm për t'u ndenjur pranë dhe sponsorizuar. Prania ime e disahershme në këto aktivitete dhe impresionet pozitive që kam përfshuar, më bëjnë të replikoj me të gjithë ata, që nuk besojnë më te efikasiteti i këtyre organizimeve dhe vijojnë t'i shohin me indiferentizëm dhe përbuzje me pa të drejtë.

Hektor Gjurgjiali, udhëheqës i rok grupit 403

MUZIKA, GJUHË UNIVERSALE

Përralla është kënga më e bukur që kam krijuar. Tekstin e këngës e kam shkruar për një kohë të gjatë. Për katër strofat e fundit më janë dashur 5 muaj kohë që kënga të marrë formën përfundimtare



Intervistoi: Zyrafete SHALA

Hektor Gjurgjiali është padyshim një nga kontribuuesit më të shquar të zhvillimit të rok muzikës në Kosovë. Ishte një nga themeluesit e rok grupit të famshëm 403, këngët e së cilës edhe pas më shumë se 40 viteve vazhdojnë të dëgjohen me ëndje të madhe. Hektori është arkitekti i suksesshëm dhe jeton herë në Tirana e herë në Prishtinë, ku siç thotë ai, ndjehet si në shtëpi. Me Hektori bisedojmë për disa çështje, të cilat gjithsesi do të zgjojnë kureshtjen e lexuesve të revistës Hejza.

HEJZA: I nderuar! Hektor, çka është muzika për Ju ose cili është përkufizimi Juaj për muzikën, përkëtë dimension magjik në jetën e njeriut?

H. GJURGJIALI: Muzika për mua është gjuhë universale, me të cilën mund të komunikoni me çdo qenie të gjallë. Mund të komunikoni jo vetëm me një person tjetër, i cili flet gjuhë të huaj, por edhe me kafshë.

HEJZA: 403 padyshim se ka hyrë në historinë e rok muzikës shqiptare si një grup, i cili që në fillimet e

tij dëshmoi se rokut shqiptar po i shtohej edhe një prurje interesante. Cilat ishin veçoritë e 403-sht?

H. GJURGJIALI: Në fillesat e grupit 403, të gjithë ne anëtarët ishim të rinj dhe studentë. Dëgjonim muzikë të huaj të mirë dhe ishim muzikantë të mirë. Ndoshta veçoria kryesore e jona ishte se u kemi ikur stereotipave të asaj kohe, ku muzika ishte pak a shumë shablon akordesh të njëjtë dhe tekstet flitnin për bukurinë e vajzës "si pranvera" apo "për lotët qe bien si shi". Në grup ishim pesë anëtarë: dy kitaristë (nuk di nëse ndonjë grup tjetër i ka pasur dy në atë kohë), basistin, klaviaturistin, tupanët, plus harmonikën e gojës [blues] që deri në atë kohë nuk e ka përdorur asnjë grup. Në mbrëmjet muzikore që mbaheshin na atë kohë, këndonim të gjithë anëtarët e grupit (pos daullistik). Pra, i kishim katër këngëtarë ku çdonjéri e këndonte ndonjë nga këngët e huaja që i kishim në repertor. Veçori tjetër është edhe fakti se të gjithë anëtarët e grupit kemi qenë ose familjarë ose shokë shumë të ngushtë, që nga fëmijëria apo nga shkolla e mesme, prandaj shumë kohë kalonim bashkë, mirë koordinoheshim dhe merreshim vesh për secilin detaj.

HEJZA: Nga perspektiva e sotme, si e vlerësoni rok muzikën shqiptare, kuptohet në hapësirat shqiptare të ish Jugosllavisë, sidomos të viteve 80-ta të shekullit të kaluar kur u ndje një shpërthim i fuqishëm i kësaj muzike?

H. GJURGJIALI: Mendoj se në vitet e '80-ta të shekullit të kaluar, në Kosovë ka pasur vërtet rok muzikë, instrumentistë të mirë të rokut dhe rok grupe më të sinqerta. Shumë i dua dhe i respektoj grupet e reja në Kosovë, por shumë më lehtë është sot për ta të bëhet muzikë "alternative", ku kryesisht dominon kitara e zhurmshme dhe me distorsion ekstrem, tupanët me ritëm të njëjtë tërë kohën apo këndimi me bërtitje ku distonimi vlerësohet si gjë interesante. Dikur, nëse nuk ke qenë instrumentist apo këngëtar i mirë dhe i saktë, nuk ke mundur të mbijetosh në rok skenën kosovare. Por, më duhet të ritheksoj se vërtet jam i kënaqur që rok muzika ka marrë një hov të ri me grupet e reja, për të cilat kam respekt maksimal dhe që gjithnjë i mbështes.

HEJZA: Ju realizuat shumë këngë që ndër vite mbijetuan dhe, edhe sot e kësaj dite, akoma dëgjohen dhe

përjetohen si këngë që me sukses e sfidojnë harresën. Ku qëndron magjia e këtyre këngëve që dëgjohen edhe pas pothuaj katër dekadave?

H. GJURGJIALI: Vërtet nuk e di. Këngët e mia nuk janë të ashtuquajtura hite të verës që dëgjohen për tre muaj rrësht - në plazhe dhe në diskoteka - e pastaj nuk i mban mend vitin tjetër. E di se tekstet në këngët e mia nuk i referohen ndonjë ngjarjeje apo kohe specifike, si dhe muzika origjinale dhe orkestrimet janë bërë më përpikëri të madhe. Këngët e mia dëgjohen nga 10-15 herë në ditë. Ato dëgjohen ndoshta një apo dy herë në javë apo në muaj.

HEJZA: Kënga Juaj "Përralla" padyshim se është këngë antologjike. Si lindi kjo këngë kaq e mrekulueshme?

H. GJURGJIALI: Përralla është kënga më e bukur që kam krijuar. Tekstin e këngës e kam shkruar për një kohë të gjatë. E mbaj mend se gjatë incizimit të albumit në vitin 2002, kjo këngë është incizuar e fundit, sepse për katër rrështa të fundit të tekstit - që nuk më pëlqenin siç ishin - më janë dashtë diku rrëth katër apo pesë muaj kohë ta përfun-



doj ashtu siç është sot. Është e veçantë, sepse është vërtet një përrallë, me një fund shumë të bukur që tregon marrëdhënien mes babait dhe djalit.

HEJZA: Dhe një ditë Ju vendosët të jetoni në Tiranë. Çfarë Ju shtyri të vendoseni në kryeqendrën e Shqipërisë?

H. GJURGJIALI: Për momentin unë jetoj edhe në Prishtinë edhe në Tiranë, dhe në të dy qytetet ndihem si në shtëpi. Ndoshta pas një apo dy vitesh mund të vendosi të jetoj tërë kohën në Tiranë, sepse është kryeqytet i vërtetë në krahasin me Prishtinën, ka klimë shumë më të mirë se Prishtina dhe ka shumë më shume aktivitete të mëdha kulturore - si teatër, opera, koncerte të mëdha, evenimente etj. Mos të harrojmë se edhe deti është vetëm 20 minuta larg, por edhe nga Prishtina pak më shumë se tri orë. Pra, mund të jem edhe këtu - edhe atje.

HEJZA: Cila është lidhshmëria mes muzikës dhe arkitekturës?

H. GJURGJIALI: Muzika edhe arkitektura janë arte që ndërthuren me njëra-tjetrën. Një këngë dhe një projekt arkitekturor - ndërtesë apo diçka tjetër - kanë të njëjtat elemente. E kanë idenë, kompozicionin, harmoninë, bukurinë dhe realizimin final. Gjatë kohës që projektoj, tërë kohën dëgjoj muzikë e cila më frysmezon për punët krijuese. Njëjtë edhe kur shoh ndonjë objekt të duhur, kudo, në mendje më vjen ndonjë melodi apo këngë e bukur që ma

pasqyron ndjesinë e atij objekti.

HEJZA: Natyrisht, teksti është një nga segmentet kryesore të çdo këngë. Fatkeqësish, sot këtij segmenti fare pak i kushtohet rëndësi, ndaj gjithandej në skenën muzikore shqiptare, kur bëhet fjalë për tekstin, kemi një çoroditje ekstreme. Cili është vlerësimi Juaj?

H. GJURGJIALI: Për mua, teksti i një këngë ka shumë rëndësi. Teksti duhet të ketë tregim apo një mesazh që vlen të dëgjohet edhe nga të tjerët. Teksti duhet të jetë i qartë, i kënduar qartë dhe me diksion të saktë. Ka mjaft këngë me tekste të bukura edhe sot, por, fatkeqësish, shumë më shumë ka tekste të cilat nuk kanë asnjë kuptim. Më shumë më duket se janë tekste të shkruara brenda ditës, të porositura dhe të blera si në tregun e perimeve. Shumë melodi dhe këngë "moderne" që janë në tregun shqiptar, më mirë do të tingëllonin po të ishin vetëm instrumentale.

HEJZA: Ku janë dhe çfarë bëjnë ish anëtarët e grupit 403?

H. GJURGJIALI: Nga anëtarët e formacionit të parë të grupit 403 (pra nga viti 1982 deri 1986-87), disa janë jashtë vendit dhe disa në Prishtinë.

Arben Godanca - kitaristi i grupit - jeton dhe punon në Prishtine si inxhinier i elektros. Nuk ka performuar me grupin 403 që nga viti 2002. Shpresoj që do ta bindim që përsëri të kapë kitarën dhe të tregojë se është ndër kitaristët më kreativ në Kosovë.

Veton Orana - klaviaturisti i grupit - jeton jashtë Kosove. Momentalisht

ne Turqi (diku në kufi me Sirinë), ku punon si përfaqësues i lartë i UNHCR-it.

Mentor Gjurgjiali - basisti - jeton në Çikago dhe punon si teknik i zërit.

Fatmir Zajmi - daullisti - jeton dhe punon në SHBA.

HEJZA: Ju vazhdoni të bëni muzikë. Jeni nëpër koncerте. Muzika Juaj vazhdon të përçojë emocione, përkatesisht të plotësojë një hapësirë boshe që u krijua me paraqitjen e rrjave të ndryshme muzikore, muzikë e cila shumë shpejtë populizohet, por edhe më shpejtë harrohet. Aktualisht, ku qëndron rok muzika shqiptare?

H. GJURGJIALI: Rok muzika shqiptare në Kosovë, gjithnjë ka qenë dhe akoma është shumë më përparrë se ajo në Shqipëri. Më vjen mirë se në Kosovë është trendi i rritjes së grupeve rok. Në shumë qytete të Kosovës, e posaçërisht në Prishtine, kanë dalë shumë grupe të reja që jo vetëm janë instrumentiste shumë të mirë dhe njohës të rokut, por edhe kanë ide dhe krijime shumë të bukura.

HEJZA: Si ka ndryshuar skena muzikore që nga fillimi i karrierës suaj deri më sot?

H. GJURGJIALI: Ka ndryshuar shumë. Teknologjia moderne, posaçërisht interneti, ka mundësuar që tanë të bëhet rok muzikë në nivel shumë më të lartë. Në fillimet e karrierës time ka qenë vetëm një studio, në Radio Prishtinë, ku janë bërë incizimet e këngëve, ndërsa tanë teknologjia ka bërë që pothuajse çdo instrumentist të ketë studio personale në shtëpi, në një laptop. Dikur në Prishtinë kanë qenë gjithsej ndoshta 5-6 kitara elektrike, 2-3 bas-kitara, 1-2 klaviatura dhe 2-3 tupana. Këto instrumente të njëjta qarkullonin mes shumë grupeve të asaj kohe, në shumë incizime apo performance live që mbaheshin, sepse në atë kohë ka qenë pothuajse e pamundur të blihet dhe të sillet nga jashtë një instrument profesional. Sot teknologjia dhe interneti ta afrojnë mundësinë që nga shtëpia të blesh online jo vetëm pajisjet dhe instrumentet më profesionale të kohës, por edhe të shohësh dhe mësosh në

video-platformat se si bëhet muzika e mirë rok. E gjithë kjo ka bërë që skena muzikore sot të jetë më profesionale, më moderne dhe më e avancuar.

HEJZA: Cilat janë këngët tuaja më të dashura që keni shkruar dhe pse i konsideroni të tillë?

H. GJURGJIALI: Grupi 403 i ka incizuar gjithsej 18 këngë - për 41 vjet. Asnjëherë nuk kam qenë i dhënë pas asaj që të krijoj sa më shumë, por sa më bukur dhe sa më mirë. Të gjitha këngët e mia i çmoj pothuaj njëjtë. Disa dikur kanë qenë mega-hite qysh para 40 vjetëve ("Indeksi", "Paraja", "A do të kthehet", "Me ty ..."), ndërsa disa nuk janë hite as tash, por dëgjohen shumë nga të gjitha moshat. Më të dashurat për mua janë: "Përralla", "Përralla e fundit", "Engjëjt nuk jetojnë në tokë", "Ëndrra", "Akoma po të pres", "Qyteti im" ... Këto me duken më të veçanta, ndoshta sepse kanë tekste më të veçanta.

HEJZA: Si ndjeheni kur dëgjoni që muzika juaj ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në jetën e njerëzve?

H. GJURGJIALI: Ndihem shumë mirë kur më takojnë njerëzit e gjeneratave të ndryshme dhe më thonë se kjo apo ajo këngë e imja u ka dhënë diçka të bukur në jetë.

HEJZA: Cili është kujtimi më i bukur që keni nga karriera juaj muzikore?

H. GJURGJIALI: Kujtimi më i bukur që kam është nga viti 1984. Grupi 403 ishte përfaqësuesi i parë i rok muzikës së Kosovës në Festivalin e Opatisë, ku merrnin pjesë shumë grupe të njohura nga e gjithë ish-Jugosllavia. Prova e parë e të gjitha bendeve ishte ta interpretojmë një "cover" (një këngë të huaj - jo këngë origjinale) në mënyrë që inxhinieri i zërit ta bënte rregullimin e miksimit dhe të ngjyrosjes së tingullit. E zgjodhëm një këngë blues, ku pos instrumenteve kishim edhe blues-harmonikën. Në përfundim të provave, anëtarët e bendeve të tjera (Crvena Jabuka, Zabranjeno Pushenje, Kerber etj.) ishin tepër të habitur me performancën tonë dhe së bashku shkuam në një lokal afér. Në pyetjet e tyre se nga cili vend dhe nga cili qytetet jemi, u përgjigjëm se jemi shqiptarë dhe se vijnë nga Prishtina e Kosovës. Aty plasi një qeshur nga ta, sepse shkaku i paragjykimeve, mendonin që ne po tallemi. Por, me insistimin e tyre që vërtet të dinë se nga jemi, në fund ua treguan edhe letërnjoftimet, gjë që i la vërtet tepër të habitur se si një grup shqiptarësh nga Kosova bën muzikë të huaj në nivel aq profesional. Është kujtim i bukur për mua, sepse ditët në vazdim i kaluam mjaft mirë dhe mendoj se thyem një tabu të asaj kohe që të tjerët kishin për njerëzit në Kosovë.

HEJZA: Çka ju mori dhe çka ju dha muzika?

H. GJURGJIALI: Muzika nuk më ka marrë asnjë. Përkundrazi, muzika më ka dhënë shumë kënaqësi, gjëzime dhe momentet më të bukura.

Foto: Besnik Hamiti


KËNGËT E PAKËNDUARA TË XHEVDET BAJRAJT

(Mbi vëllimin me poezi Angelus Novus botuar nga "De Rada", 2023)

Zyrafete SHALA

Ndryshe nga vëllimet e tjera poetike të Xhevdet Bajrajt, vëllimi Angelus Novus është pagëzuar para se të merrte formën finale, madje edhe para se të përzgjidheshin poezitë që do të përfshiheshin brenda tij. Megjë kishim disa vjet që bashkëpunonim, e kishim krijuar një sistem të detajuar të punës që e ndiqnim me përpikëri, dhe sipas tij, titulli i librit zakonishi lindte pas përfundimit të të gjitha fazave. Mirëpo, edhe pse i pazakontë ky veprim atëbotë nuk më bëri shumë përshtypje sa më bëri vetë kuptimi i titullit: Angelus Novus (engjelli i ri) sipas traditës hebraike, është një krijesë qellore e krijuar vetëm për të kenduar një këngë të përjetshme përparrë Zotit. Një legjendë talmudike thotë se në çdo moment, një legjon engjësh të rinj krijuhen që, pasi të këndojnë himnin e tyre para Zotit, të përfundojnë dhe të treten në hiç. Pas largimit të Xhevdetit nga kjo botë ky titulli i librit mori përmasa të reja, që krijuon përshtypjen se edhe vetë poeti u bë pjesë e atij legjioni të engjëve që pasi përbushi misionin e ekzistencës së tij u tret, iku në amshim. Megjithatë, ndryshe nga engjëjt, ai krahas shumë vëllimeve poetike të botuara më parë, la edhe këngë të pakënduara, disa prej të cilave zunë vend në këtë vëllim e të tjerat do të janë pjesë e ndonjë libri tjetër. Angelus Novus është libri të cilin Xhevdet Bajraj sapo kishte filluar ta bëj gati përshtyp dhe shpresonte që të dilte nga shtypi në kohën kur ai do të vinte në Kosovë për pushime. Mirëpo, pas shfaqjes së shenjave të para të sëmundjes së tij gjithçka mori kah tjetër. Përkundër dëshirës dhe këmbënguljes që të vazhdonte me radhitjen e përgjedjen e poezeve, libri mbeti i papërfunduar dhe të tillë ma përcollë pak ditë para se të largohej nga kjo botë. Prej atëherë, u kthehesha kohë pas kohë poezeve të dërguara dhe sado që e ndjeja vazhdimisht peshën e porosisë së papërbushur, e kisha të vështirë, në kufij të së pamundurës, të krijoja atmosferën të punës. E njihja mirë metodën e tij të punës në organizimin e poezeve, kriteret rigorozë të përgjedhjes së fjalëve dhe thyerjes së vargjeve, prandaj u desh kohë që të bindem se librin mund ta finalizohet.

Poezitë e vëllimit Angelus Novus janë të ndara në pesë cikle, Stina e ftohtë e jetës, Lulet kishin provuar të çelin, Në fushën e ëndrrave, Kujtimet në tokat e shkreta dhe Ka mbetur edhe pak diell, mirëpo nuk është kjo një ndarje klasike sipas temës që trajtojnë. Në secilin cikël gjenden poezi me motive të ndryshme nga njëra-tjetra, ashtu siç është edhe vetë jeta, një mozaik përjetimesh, situashë e ngjyrash që na i mbushin ditët. Poezitë e këtij vëllimi kanë lindur në harkun kohor 2020-2022 dhe si të tilla, pjesa dërmuese janë vazdimësi e preokupimeve dhe dhimbjeve të mëhershme të poetit; ndërkokë që vetëm një numër i vogël i tyre trajtojnë shqetësimet e ditëve të fundit të tij. Për nga lëndë që trajtojnë këto poezi janë heterogjene dhe i sjellin edhe njëherë të përbledhura motivet mbi të cilat u vunë themelët e kriminarisë së Bajrajt dhe që në të njëjtën kohë ishin dhimbja e tij. Gjëmë këtu dashurinë dhe mallin përvendindjen si lajmëmotiv që rimerret në secilin vëllim poetik dhe që merr ngjyrime të reja emotive krahas kalimit të kohës; pastaj zhënjimin me realitetin aktual shqiptar, qoftë nga paaftësia e zënies së hapit



daj në një poezi tjetër shton se: Të gjithë kemi vdekur / në atë pranverë të luftës / (edhe ne që mbetëm gjallë). Nuk mungon as shpërfaqja e paradokseve të realitetit tonë: Në këtë vend të bukur / gjithçka është kthyer përbys / qytetarët normalë trajtohen si kriminelë / kriminelët trajtohen si zotërinj / apo edhe si heron / vrashësit si viktima / e viktimat si fajtorë, prandaj vjen në përfundim se: përlirinë njeriu duhet të jetë akoma më i fortë / se sa për okupimin. Doemos, objektiviteti të Bajrajt nuk i shpëton as dukuria e metamorfozave që e karakterizon kohën e zvarranikëve: Ndonjëherë / jeta di të jetë e pamëshirshme / qengjat e bardhë i shndërroi në desh të zi / në politikanë / e këta pastaj / ulur mbi varret e të rënëve përliri / i hëngrën ditëtona / si të ishin / fara të pjekura kungulli.

"Nëse mendon që je në gjendje të jetosh pa shkruar, mos shkruaj" thotë poeti austriak Rainer Maria Rilke, që njëkohësisht konsiderohet si një nga lirikët më të shquar gjerman; që do të thotë se procesi i të shkruarit mund të arrijë nivelet më të larta estetike kur është ekuivalent me nevojën për të jetuar. Nëse këtë thënie do ta adaptojmë në rastin e poetit Bajraji, atëherë do të mund të themi pa hezitim se deri në fund të jetës përlirët Bajrajan poezia ishte e vërtëna formë konkrete e ekzistencës, e domosdoshme për t'u përballur me ashperinë e jetës, përlirët ta nxjerr zérin e protestës, përlirët ta artikular pakënaqësinë dhe përlirët klithur. Vetëm gjatë procesit të krijimit ai arrinte të gjente daljen nga ai labirint vuajtjesh ku e degdisin dëshpërimet e jetës dhe (sic deklarohej shpesh) turpi i të qenit njeri. Duke frymuar pareshtur me jetën dhe ndodhitë e botës shqiptare poezia e Bajrajt është një pasqyrë ku ne mund ta shohim fytyrën reale të shoqërisë sonë, por padyshim është edhe testament, nga i cili ato që vijnë pas nesh do të mësojnë se si nuk duhet jetuar, apo se sa i padushëm është kufiri mes njerëzores dhe çnjerëzores.

EDHE NJË VËLLIM POETIK I XHEVDET BAJRAJT

Klubi letrar "De Rada" ka botuar vëllimi poetik "Angelus Novus" të Xhevdet Bajrajt, vëllimi i fundit që poeti la në dorëshkrim para se të largohej nga kjo botë më 22 qershor të vitit të kaluar. Poezitë e këtij vëllimi shfaqen si vazdimësi e preokupimeve të mëhershme të Bajrajt, kryesisht prokupimi me fatin e atdheut dhe brishtësia e lirisë së tij. Libri ka mbi njëqind poezi dhe është i ndarë në pesë cikle. Parathënia "Këngët e pakënduara të Xhevdet Bajrajt" është shkruar nga redaktori Zyrafete Shala, nën përkujdesjen e së cilës u përgatit libri përshtyp, ndërsa recensenti Agron Shala ka përgatitur pasthënien "Nga të huajt i nderau dhe nga të huajt i vajtar". Recensente e dytë e librit është Nafije Zogaj. Kopertinat dhe faqosja janë punuar nga Jeta Rexhepi dhe Drian Shala, ndërsa portreti i autorit nga piktori Florent Pista.

XHEVDET BAJRAJ

Ai përgjithmonë do të jetë prezent midis nesh, sepse të pavdekshëm e bëjnë veprat e tij brilante, ndër më të mirat në letërsinë shqipe

Xhevdet Bajraj, një nga poetët tanë më të shquar, u lind në Panorc të Malishevës në vitin 1960. Pas shkollës fillore dhe të mesme studioi për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës. Deri në vitin 1999 jetoi në Rahovec, ndërsa pasi ia ofruan bursën e Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimitarëve, shkoi në Meksikë, ku jetoi dhe veproi deri në fund të jetës së tij. Xhevdet Bajraj ishte profesor në Akademinë e Krijimtarisë Letrare në Universitat Autònoma de la Ciudad de México (UACM) në Meksiko Siti. Është marrë edhe me përkthime, nga gjuha spanjolle në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Veprat e Xhevdet Bajrajt janë përkthyer në disa gjuhë dhe gjithashtu janë shpërblyer me çmime të ndryshme. Poezia e tij është përfshirë nëpër antologji të ndryshme në gjuhë të huaja.

Është bashkë-protagonist në filmin Aro Tolbukhin - Në mendjen e vrasësit (Aro Tolbukhin - En la mente del asesino), të regjisitorit spanjoll Agustín Villaronga, film ky që ka genë fitues i disa çmimeve ndërkombëtare. Po ashtu e ka një regjistrim në CD të poeziave të tij me rock grupin Heshtjet e pakëndshme (Silencios incómodos), Grabaxiones Alicia, 2006.

Në vitet 2016-2019 mori bursë nga Sistemi Kombëtar i Krijimtarisë Artistike (mekzikane), SNCA.

Sëmundja e rëndë e gjeti në vrullin e krijimtarisë poetike, në kulmin e karierës dhe përsosmërisë së profilit krijues. Më 22 qershor 2022 ndëroi jetë në Meksiko Siti, pa arritur të kthehet në vendindje, ashtu siç ishin planet e tij. Megjithatë, ai përgjithmonë do të jetë prezent midis nesh, sepse të pavdekshëm e bëjnë veprat e tij brilante, ndër më të mirat në letërsinë shqipe.

VEPRAT E BOTUARA NË GJUHËN SHQIPE

Nënë prej guri (1988), Emblema e vdekjes (1993), Copë e humbur e parajsës (1996), Liria e tmerrit (2000), Kur engjëjt qajnë (2002), Blues në qiellin indian (2003), Dritë e zezë (2004), Shpuplimi i shqiponjës (2007), Vrasja e mushkonjës (2011), e ribotuar si libër i veçantë në vitin 2020, Copa ime e qiellit (2015), Lëngu i trëndafilave (2017), Vitet që nuk e sollën pranverën (2018), Kur qajnë hardhitë (2019), Ca kokrra rrush të Rahovëcit (2019), Kafe me nënën (2020), Me zemër në qese najloni (2020), Burri që lozta me engjëj (2021), Unaza e Saturnit (2022) Angelus Novus (2023).

VEPRAT E BOTUARA NË GJUHË TË HUAJA

Ruegoalbanés (Lutje shqiptare), Ramón Sánchez Lizarralde, México D. F. Editorial Ácrono y Casa Refugio Citlaltépetl (2000), Sloboda užasa (Liria e tmerrit), Botuesi Rende, Beograd (2000), Eltamaño del dolor (Përmasa e dhembjes), México, D. F. Editorial ERA, CONACULTA y UACM (2005), Temporada de las flores tristes - Tezcatlipoca blues (Stina e luleve të mërzitura -Tezcatlipoca blues), Asociación de Escritores Mexicanos (Shoqata e Shkrimitarëve meksikan), Secretaría de Cultura de la Ciudad de México, Sekretariati për Kulturë i Meksiko Siti, La Pirámide, Géiser y Toshka dhe Generación Espontánea, Meksiko Siti (2010), Lascenizas de una flor (Hiri i një lule), México, D.F. Ediciones Botas, México, D.F. (2013), Anatomía de una pesadilla, (Anatomía e një ankthi), Guayaquil, Ecuador, El Quirofano Ediciones(2013), Canto 3 (Canto 3), México, D.F. Ediciones Botas (2014), Ubistvo jednog komarca (Vrasja e mushkonjës), LINKS, Edicija internacionala, Beograd (2014), Sueños (Endrrat), Editorial Praxis, México, D.F. (2015), Daszünd 74 blättchen (Poezi në gjermanisht), përktheu Susana Finger, Edition Dreizeichen Meissen (2016), Slaying the mosquito (Vrasja e mushkonjës), Laertes, Chapel Hill, SHBA (2017), Cuatropatrias (Katër atdhetë), Perrosalados, C. De México (2018), We fall likechildren (Rrézohermi si fëmijë), Egret, Chapel Hill, SHBA (2018), Çağdaş Kosova Oyunları Seçkisi (Vrasja e mushkonjës, brenda një antologjje), Turqi (2018) etj.

ANTOLOGJITË E PËRPILUARA


Así nacieron (Ashtu lindën), Antologji e poetëve të rinj meksikan, México, Géiser y Toshka (2005). Antología de poesía albanesa (Antologjia e poezisë shqipe), México, D.F. Përkthyer në gjuhën spanjolle, Ediciones Botas (2013)

PËRKTHIMET

Udhëzime për ta kapërcyer kufirin (Instrucciones para cruzar la frontera), Luis Humberto Crosthwaite, Prishtinë, Sabaiumbb (2005), Mater dolorosa (Materdolorosa), Ricardo RomeroVallejo, Botuar në gjuhën shqipe, Tiranë, Globus R. (2008), Elguardián de las golondrinas (Kujdestar i dallëndysheve), Petraq Risto, Përkthim në gjuhën spanjolle, Geiser y Toshka (2008)

DISA NGA ÇMIMET

Shpërblimi i Shoqatës së Shkrimitarëve të Kosovës – për librin "Emblemë e vdekjes" në vitin 1993, "Copë e humbur e parajsës", u shpërblye si libri më i mirë për vitin 1996 nga Shoqata e Shkrimitarëve të Kosovës, "Liria e tmerrit" u shpërblye si libri më i mirë për vitin 2000 nga Shoqata e Shkrimitarëve të Kosovës, Çmimi ndërkombëtar i poezisë në Meksikë në vitin 2004 për librin "Lutje shqiptare", Çmimi i Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës së Kosovës në vitin 2011, për monodramën "Vrasja e mushkonjës", Çmimi i parë për librin më të mirë me poezi në Mitingun e poezisë (2019) në Gjakovë, për librin "Vitet që nuk e sollën pranverën", Çmimi "Ali Podrimja" për librin më të mirë me poezi për vitin 2019 nga Ministria Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, për veprën "Kur qajnë hardhitë", Çmimi "Ali Podrimja" për librin më të mirë me poezi, për vitin 2021 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë, për veprën "Burri që lozta me engjëj". (Z. SH.)



Në shiritin e kohës

Hysë Shkreli: NJË LETËR PA ADRESE



I nderuar dhe i dashur Bekim Fehmiu, Na thanë se ke vrarë veten. E pabesueshme! Ti Bekim nuk mund ta vrisje Bekim Fehmiun. Ai ishte i madh për tu vrarë. E deshe ti atë apo nuk e deshe, ai nuk ishte vetëm yti. Ishte edhe yni. Ti linde në një qytet tragjik, ku filloi një luftë botërore e disa të tjera ballkanike. Ti linde në një kohë të pakohë, kur shqiptarët nuk kishin film, as ekran e as shtet të konsoliduar. Linde me shumë lindje shqiptare. Ato ishin lindje plotë dhembje, disa edhe të përgjakshme. Ndaj u detyrove, njësoj si Uliksi, të rrugëtoje e shpërnguleshe nga njëri qytet në tjetrin: nga Sarajeva, Shkodra, Prizreni, Prishtina... Udhëtave nga njëra kulturë në tjetrën, nga njëri front në tjetrin. Fole në shumë gjuhë, e megjithatë disa nuk të kuptuan. Ti zgjodhe të jetosh në një skenë e vend të turbullt. Kjo ishte beteja jote, në të cilën ishe i gatshëm për sulme e plagë. Ti nuk zgjodhe skenarin e jetës sate. Atë ta shkroi e imponoi koha e gjeneratës sate. Jeta jote ishte plotë shkëlqim e dallgë, guxim e frikë, sfida e fitore.

I ngjan fatit të shqiptarit. I ngjan historisë sonë. Si komb, ne përherë ishim në luftë mbrojtëse, ashtu siç ishe ti. Gjatë historisë, ndonjëherë në lidhëm edhe aleanca të gabuara, mirëpo arritëm edhe shkëlqime në civilizimin evropian. Megjithëkëtë, shpesh na bënë fajtor. Ishim të akuzuar, ishim të abuzuar. Jo rrallë e zgjodhëm tkurjen si mbrojtje.

Ti jetove në Beograd, në kryeqytetin e vuajtjeve shqiptare. Aty ku shqiptarët i quajtën "sharrëxhinj", "njëre me bisht", "primitivë"... Në qytetin ku shqiptarët përherë ishim të përbuzur e nënçmuar. Aty ku shpesh u morën vendime të kobshme për shqiptarët. Mirëpo, ti dëshmove se ne nuk ishim njerëz me bisht, por njerëz me njëqind shpirtra. Nuk ishim sharrëxhinj, por vetë sharra: ajo që hapë udhë edhe aty ku nuk ka. U ngrite mbi urrejtjen e përbuzjen në një yll hollivudian. Na bëre të ndihemi

krenerë edhe atje ku s'na njihnin ose ku s'na donin. I munde përcimimet që iu bënë kombit tënd. U tregove edhe armiqve të kulturës sonë se shqiptarët kanë talent dhe mund të ngrihen edhe mbi kulturën e tyre. U dëshmove atyre se ne kemi kulturë edhe për kulturën e tyre. U bëre idol i tyre dhe yni.

Kritikët e tu të qortuan pse zgjodhet Beogradin si qytet tëdindë akademik. Po ç'zgjidhje tjetër kishe? Ta studioje filmin në Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj!... Kosova asokohe nuk kishte shkollë për ty. Ndoshta mund të zgjidhje Tiranën. Po të zgjidhje Tiranën, s'ka dyshim se rruga jote jetësore do të ishte tjetër. Mirëpo, asokohe Tirana ishte e ndaluar për ty e për ne. Madje, edhe kineastët më të njobur të Shqipërisë në ato vite shkollët e zhgënjeshin në Rusi. Ndaj mbasë Beogradin e pate një udhë të imponuar nga rrëthanat, në të cilat jetove. Disa shtruan pyjetjen e kundërt: pse jo Beogradin?

Ne kishim intelektualë të shquar në të gjitha qendrat e Ballkanit. Nëse kishim një Moisi në Vjenë, një Gjika në Bokurest, një Luaras në Sofje, një Frashëri në Selanik, pse të mos kishim edhe një Bekim në Beograd? Në atë qytet jetuan dikur, e jetojnë edhe sot, më dhjetëra mijë shqiptarë. Në Beograd u shkolluan edhe intelektualë të shquar shqiptarë, si Anton Çeta, Idriz Ajeti e deri të Mark Krasniqi. Beogradi gjendet në Ballkan, e ky Ballkan u takon edhe shqiptarëve.

Të kritikuan pse nuk u shpërngule. Pse nuk e lëshoë Beogradin, atëherë kur edhe intelektualë serbë u larguan në shenjë proteste për politikën e luftën që u udhëhoq e u drejtua nga ky qytet. Vendimi yt mbasë ishte protesta jote. Apo lufta jote kundër tkurjes shqiptare. Në të kaluarën ne u shpërngulëm me mijëra nga Bujanoci, Nishi, Beograd. Mjaft na shpërngulën! Ndoshta është koha të rrimë e mbijmë aty ku duam për të dëshmuar praninë tonë në të katër anët e Ballkanit.

Gjithnjë dëshiruam të të shihnim në një film shqiptar, mirëpo kjo nuk ndodhi. Sigurisht që nuk ishe kundër filmit shqiptar, mirëpo ishe kundër provincializmit primitiv shqiptar, i cili nganjëherë preku kulturën tonë. Ne kishim heronj e role për ty, mirëpo nuk kishim filma për ty. Sepse ti ishe më i madh se filmat që bënim. Kosova nuk mundte të ofronte atë që nuk e kishte. Ndaj na kritikove e të kritikuam. Donim te të shihnim të përsosur, doje të na shihje më të mirë. Kritikat, ngado që erdhën, nuk ta humbën madhështinë. Ti mbete vigan në artin tënd e kulturën tonë. Kosova nuk ka intelektualë për të gjykuar apo hedhur.

Jeta jote ishte një rrjetë sfidash. Ti rrënove ose kapérceve shumë mure. Vizitove Shqipërinë në një kohë të turbullt, kur të tjerët e kishin të ndaluar. E theve kështu murin shqiptaro-shqiptar për të dëshmuar burimin e gjakut tënd. Shkove në Francë dhe me suksesin tënd në Kanë theve murin filmik midis Evropës Komuniste dhe Evropës Perëndimore, të cilat i kishte ndarë lufta e po i bashkonte arti. Më vonë, me filmat tu theve edhe murin kulturor midis Evropës Lindore dhe Hollivudit. Edhe atje ishte shqiptar.

Deshën të ta ndryshojnë emrin për shqiptim më të lehtë, ose qëllime komerciale, mirëpo ti nuk pranove. Emri yt kishte kuptim vetëm në gjuhën tënde. Mbete Bekim Fehmiu në çdo ekran ku zure jetë. Ti hyre në Hollivudit e Xhon Belushit, në kohën kur akoma nuk dihej se edhe ai ishte shqiptar. Pas Elena Qiriqtit ti ishe i pari emër shqiptar në dyert e Hollivudit.

Bekim, ti nuk e vrave Bekim Fehmiun. Nuk mund ta vrisje. Nuk kishe fuqi vrasësi për të vrarë Bekim Fehmiun. Dikush apo diçka vetëm u dha fund dhembjeve e vuajtjeve të trupit tënd. Shpirti yt gjallëron e inspiron.

Ty, apo trupin tënd, e vrau koha e ligë, koha e dhunës, koha e kosit, të cilën e

sollën ata që deshën një Ballkan tjetër. Ty të vrua dëshpërimi, vëtmia, zhëgjimi, politika... Ty të vranë ata që plagosën Evropën, ata që ngulfatën Ballkanin, ata që dogjën Kosovën, ata që shpërndanë vdekje nga Kroacia deri në Kosovë. Ty të vrua shovinizmi serb, primitivizmi Ballkanik, dhuna mbi humanizmin, urejtja midis njerëzve. Ty të vranë armiqë e artit tënd. Ata të gjithë së bashku nuk mund te të vrissin me një plumb, ndaj të vranë me zymtësinë, me errësirën e tmerrin që krijuan rrëth teje.

Ti besove se kultura është mbi politikën, mirëpo politika shpesh e dhunoj kulturën. Ti besove se arti është mbi ndasitë midis njerëzve, mirëpo njerëzit krijuan kufi gjaku. Ty të vrua rrënim i kalasë sate të paqes. Ty të vrua lufta pa luftëtarë. Të vrua paaja që nuk ishte. Të vrua koha e pakohë. Të vranë... apo besojnë se të kanë vratë!

Ti jetove në dy brigje që nuk takoheshin dot, sepse urat rrënoheshin çdo ditë. I besove kohës në të cilën jetove, mirëpo ajo të zhgënjeshi t' dëne. Zgjodhe heshten si armë kundër armiqve të tu, zgjodhe izolimin si protestë, mbylljen si mburojë. Ishin këto armë shumë njerëzore e të civilizuara për armiqë e tu primitivë.

Ti vendose ta bëje këtë luftë i vëtmuar. Megjithëkëtë ne ndihemi fajtorë: të lamë të vëtmuar atëherë kur më së tepërmë kishe nevojë për miq. Ne të kishim ty në ekran, mirëpo ti nuk na kishe pranë.

Të kërkojmë ndjesë.

Ti le Kosovën si Uliksi Penelopën për të luftuar për artin tënd. Kosova të priti me vite. Po kthehesh nga Troja jote në Kosovë hi e shpirt, yll e farnë. Vdekja jote na kujton kohën kur kolosë të kulturës sonë vinin në arkivole nga dhei i huaj.

Ti le porosi të kremohesh. Ndoshta pse trupi yt ishte në flakë prej vitesh. Ndaj varri yt nuk do të jetë në Beograd, as në Prishtinë, në Tiranë, as në Holivud. Varri yt do të jetë në qill, atje ku pushojnë yjet. Sepse ti ishe një yll. Atje të pret Aleksandër Moisiu e emra të tjerë shqiptarësh të bekuar. Në historinë tonë nuk është hera e parë që yjet shqiptarë lindin ose vdesin në dhe të huaj. E rëndësishme është që ata shkëlqejnë mbi tokën e tyre. Ne, jo rrallë u kemi dhënë krijues e heronj edhe kulturave të tjera, ashtu siç bëni bota e civilizuar.

Ti ishe një shkollë e Moisive të rinj. Familja jote ishte një universitet shqiptar: tempulli i Ibrahim Fehmiut. Sot familja jote, jemi të gjithë adhuruesit e filmit tënd.

Thanë se jetove 74 vjet. Themini se jetove më mijëra vjet e do të bësh edhe shumë jetë të tjera në të katër anët e botës, kudo që do të arrijnë filmat e tu.

Prizreni të dha djalerinë, ti po i jep emrin: Bekimin.

Ti nuk po i kthehesh tokës së Kosovës, ajo ka varre tepër. Po i kthehesh qillit të Kosovës. Engjëjt dhe artistët jetojnë në qill. Prej sot ai qill ka një yll më tepër. Të gjithë ata që éndërrojnë Olimpin tënd le të shikojnë kah ai yll.

Të qoftë i kaltër qilli i Kosovës!

Qoftë e pafund bota e artit tënd!

Qoftë i ndritshëm ylli yt në atë qill!

Nju Jork, 22 qershor 2010

(Shkëputur nga Monografia "BEKIM FEHMIU - Odiseu i Kosovës" (botimi i dytë 2021), të autorit Fahri MUSLIU)

RUDIANI I "ERRËT"

(Mbi mistikën gjuhësore të poezisë së Rudian Zekthit)



Agron TUFA

Eshtë shumë e vështirë të flasësh për poezinë në përgjithësi, por për poezinë e Rudian Zekthit kjo bëhet thaujse e pamundur. Kjo - ngase lypset një gjuhë tjetër, e cila të komentojë të pakomentonueshmen, proceset e ndërlikuara që shkaktojnë ndërrmendjet, aludimet dhe referencat e dendura nga kultura dhe gjenealogjia e saj: lypset të shpiket, siç e dimë, një mbigjuhë, e cila të jetë në gjendje të shpikojë një gjuhë që nuk eshtë gjuhja jonë e përditshme, që eshtë dhe s'është ojo gjuhë që njobim. Pra lypset një metagjuhë për poezinë, e cila për rastin e poezisë së Zekthit, prapë nuk eshtë ngushëlluese. Kjo vjen ngase tekstet e tij poetike janë të mbështjella me një rrjet të dendur domethëniesh, përftesash, luhatjesh e hijezimesh të holla kuptimore, saqë depertimi në thelbin e poezisë së tij ka mbetur ende (e mbapse kështu do të mbesë) një sfidë, tentativë vetëm për esnafët e asaj poezie që të josh me misteret e thellësive.

Që nga viti 1990 kur botoi ciklin e parë në "Zëri i Rinisë", kohë që përkon edhe me libërtinë e tij të parë - "Poezi" (Elbasan, 1990) - gjer në përbledhjen prej 26 poezish-poemtha "Poezi" ("Marin Barleti", 1995), sikundërse edhe në prozat e tij të shkurtër ose novelëzat, që Rudi i quante paradoxalist didaktike - poezia e Zekthit vetëm se e ka dendësuar atmosferën e mistikës gjuhësore. Them e mistikës, jo e hermetikës, që shpesh e kam parë tek disa imitues apo të ndikuar prej tij, ta shesin si ndërlikueshmëri imazhi, gjuhë e mendimi. Për Rudin kjo ishte gjuhë-normë e poezisë: stil individual të menduar, gjykuari, vegimi, sikundërse gjithë pasionet e tjera, deri tek natyrshmëria e prekjes dhe mahnisë që gjeti ai në besimin islam. Por ama ka qenë ai vetë me përvojat e tij shpiktorë të natyrshme dhe jo modat që t'i imponoheshin. Megjë ra fjala tek moda, unë kam njohur kënd tjetër që të ishte aq alergjik e përfashues përmodat apo gjérat që vinin së jashtmi. Prandaj kur them "mistikë gjuhësore" kam parasysh imazhet e lliruara instinktivisht prej brendësisë së tij, zhburgosjen, verbalizimin e tyre, të cilat krijojnë një atmosferë që i përfashon lexuesit e sipërfaqshëm, duke ua lënë këtë privilegji vetëm një numri të kufizuar lexuesh, kryesisht poetëve. A nuk eshtë ky një ndër tiparet që i kanë shoqëruar avangardistët në krye të qdo lloj lëvizjeje apo rryme? Pagëzori i simbolizmit rus, poeti Vjaçeslav

Ivanov qe shprehur për kubofuturistin Velimir Hlebnikov: "Poezia e tij do të fillojë të kuptohet përafërsisht pas 250 vjetësh". Rudian Zekthi ka qenë avanguardisti më ekstremal në grupimin e poetëve "E për-7-shme". Avangardizmi i tij përqendrohet kryesisht në procedetë e tij me gjuhën, duke e radikalizuar procedurin në tre sfera të shprehjes poetike: në formë (sintaksë), përbajtje (semantikë) dhe pragmatikë (demonstrimi i risisë si gjest). Kjo e vështirëson komunikimin, po të marrim parasysh se lexuesi ynë vjen prej përvojash leximor të sipërfaqshme. Prandaj edhe në gazeten avangardiste "E për-7-shme" (1992), në rubrikën "O popoll, popull, popull", Zekthi shkruan: "Ndër kërkësat e shumta që nisen si dallëndyshe nga parlamenti shqiptar drejt Komunitetit europian, kemi dhe ne një kërkës modeste: të na sjellin një katër mijë lexues të kualifikuar për gazetën tonë".

Si një nga poetët më të spikatur të avanguardës së viteve nëntëdhjetë, krijuimtaria e Zekthit dallon qysh në fillimet e saj përmataforën e zgjatur, ambivalente dhe asketike, e cila shpesh herë kalon në alegori. Por gjithë kjo trajektorë e metamorfozës së gjuhës tek Rudi nuk ndjek shenja e itinerare të njohura. Eshtë udha e shndërrimeve mbetet e panjohur, joreminishente, një sistem krejt vetjak që nuk të ndërrmend asnjë procede të mëparshëm në poezinë shqipe. Tek vargu i Rudit ke hyr në një pyll, por nuk e di se në cilën pjesë të botës je, nuk e di se në ç'brez gjeografik e gjeofizik je. Njësia e poezisë së tij bie menjëherë në sy përsintaksën tejet të koklavitur, ndërsa semantikisht ajo eshtë e ngjinj përplot asociane verbale, abstrakte me arketipe të pavetëdijes kolektive, duke krijuar kësioj, tablo surreale, makthe, nonsense, por edhe mikrodrama lirike, ku të gjitha komponentët - përfshij dhe sendorësinë - bashkëveprojnë sipas një logjike ankthi, vegmi e ëndrrës. Maniera stilistike e Zekthit për t'i vënë në një rrashf të ndërsjellët veprimi gjësendet e perceptueshme me ato abstrakte e mistifikon kodin komunikativ dhe e bën ligjëratën poetike të ngjashme, herë me fragmentet e teksteve të lashta apokrifike, herë me procedurat verbale të alkrimistëve. Nëse bëjmë në jë krahasin të kushtëzuar, logjika e ëndrrës (gjumit) në këto tekste, afron disi me manierën narrative të teksteve të Kafkës, Bruno Schulzit dhe Hlebnikovit. Konfiguracioni i fjalës sipas kësaj logjike, nuk hyn në lidhje referenciale me "botën". Nga kjo

pikëpamje letërsia zbulon ngjashmërinë e saj, jo me ligjërimin e aplikuar, por më së shumti me matematikën: diskursi letrar nuk mund të jetë i vërtetë apo i rremë, ai eshtë real veçse në raport me premisat e veta. Poeti, ashtu si dhe matematicieni, varet jo nga e vërteta deskriptive, por nga përshtatja e postulateve të tij hipotetike. Letërsia, ashtu si dhe matematika, eshtë gjuhë - dhe gjuhja në vëtvete nuk reprezanton asnjë të vërtetë, anipse ajo mund të përftojë mjete për shprehjen e një sasie të panumrit të vërtetash. Prandaj teksti letrar e ka në natyrën e vet tautologjizmin: ai shënjon vetveten. Simboli poetik, në thelb, shënjon vetveten, në lidhje me një vepër të dhënë poetike. Kur e pyesin poetin se çfarë ka dashur të thotë në x element të veprës së tij, ai gjithnjë duhet të përgjigjet: "domethënë e tij eshtë - të jetë një element i veprës".

Struktura e poemthave të Rudian Zekthit paraqet një ngrehinë të studiuar matematikisht, brenda së cilës kemi lëvizje konceptesh metafizike, herë natyrshëm e herë sforçueshmë, por me synimin për t'u realizuar në një tërsi të vetme ku vizualja dhe verbalja të shenjnjë, sipas Mihail Bahtinit, një kronotop të përbashkët. Këtu personazhi kryesor - Gjuha, e ngjashme me gjeometrin K të romanit "Kështjella" të Kafkës, bën çapë sizifiane në gjakim për të rrrokur të parrokshmen - energjinë ejdsionare të fjalës me derivatet e saj, zigzaket, hujezimet, asociacionet - të gjitha këto, të përllogaritura me një mastrar magjistari: kësodore logjikja me alogjiken identifikojnë njëra-tjetër në funksion të tërësisë poetike. Ngjëromjë për ilustrim një fragment të poezisë "Ngadalësim" ("Aleph", 11, 2001): "Kisha humbur dhe s'më gjente dot/ Asnjeri. Kurse vetë çuditesha si qenkat njësoj/ Sic isha para njëzet vjetësh./ E nisa për në varreza si çdo mëngjes/ Shpjegonte mësimin ime émë, veç mëngjes si ky/ S'më kishin zënë sytë, i plasarit/ Si puthjet e babait të tij. Dritëshkurtëri/ Dritëshkurtëri mbetet, humb, ta dija kaq idiot/

S'a kisha bërë kokën fare<...> Flisja me vete/ Shpesh se nuk isha vërtet idiot, por bota/ Atë punë ka, të shpifë, ndonjëherë të bëjë/ Sikur nuk më gjen. Po unë s'e kam për herë të parë/ Që humb moj nënë, pra, që më duket/ Se unë me përparsen e bardhë jam gogoli/ I vendlindjes têndë ndërsa rrëptësia e kodrave/ Më duket mjaltë e helikopter. Eja të kërkojmë/ Së bashku, se këtu rrotull duhet t'kem humbur".

Në poemthat e Zekthit, subjekti përbëhet nga ndeshja e ideve metafizike, vegimeve perceptivne të përziera në mënyrë surreale, duke të krijuar idenë-table se gjendesh në një korije magjike ku fshihen thesare, të cilat shfaqen tek-tuk e humbasin, ngase fasha të shpejt mjegulle ndërhynë dhe të pengojnë t'i shquash. Ajo që e vështirëson komunikimin e lexuesit me këtë poesi, eshtë shkapiçimi abstrakt alogjik dhe karakteri fragmentar i vargut, i cili bën dendur aludime të brendshme eksplikative me citime, duke i dhënë poezisë njyresë të theksuar fantastike. U rikthehem vargjeve të tjera ilustruese nga poezia e sipërcituar: "...Kam humbur pikërisht kur përvëlohesha nga dashuria/... Dashuroj si i çmendur edhe atë rosën me këpucë të vjetra/ ...Më kërkoni edhe andej nga thonin se rrini/ Si në pulari melekët, edhe aty ku kishin/ Korrur grurë me djersë të verdhë, brenda në kanalin e varfëri/ Kurse unë, jam kaq afër, në juglindje të filozofisë/ Aty ku do t'ishte vendi më i mirë/ Për të ndërë rrobat, po të kishit pak tru/...Mjafton, eja më gjeni shpejt, dua të ha/...do t'ju ndihmoj drejtëpërdrejt/ Me gjithë ndikimin tim po ta kaloj natën këtu/ Do më shqyejnë brekosit dhe misrat/ Reumatizma do fluturojë së bashku me shpirtin/ E do t'iu torturojë/ Duke zënë vend në fotografatë e mia".

Gjysëmseriozitet, ironi, fantazmagori - një rrëfim ngjethës dhe një asketizëm për ta zbuluar artificialisht vargun. Mbërritja e çiltër e thelbët të poezisë nuk eshtë punë për lexues dembelë, apo të rriturit me vargjet "mace-mace/-tollumbace". Shprehja poetike e Zekthit, e ngarkuar me këto tregues eksplikative, të jep iluzionin e fragmenteve apokrifike. Së këndejmi shpjegohet dha fakti që leximi i parë dhe i dytë i teksteve të tij, të lëmbresë të ndryshme; se nën leximin e dytë identifikimi tashmë eshtë i pamundur dhe leximi shndërrohet pashmangshëm në metalexim.

Një tjetër problem - madje problemi qëndror i poezisë së Rudian Zekthit - eshtë përfjetimi i kohës, i shtruar qysh në vëllimën e parë poetik "Poezi" (1990), derisa bëhet dominues në "Poezi" (1995). Kështu, duke i dhënë vetëdijes subjektive natyrë transhendente, Zekthi e abstragon gjuhën si të vetmen "pikë referimi", diku jashtë rrjedhës kohore dhe, së këndejmi, të fiksojë nëpërmjet identifikimit çdo interval të formacionit kohor. Sipas Zekthit, nuk mund të gjykosht mbi Kohën duke qenë i gjalltitur në rrjedhën e saj. Duhet diçka metakohore (jashtëkohore) për të pasur qartësi mbi rrjedhën e çregjullt megakohore (brendakohore). Në mënyrë intuitive Zekthi i afrohet poetikisht "koncepti intencional të egos transhendale mbi kohën", shumë të ngjashme me të dhënat ndërndijore të vetëdijes, të përpunuara në fenomenologjinë e Edmund Huserit (vepra e Huserit: "Fenomenologjia e vetëdijes së brendshme të Kohës"). Megjithatë, definicioni i Zekthit mbi idenë e Kohës eshtë më radikal: ndërsjelltësia e identifikimit të Gjuhës me Kohën, jo më vijen melodike, siç provuan Franc Bertrano dhe Huserli.


Duke marrë parasysh vështirësitë që paraqet hulumtimi i teksteve të tilla, që krijojnë jo vetëm konceptin, por dhe metaforën e konceptit, unë do ta ndaja Kohën në poezinë e Zekthit - në kohë të mendimit përmendimin me shkas tekstin dhe në Kohën e komentimit kur vëzhgimin mund ta përfytyrosh të shtrire në hapësirën e tekstit poetik të komentuesit dhe të të komentuarit. Por që të mund të ndjekim, si gjuhja arrin të shenjnjë identifikimin me formën e idesë (platoniane) apo gjësendit të kulluar, na rregull i ri i leximit të poezisë dhe një rritje intelektuale, pa të cilat nuk ngjatjetohesh dot me vargje krejt atipike, si të Rudian Zekthit.

Legj: Rudian Zekthi

Profile: Ramadan Sokoli

FIGURA E NDRITURE E KULTURES KOMBËTARE

Më 11 mars 2008, Ramadan Sokoli u shua duke lënë të ndrisë përgjithmonë emri dhe veprat e tij. Ai ishte dhe mbetet figura më e ndritur e kulturë sonë kombëtare në fushën e muzikologjisë, krijuesi dhe themeluesi i kësaj shkencë të re, që u mboll e lëshoi rrënje si shkencë prej tij, që në fillim të viteve '50 të shekullit që lamë pas.



Nga Shaqir REXHVELAJ

Profesor Ramadan Sokoli është jo vetëm një shkencëtar i madh, por edhe një patriot i madh. Duke iu referuar medias, ai është cilësuar edhe si rilindësi i fundit. Kjo mbështetur edhe te familja e tij e madhe në qytetin e lashtë të Shkodrës, te gjyshi i tij Hodo Pashë Sokoli, pjesëmarrës në Lidhjen e Prizrenit dhe mbrojtës i trojeve shqiptare të Plavës e Gucisë, Ulqinit, te i jati i tij Isuf Sokoli, edhe ky i internuar në Itali për të ardhë te vëllazëria e tij Ibrahim Sokoli dhe Hodo Sokoli, që bashkë me Radon provuan persekuimin e egër komunist, duke vuajtur mbi 40 vjet burg. Të gjithë intelektualë të ndritur dhe patriotë.

Profesor Ramadan Sokolin e kam njohur për herë të parë në qershori të vitit 1957 në festivalin folklorik të Qarkut të Shkodrës, ku unë isha pjesëmarrës interpretues i folklorit të Malësisë së Madhe dhe ai ishte anëtar i jurisë, ku përzgjidhnik talentë që do të merrnin pjesë në Festivalin e Rinisë e Studentëve që do të zhvillohej në Moskë në muajt korrik-gusht 1957. Fati dhe jeto e solli që prej asaj date deri sa ka mbyllur sytë unë të jem një ndër njerëzit më të afërt të tij (jashtë rrëthit të tij) në fillim si objekt i punës së tij, unë si bartës i folklorit, ai si stiuies i folklorit dhe më vonë, nxënës i klasës së tij në Liceun Artistik "J.Misja" në Tiranë, në degën e Flatis, pastaj student i tij në Konservatorin Shtetëror të Tiranës dhe pas studimeve si shok dhe mik shtëpie, i një familjeje me "hije në biografi", por të mrekullueshme në tradita, në mikpritje dhe me një rrëth të mrekullueshmë si nga ana e profesorit,

por edhe të së shoqes Lilit, nga familja tiranane Petrela, - një grua e rrallë ideale, që mund ta gjesh vetëm në romane.

Në vitin 1958, kur fillova mësim në klasën e tij përf flaut në Liceun Artistik, kam bashkëpunuar me profesorin si bartës autentik i folklorit të Malësisë së Madhe, duke riprodhuar këngët dhe meloditë e zonës sonë, duke filluar që nga këngët karakteristike "Majekrahit" e këngë të tjera pa shoqërim muzikor me karakter baritor, këngët rapsodike me lahitë, melodi të ndryshme në instrumentin populor "Zymare", disa melodi që vetë i kisha krijuar, por edhe shumë ninullëza e nanurisje të ndryshme fëminore, të cilat përfundin në rininë e tij pati instrumentin e kitarës, siç quhet rëndom kitara si "piano e të varfërvë". Me këtë bagazh muzikor dhe me disa krijime në fushën e këngës, në vitin 1940 regjisohet dhe vazhdon studimet në konservatorin "Luigi Cherubini" në Firenze - Itali përf kompozition dhe Flaut.

Mbas studimeve kthehet në Shqipëri me ndrrën e një të ri, përf të vënë në shërbim të vendit dijet dhe kulturën e tij perëndimore. Por mbas Luftës së Dytë Botërore në vendin tonë u instalua regjimi komunist dhe fatkeqësisht idelet, pikëpamjet e tij, por edhe tradita familjare dhe kultura perëndimore pluraliste binin ndesh me parimet e reja të këtij regjimi, siç rezultoi famëkeq përf shqiptarët. Meqenëse këto pikëpamje ai i shfaqte në rrëthet shoqërore në Shkodër, hapur sidomos edhe gjatë kryengritjes anti-komuniste të Postrribës, në vitin 1946 arrestohet dhe dënohet me 5 vjet heqje lirie. Ramadan Sokoli, siç edhe më tregonte, vitet e burgut e transformuan rrënje-sisht, sidomos në njohjen e jetës dhe të njerëzve të saj brenda hekurave të burgut njerëz të ditur, intelektuale klerikë, bajraktarë, pasanikë, tregtarë, malësorë, të një tradite që ridhët prej shekujsh, ashtu shqiptarë, por që po

rrezikohej seriozisht përballë një regjimi të ri, në pamje të jashtme popullore, por që vetëm ne që jetonim prapa hekurave e kuptonim se sa i padrejtë dhe i pamëshirshëm do të ishte përf shqiptarët. Në burg dhe në kampet e përqendrimit ku punova me të burgosurit - tregonte ai, kam njohur karakterin e vërtetë të shqiptarit, burra të ditur dhe të thjeshtë, trima dhe të pathyeshëm përballë torturave, por që ishin dhe palca e kombit, prej tyre jo vetëm kam mësuar, por edhe u yshtha përf të filluar shënimet e para të hedhura në copa e bloqe letre përf kulturën kombëtare shqiptare, përf folklorin, përf "gjëegjëza", përf doket dhe zakonet që ishin aq të pasura dhe të larmishme nga njëri tregimtar te tjetri e me një shtrirje; nga gjithë viset e Shqipërisë.

Shënimet e para dhe zanafillën e studimeve të para etnomuzikologjike prof. Ramadan Sokoli i ka nga vitet e jetës së tij në burg. "Cdo e keqe e ka një të mirë", përsëiste shpesh ai. Vitet e burgut i shfrytëzoi aq sa mundi përf të mbledhur nektarin e parë të traditës së kulturës popullore, të cilës ai ia kushtoi gjithë veprën e tij mijëra faqe, e shkruar në rrëth 20 libra muzikologji pa përmendur këtu krijimtarinë muzikore në disa fusha të saj, që nga kënga e përpunumi i saj, te veprat e shumta instrumentale, nga miniaturë te poemë simfonik, muzikë dhome e koncerthe përf instrumentin e flautit e deri te metoda përf fyell.

Botimet e para serioze në muzikologji me karakter ndërkombëtar kanë filluar me botimin: "Les dances populaires et les instrument mousicaux du peuple Albanais", Tiranë 1958.

Ky botim pati një interes të veçantë të qarqeve muzikologjike ballkanike dhe europiane dhe nuk vonoi shumë dhe profesor Ramadani krijoj një letërkëmbim me shumë muzikologë të vendeve të ndryshme, sidomos nga Rusia, Bullgaria, Rumania, Hungaria, Gjermania Lindore, por edhe nga vende perëndimore.

Me interes shumë të madh shkencor kanë qenë përf profesor Sokolin organizimi i dy ekspeditave shkencore muzikologjike, të organzuara nëpër vise të ndryshme të Shqipërisë, por kryesisht në jug të saj; e para, në vitin 1958 me shkencëtarë (muzikologë) gjermanë; Shtokman dhe Fidler dhe ekspedita e dytë me shkencëtarë rumunë të kryesuar nga muzikologja rumune, Zonja Comichel në vitet 1960.

Këto ekspedita nga pala shqiptare u kryesuan nga prof. Sokoli dhe një kopje të regjistrimeve të tyre sot ndodhen në fonotekën e Institutit të Kulturës Popullore. Metodologjia praktike e mbledhjes së gjinive të ndryshme të folklorit në terren përbën një përvojë të madhe shkencore përf muzikologjinë shqiptare dhe në këtë kohë fillon dhe një etapë e re e studimit të kësaj kulture popullore kaq të pasur dhe të virgjër, si përf studimesit shqiptarë, por sidomos

për studiesit e huaj. Kjo është edhe peridha kur fillon dhe ndërkombëtarizimi i muzikologjisë shqiptare.

Në vitet '60-'70, Prof. Sokoli boton veprën madhore "Folklori Muzikor Shqiptar (Prozodia dhe Morfologjia)", "Veglat muzikore të Popullit tonë (Organografia)", "Vallet e muzika e të parëve tanë (Ilirët)", "Chanson populaie albanaise (Albanskie narodnie pjesni)", volumi i dytë, "Figura të Ndrituara të Kulturës shqiptare në shekuj (Jan Kukuzeli Andrea Aleksi)", "Gjurmime folklorike", "Figura e Skënderbeut në muzikë", në kuadër të 500-vjetorit të Heroit tonë kombëtar. Mbas këtyre botimeve në Shqipëri, por edhe mbas publikimeve që bënë shkencëtarët gjermanë dhe rumunë në forumet ndërkombëtare folklorike me studimet e tyre, folklori muzikor shqiptar u ndërkombëtarizua si një pasuri e çmuar me identitet të veçantë i krijimtarisë në fushën e këngës homofonike e polifonike, në vallet e pasura me ritme të larmishme, me instrumente folklorike që përcillnin brez pas brezi shpirtin e melodive baritore origjionale, me kostumet kaq të bukurë dhe unikale, siç është "Xhubleta" e Malësisë së Madhe". Pra, shpirti krijues ndëri shekuj i popullit tonë po shfaqet i studiuar dhe i analizuari në mënyrë shkencore përballë kulturave të popujve të tjerë, me veçanti dhe identitet të panjohur deri atëherë edhe shkencërisht dhe për këtë meritë të veçantë ka pa asnjë mëdyshje profesor Ramadan Sokoli. Në këto vite krijuhet dhe Instituti i Kulturës Popullore me degën e muzikologjisë dhe shkencëtarët e rinx, por edhe ata me përvojë, pa dyshim krijusn një shtrim të ri me studime të reja dhe kontributet, duke zgjeruar dhe thelluar studimet shkencore, por dhe përfaqësimin ndërkombëtar të kësaj shkencë në forume studimore, por dhe duke e pasuruar me ekspedita të reja.

Për arsy biografike, që e ndoqën si hije e zezë deri në vitet '90, atij asnjëherë nuk iu botuan punimet

Por, në regjimin komunist sa herë forcohej dhe egërsohej lufta e klasave aq më shumë vështirësohej puna dhe vepra shkencore e profesor Ramadani. Për arsy biografike, që e ndoqën si hije e zezë deri në vitet '90, atij asnjëherë nuk iu botuan punimet. Disa herë vepra të veçanta përfunduan edhe në karton, sepse ai nuk pranoi asnjëherë që në parathënet e librave të tij të shkruej: "nën udhëheqjen e Partisë e shokut.... kultura popullore ka arritur...", etj. etj. Madje, më kujtohet se në vitin 1965 i kishin kthyer nga botimi korpusin "Veglat muzikore të popullit shqiptar (Organografia)", bash për këtë arsy, redaktori i shtëpisë botuese i kishte thënë se në fillim të librit duhet të vinte një shprehje të udhëheqësit të Partisë, të cilat, sipas tij, janë edhe shumë të goditura, por dhe aktuale për kulturën popullore. E takova profesorin, ishte shumë i mërzitur, e pyeta se çfarë kishte dhe më tha vërejtjen e redaktorit. Unë në bisedat me profesorin kisha krijuar një kofidencë të atillë që ai vëtë ma kishte dhënë dhe shpesh përdorja një stil ironik të foluri dhe i thashë: mirë të ka thënë, shumë të bukur i ka, pse s'vendos ndonjë nga ato dhe gjithçka zgjidhet fare lehtë. Ai më pa me bisht të syrit dhe duke pasur shumë besim tek unë tha: por ato s'janë shprehjet e tij, i ka të vjedhura nga njerëz të mëdhej dhe unë nuk mund të vë në hyrje të librave të mi "shprehje të vjedhura", pastaj ç'do një politikan të japë sentencë përfolklorin, ai nuk është shkencëtar që unë ta citoj. Por është filozof i thashë unë dhe mendimi filozofik udhëheq, por edhe frymëzon,



prapë me ton ironik. Unë jam në hall, tha, "ti më çan kokën", por me një ton aspak miqësor, madje në një mënyrë idhuate dhe profesori po të zemërohej e kishte shumë të vështirë të pajtohej, madje mund të them se ishte dhe një mangësi i tij. Ndërrova stil dhe i thashë "po të kesh besim, ta rregulloj unë" dhe në të vërtetë aty për aty më lindi një ide. Unë e kuptova, i thashë, ju nuk dëshironi të vini citate të dhe nuk e përmenda emrin se ishim dhe në rrugë (Me këtë rast dua të them se të gjitha bisedat kofidenciale me karakter politik dhe pakënaqësitet që kishte, i bisedonim në shëtitje). Pikërisht, më tha i nevrikosur, se do të më tallin të gjithë. Nuk shkon, e kupton se nuk shkon - një citat i tillë kërcet si zbranjë e një kobureje në një sallë koncerti. Mirë pra, i thashë, e kuptova. Më lejo të bëj një propozim, por po të pëlqeu do të më thuash që jam i mençur. Këtu u zbut dhe po priste zgjidhjen. Para disa ditësh, në muajin tetor, në kuadër edhe të muajit të letërsisë dhe arteve, ishte mbajtur Plenumi i 15-të KQ, ku jepeshin orientimet përvillimi e artit dhe letërsisë, por kryesishet dhe si duhet të mbështeten ato në traditën tonë dhe kushte edhe mjart fraza të gjetura që mund t'i përdorim, i propozova një frazë që më kishte bërë përshtypje, por që nuk e mbaja mend, por vetëm iderë e saj, duke i shtuar që këtë frazë e ka thënë R.Alia. Është dhe shkodran, por mos u bëni merak nuk ia përmendim fare emrin as këtij, themi nga Plenumi i 15-të përvillimi i letërsisë dhe Arteve, i cili është titulli "Mjeshtëri i Madh" dhe pas kësaj qyteti i tij i lindjes, Shkodra, Këshilli Bashkiak i kqtij qyteti i cili është titulli "Qytetar Nderi". Në vitin 1962, nxënësit e tij jepnin mësimin e këtë institucion të lartë të muzikës, ndërsa ai jo. Por kurrë nuk e dha vete. Ai vazhdonte të nxirrite kuadro dhe të jepte mësim me një devotshmëri që është vetëm në natyrën e njerëzve të veçantë dhe që bëjnë hitorinë e tyre dhe të vendit të tyre.

Ramadan Sokoli ishte një njeri me kulturë të gjerë, një figurë poliedrike në kuptimin e mirë të fjalës. Me atë mund të bisedoje përfshirë që fushë të artit, por edhe të shkencave humanitare, duke gjetur përgjigje profesionale dhe bashkëkohore, një enciklopedi e gjallë. Biblioteka e tij në shtëpi ishte shumë e

vetë e kishte përshtatur për Konservatorin.

Ramadan Sokoli, me mendjen e tij të ndritur na sjell një krijimtar me studime etnomuzikore, që nga Antikiteti ynë, me "Vallet e muzika e të parëve tanë (Ilirët)", si një gjurmues i pasionuar pasuron fondin tonë kulturor e kulturën tonë muzikore duke zbuluar figura gjigante, siç janë Niketë Dardani e Jan Kukuzeli, duke ndriçuar shekull pas shekullit me figurat e ndritura, si në librin "16 shekuj", deri në ditët tona, për të ardhur te krijimtaria e tij si këngët "Blegëron delja", "Turtullesha", etj, ku na prezantohet jo vetëm si studimes, por dhe krijuar me ndjeshmëri poetike krejt të veçanta muzikore. Hulumtimet e tij etnomuzikologjike janë shtigje të reja që shkelën për herë të parë nga ky studimes pasionant, që shquhet për thellësinë e mendimit, gjësina e horizontit kulturor, si dhe seriozitetin e gjykimit shkencor të lëndës që merr për objekt studimi.

Duke i hedhur një vështrim të shkurtër veprave studimore të Prof. Sokolit konstatojnë me kënaqësi se ajo shtrihet në 20 shekujt e etnisë së kombit tonë dhe përbën vlera të pamohueshme në panteonin tonë kulturor. Por, profesori ynë i nderuar gjatë gjithë vëprimit të tij në regjimin komunist nuk ka një vlerësim sado të vogël për veprat e tij dhe asnjë "Fletë lavdrimi" nga ato që rëndomt jepnini Bashkimet Profesionale. Shpesh me ironi dhe cinizëm për regjimin, profesori tregonte se të vërtetmen "Fletë Nderi" që ka marrë, ka qenë në qitje ushtarakë në zbor, që çuditërisht, rastësisht, kishte dalë shkëlqyeshëm.

Ndryshimet demokratike në vendin tonë profesor Sokolin e gjetën në moshën e tretë, në të 70-tat, mbasi kishte harxhuar gjithë dijet dhe mundin për të vënë gjithçka në të mirë të kulturës kombëtare, por pa ndonjë vlerësim dhe pa më të voglën vëmendje për ta shpërblyer me tituj apo ndere të tjera. Është qeveria e Partisë Demokratike dhe institucionet e ngritisura prej saj që vlerësuan punën dhe vepren e muzikologut Ramadani Sokoli. Duhet të vinte viti 1995 kur Akademica jonë e Shkencave i akordoi titullin "Profesor".

Në vitin 2000, Qendra Ndërkombëtare e Jetëshkrimeve në Cambridge të Anglisë, e përfshin Prof. Ramadan Sokolin në Enciklopedinë e Personaliteteve të Shqipërisë. Në vitin 2002, nga Presidenti i Republikës, Zoti Alfred Moisiu, i akordohet titulli "Mjeshtëri i Madh" dhe pas kësaj qyteti i tij i lindjes, Shkodra, Këshilli Bashkiak i kqtij qyteti i cili është titulli "Qytetar Nderi". Në vitin 2006, Qendra Kombëtare e Veprtarive Folklorike i jep medajen "Embëlernë e Kulturës Shqiptare" dhe po brenda këtij viti ABI/Istituti Amerikan i Biografive i jep Diplomën "Ekspert në Etnomuzikologji dhe Kompozim".

Ramadan Sokoli njihet edhe si një penë shumë e njohur në pulicistikë. Ai ka trajtuar në shtypin e kohës publicistikë me karakter shkencor kulturor si: te revista "Nëntori", "Shkenca dhe Jeta", "Kultura popullore", ka trajtuar probleme të etnomuzikologjisë, ka shkruar skenarë përdokumentare të Kinostudios, por sidomos për emisione radio-televizive, me qindra artikuj, studime, tekste mësimore, recensione etj. Një faqe e ndritur jo shumë e njohur është dhe krijimtaria muzikore në gjini të ndryshme e profesor Ramadani Sokolit, por ajo meriton një vështrim me karakter njohës, studimor dhe publikues, sepse ka edhe shumë vepra që ende nuk kanë parë dritën e ekzekutimit në publik.

E MADHËRISHMJA NË ESTETIKË

Çdo gjë që ngjall idenë e pakënaqësisë dhe rrezikut, që rezulton të jetë e tmerrshme ose lidhet me objekte që shkaktojnë mahnitje, tmerr ose diçka të ngjashme, sipas Berk-ut, është burimi i sublimes

Nga Metin IZETI

Estetika zakonisht kuptohet si një disiplinë filozofike që merret me të bukurën dhe artin. Megjithatë, ky përcaktim i fushës tematike të estetikës nuk është i vetëkuptueshmë, nëse kemi parasysh një kategori tjetër estetike siç është e madhërishmja (sublimja). Sublimja nënkuption atë që ne e ndiejmë si të madhe, të fuqishme, madje të dhunshme, ajo që ngrihet përtrej çdo mase dhe kufiri dhe që është madhështore. Në ekzistencë sublimja lidhet me Zotin dhe krijimin madhështor të Tij, ndërsa në natyrë, lidhet me përmasën sublime të diellit, qillit me yje, malet, deti, si dhe me lloje të caktuara të artit si faltoret, himnet, trajeditë dhe ndërtesat monumentale. Ndryshe nga e bukura, sublimja nuk shoqërohet vetëm me kënaqësi dhe gëzim, por edhe me pakënaqësi, drojë, frikë, tërmet. Për këtë arsy, një komponent i rëndësishëm i ndjenjës së sublimes është distanca, pra siguria personale në raport me dukuritë që evokojnë sublimen, por që nuk mund të kërcenojnë ekzistencën e vëzhguesit. Në të njëjtën kohë, këtu bëhet fjalë për një problem tjetër të rëndësishëm estetik, i ashtuquajturi problem i emocioneve të përziera në estetikë. Ky është një fenomen i njohur që nga Aristoteli dhe i formuluar në pyjeten se si ndodh që ndjenjat që nuk konsiderohen ndryshe të këndshme në përvojën estetike të një vepre arti përfaqësojnë një pjesë integrale të kënaqësisë. Trajtimi sistematik i së bukurës dhe sublimes që ndodh në shekujt XVIII dhe XIX çon, nga njëra anë, në kundërshtimin e së bukurës dhe sublimes, si te Burke dhe Kant, ndërsa nga ana tjetër, e bukura dhe sublimja janë të lidhura në unititetin e së bukurës dhe sublimes, si tek Winckelmann dhe Schelling.

Kur sublimja morale bëhet sublimë estetike

Filosofët janë të vetëdijshëm për veçantinë e problemit estetik të sublimes. Ata besojnë se sublimja shquhet në një sërë kallëzuesish me vlerë estetike si diçka e veçantë, në një farë mënyre më e rëndësishme dhe më e veçantë se kallëzuesit e tjerë vlerash, madje aq sa ndoshta sublimja është e vëtmja e padisikutueshme ndër të gjitha kallëzuesit e vlerave estetike. E bukura, e holla, idiliqja dhe e këndshmja e fitojnë thelbën e tyre vetëm në reflektimin (e tyre të përbashkët) me sublimen. E madhërishmja (sublimja) është një kategori estetike e pamohueshme e rëndësishme, pavarësisht nëse disa atë ka kanë nënshtruar të bukurës (siç bën vetë Hartmann) ose e kanë ndarë nga e bukura (siç bën Kanti).

Estetika i kushton një vend krejtësisht konvencional të shfaqjes së sublimes si diçka të madhe që tejkalon dhe del mbi çdo gjë tjetër dhe është superiore në atë, në natyrë, në jetën njerëzore, por edhe në fantazi e mendime. E gjemjnë sublimën në stuh, dallgët e detit, ujëvarën, sipërfaqet me borë të maleve të larta, në shkretëtirë, në heshtjen e fushës dhe qillit plot yje, gjithashtu për shkencëtarin është sublime rruga e atomit, ose lëvizja delicata në bërrthamën e qelizës. Estetikisht sublimi është diçka tjetër. Shfaqet "për ne", nëse kemi qëndrimin e duhur në perceptim dhe shijim. Kur në jetën njerëzore shohim dikë që është ngritur mbi dhimbjen dhe vuajtjen, që sakrifikan jetën e tij për hir të një dytë të madhe, kemi njëfarë ndjesie të sublimes. Këtu, megjithatë, zakonisht nënkuptionjë sublimen nga aspekti moral. E kur sublimja morale bëhet sublimë estetike? Sublimja morale nuk na lejon të distancohem nga ajo. E larta morale dhe në përgjithësi sublimë bëhen estetikisht sublim kur përvëç admirimit ka distancë, që madhështia dhe epërsia të duken larg shpirtërores së ngacmuar menjëherë.



Fushat më të pastra të sublimes janë, feja, veçanërisht përmasa ezoterike e fesë, miti, botëkuptimi, madje edhe mendimi filozofik. Edhe pse është e diskutueshme në estetikë se a janë të gjitha këto dukuri thjesht estetike? A është vendi i vërtetë i sublimes estetike, vetë sublimja artistike? Sublimja nuk mund të lidhet vetëm me disa tema lëndore, por përkundrazi është mjalt e pavarur prej tyre. Me përashtim të dekorimit, sublimja ekziston në të gjitha artet. Në pikturë vërehet qartë marrëdhënia midis së bukurës dhe sublimes. Sublimja fillon aty ku e bukura i tejkalon mundësitet e gjykimit të shijes dhe logjikës dhe përballet me fascinimin dhe mahnitjen dhe shpeshherë nga brenda thotë: Kjo nuk mund të jetë njerëzore!

Sublimja si një nga kategoritë e të bukurës

Pas rënies së papritur të teorisë klasike, formale të të bukurës si një kategori themelore, që năodhi në shekullin e 17-të, ideja e sublime është e vëtrua ide që ka mbijetuar deri më sot midis ideve tradicionale estetike dhe disa teoricienëve kryesorë bashkëkohorë. E madhërishmja është një kategori e modernes dhe post-modernes par excellence; mes estetive është Teodor Adorno, i cili vë në dukje se "ideja e sublimes, pas rënies së papritur të të bukurës formale, është e vëtrua ide që ka mbijetuar përgjatë modernitetit midis ideve tradicionale estetike"; sublimja që Kanti i kishte rezervuar ndjenjës së natyrës (sepse nuk e kishte përfjetuar ende artin e madh subjektiv) u bë shpejt pas tij një përbërës i vetë artit.

Koncepti i sublimes ekziston në përmasën e artit që nga kohët më të lashta.

Atë e hasim në faltoret, këngët fetare në Egjiptin e Lashtë, Në Indi, në Kinë, në Persinë e lashtë dhe gjetiu. Ndërsa në Greqinë e vjetër u formësua në antikitetin e vonë, në retorikë, ku piktori me stilin sublim tregonte stilin më të lartë të oratorisë. Në këtë kuptim, ky term përdoret shpesh nga Dionisi i Halikarnasit në traktatin e tij Mbi kombinimin e fjalëve, ku dallon tre lloje të të folurit: i repte, i bukur (të hollë) dhe i ndërmjetëm; stilii sublim ishte i pari, i repte, dhe kjo tregon se grekët dhe romakët e kuptionin sublimen si madhështi dhe seriozitet. Një stil i tillë, siç konsiderohej në atë kohë, ishte tipik për Empedoklen, Pindarën dhe Eskilin dhe kishte diçka të madhe, domethënëse, madhështore në të. Një kuptim pak më ndryshe gjemjë te Dhimitri, i cili në traktatin e tij Për stilin dallon katër stile: i thjeshtë, madhështorë, delikat dhe i fuqishëm; duke analizuar stilin madhështor/megaloprepes/, ai thotë se ai nuk buron nga raporti i fjalëve apo teknikat e ndryshme retorike, por më tepër nga fyrmezimë i temës në fjalë.

Eh pse është shkruar shumë për stilin sublim në retorikën antike, veprat më e rëndësishme zakonisht konsiderohet se është traktati Mbi sublimën (Peri pypous), i cili i atribuohej prej kohësh retorikut të famshëm nga shekulli i III Cassius Longinus (kështu që autorësia e tij sot do të i atribuohej një autor të panjohur nga shekulli I pas Krishtit, i cili tanë quhet me kusht Pseudo-Longinus). Ky shkrim polemik u shkrua kundër traktatit me të njëjtin emër nga retoriku Cecilius, një ndjekës i Dionisit të Halikarnasit, të cilin autorin e kritikon përmalizmin e tij të thatë, sepse në traktatin e tij Cecilius mjaftohet me numërimin e rregullave teknike retorike pa iu përgjigjur asaj që është në thelb, pra,

sublimes. Vetë Pseudo-Longinus në traktatin e sipërpërmendur jep disa përkufizime të sublimes; qysli në fillim thotë se është "një lloj maje dhe përsosmërie e të shprehurit" dhe se shkakton një përshtypje të madhe emocionale sepse "në kohën e duhur dhe në vendin e duhur tund gjithçka si rrufe dhe papritmas zbulon forcën e folësit". Longini i kushton vërmendje të veçantë efektit të sublimes tek njeriu: qëllimi i sublimes nuk është pastrimi, imitim apo udhëzimi, por sjellje e dëgjuesit në një gjendje kënaqësie, dhe për ta arritur këtë, Pseudo-Longini thekson pesë burime nga të cilat lind lartësia e stilit: "Tek të gjitha këto burime, siç supozojmë ne, thermeli është aftësia natyrore, sepse pa të nuk mund të krijuhet asgjë. E para është aftësia më e rëndësishme përmes idës mëdha (...). e dyta është një ndjenjë e thellë dhe e frymëzuar, pra, këta aftësi të sublimes janë kryesisht të lindura. Pjesa tjetër mund të përfshitet artificialisht. Aftësia e tretë konsiston në disa përpunime të veçantë të figurave (nga të cilat ekzistojnë dy lloje: figurat e mendimit dhe figurat e shprehjes). Pastaj vjen fisnikeria e të shprehurit; përfshin dy pjesë, përkatësisht zgjedhjen e fjalëve dhe të folurit në një shprehje të transferuar e të rafinuar dhe së fundi, momenti i pestë, që është zëri sublim që përfshin të gjitha ato që i paraprijnë dhe përbëhet nga përbërja dhe renditja e fjalëve; Ky koncept i ligjërimit përpinqet që të paraqëse seriozitetit dhe sublimitetit". Ky shkrim, i konsideruar në lashtësi si një traktat mbi retorikën, humbi gjatë mesjetës dhe u zbulua vetëm në shekullin e 10-të në Bizant dhe iu bashkëngjitet dorëshkrimit të traktatit Probleme Fizike që i atribuohet Aristotelit; pasi u gjet në shekullin e 16-të dhe u përkthye (1672) në frëngjisht, traktati filloj të interpretohet në një mënyrë të re - si një vepër mbi teorinë letare. Kështu Nicolas Boaleau (N. Boileau-Despreaux, 1636- 1711), duke përkthyer këtë shkrim, futi në estetikë konceptin e sublimitetit (dhe me këtë konceptin e fascinimit), kështu që vëtëm në shekullin e 19-të, sublimja u kuptua si një nga kategoritë e të bukurës.

Ndryshimin midis të bukurës dhe sublimes

Në Angli, koncepti i sublimes u përdor gjërisht nga Addison, Hume, Shaftesbury dhe Hutcheson. Në vitin 1747, John Bale shkroi, në atë kohë jo shumë me ndikim, një ese mbi sublimen dhe në 1757 Edmund Burke (Burke, Edmund, 1729-1797) botoi traktatin Hulumtime Filozofike mbi Origjinën e Ideve Tona të Sublimes dështë Bukurës. Në këtë shkrim, Burke vazhdon traditën e estetikës sensualiste angleze që fillon me Locke. Duke ndjekur gjurmët e Shaftesbury (Anthony Ashley Cooper Lord, 1671-1713) dhe Hutcheson, Burke beson se nocionet tona për bukurinë dhe gjykimet e shijes bazohen në përvojën, dhe meqenëse organet shqisore të të gjithë njerëzve janë të barabartë, po ashtu edhe nocionet e bukurisë dhe e sublimes janë të tillë. Sipas Berk, sublimja lidhet me efektet e vetë-ruajtjes, të cilat përfshijnë frikën, tmerrin, habinë dhe ngazëllimin. Çdo gjë që ngjall idenë e pakënaqësisë dhe rrezikut, që rezulton të jetë e tmerrshme ose lidhet me objekte që shkaktojnë mahnitje, tmerr ose diçka të ngjashme, sipas Berk-ut është burimi i sublimes.

Që në faqet e para të shkrimeve të tij, Berk vë në dukje përdorimin e gabuar, shpeshështë arbitrat të koncepteve sublimes dhe veçanërisht të bukurës, dhe për këtë arsyen përpinqet që këto koncepte të mos i analizojë veçmas, por në lidhjen dhe ndryshimin e tyre të ndërsjellë. Ai i sheh dallimet në faktin se sublimë qëndron tek pakënaqësia dhe e bukura tek ndjenjat pozitive; përmë tepër, sublimë lidhet me diçka të fortë dhe të fuqishme, dhe e bukura

me disa dobësi. Duke e shoqëruar në mënyrë të pajustifikueshme sublimen vetëm me afektet negative dhe duke ngushtuar kështu shtrirjen e këtij termi, Berk përpinqet t'i kontrastojë këto dy terma për të treguar kundërshtinë e tyre, kështu që është e kuptueshme që ai gjen një afërsi mes sublimës dhe të shëmtuarës.

Traktati i lartpërmendur nga Burke mbi origjinën e ideve për sublimen dhe të bukurën ishte i njohur jo vetëm në Angli, por edhe në vende të tjera evropiane, veçanërisht në Gjermani dhe Francë; një koncept i tillë i sublimës ishte në estetikën angleze të shekullit të 18-të i lidhur ngushtë me mësimin e gjeniut, peizazhin romantik dhe idetë e estetikës pararomantike. Më pas, si reagim kundër estetikës së klasizmit, do të shfaqet sentimentalizmi dhe nevoja për kategorinë e termave të rindës, pasi atë, të parët do të konsiderohen të

pamjaftueshme në klasicizëm; kështu do të shfaqet termi piktoreske/piktoresk/ (1792), si diçka që është midis së bukurës dhe sublimës; kundrejt së bukurës, e cila karakterizohet nga proporcionaliteti dhe rregullia, piktoreskja, karakterizohet nga çrrregullimi dhe asimetria. Në përpjekje për të dalluar ndjenjet e së bukurës dhe sublimës, dhen ndikimin e madh të Berk-ut, Kanti e ka shkruar njërin nga shkrimet e tij të para "Për të bukurën dhe sublimen" (1764), ku ai theksoi sesi sublima emocionon dhe e bukura tërheq. Aty, Kanti, ashtu si Burke para tij, shkruan se sublimja lidhet me madhështinë e lëndës dhe shkakton tmerri e emocion. "Pamja e maleve, majat e mbuluar me borë ngrisen mbi re, përshtkrimi i stuhisë së furishme ose fotografia e ferrit e dhënë nga Milton njall pëllqim, por pëllqim të ndjekur nga një dridhje; (...) me qëllim që kjo përshtypje mund të zhvillohet në ne me

forcën e duhur, ne duhet të kemi një ndjenjë të sublimës; (...) Lisat e gjatë dhe hijet e vemuara në paraqës janë sublim, rrugët me lule, gardhet e ulëta dhe pemët e prera në forma të ndryshme janë të bukura. Nata është sublim, dita është e bukur". Nëse në këtë shkrim Kanti niset nga parimet sensuale dhe empiriste në përcaktimin e sublimës, duke gjetur dinjitet në piramidat dhe faltoret e ndryshme, dy dekada e gjysmë më vonë ai nuk do të kënaqet më me kriteret empiriste, kështu që sublimja, si e bukura para tij, do të konsiderohet e bazuar në parimet apriori të mendjes brenda sistemit të kategorive filozofike dhe estetike dhe do të përpinqet të tregojë karakteristikat e sublimës bazuar në vendin e saj në sistemin e kategorive estetike.

Duke vënë në dukje ndryshimin midis

të bukurës dhe sublimës, Kanti vë në dukje se kënaqësia që marrim nga e bukura lidhet me paraqitjen e cilësisë, ndërsa, kënaqësia që ofron sublimja me paraqitjen e sasisë; ndërsa pëllqimi i së bukurës mbart brenda vetes një ndjenjë të drejtë përdrejtë të përsosjes së jetës, ndjenja e sublimës përfaqëson një kënaqësi që lind vetëm në mënyrë indirekte, duke u prodhuar nga ndjenja e një frenimi momental të forcave jetësore, dhe si rrjedhim, pëllqimi i sublimës, përmban në vetvete admirim dhe respekt. Përdherisa te e bukura, shija presupozon dhe e mban shpirtin në soditje paqësore, deri atëherë ndjenja e sublimës, sipas Kantit, mbart brenda vetes si karakter një ngacmin shpirtëror të lidhur me gjykimin e objektit. Për më tepër, lartësia e vërtetë duhet kërkuar vetëm në shpirtin e atij që gjykon dhe jo në objektin e natyrës, gjykim i të cilit e lind këtë gjendje.

Ese

ROBI

(Manual tregues mbi gjendjen e errët të racës shqiptare)

Fehmi AJVAZI

Të gjithë njerëzit lindin të lirë në natyrë. Liria natyrore, ligjet natyrore dhe gjithçka tjetër, qenien njerëzore e formaton si unike, të papërsërithshme. E mandej, fati i çdo qenie varet nga ambienti që i takon, raca, gjinia, kombi etj. Përcaktuesi i tij, natyra, vendos për te. Natyra na i jep të gjitha atributet, ende pa lindur dhe disa të tjera! Por, nuk janë të gjitha. Këto "të tjera" përcaktohen nga kushtet dhe rrëthanat shoqërore, si dhe ato juridike e shtetërore. Mes ligjeve natyrore dhe atyre shoqërore, derivati njerëzorë, e përcaktion fatin e tij. Në fakt, "unë, ti, ai tjetri, ata etj.", varet se çfarë ideuan, si u zhvilluan, sa u zhvilluan dhe sa sakrifikuani për vetën e tyre, dhe që kanë trashëgim.

Kështu disi, mbi ligjet natyrore erdhën duke dominuar ligjet shoqërore. Soji i dominimit, në fillim qenë sjelljet e formuara, rregullat, normat, zakonet etj., të cilat, pas vitit 1648, kur zuri fill shteti modern, gradualisht ua lëshuan vendin ligjeve shtetërore. Fatkeqësish, në shkuj e mëhershëm, mbështetet para erës sonë, u klasifikuan disa kategori shoqërore, që domethënë disa klasa shoqërore. Kështu, zhvillimi shoqërorë nga domosdoshmëria dhe presioni i zhvillimit, pranoi "ndarjet" si mundësi ekzistenciale, dhe si nevojë e konkurrencës shtetërore. Lindja e tipeve të para të organizuara, qytet - shtetet, dhe pastaj mbretëritë, perandoritë etj., i dhanë kuptim filozofisë jetësore të njeriut. Lindja e religjionit, hapi etapë të re zhvilluese. Dhe kështu, me kalimin e kohës, përfundimisht, normat natyrore erdhën duke e humbur kuptimin, mes normave praktike-shoqërore, dhe atyre hyjnore.

Demonstrimi i lirisë, hyri në fazë të reja. Iluminimi si mënyrë jetësore, konkurenca, luftërat etj., u dhanë shtysë kategorizimeve shoqërore. Prandaj, pa vazhduar më tej në histori, këndej klasës më të lartë, asaj aristokratë, dy qenë klasat e fundme: shërbëtorët (skllevërit) dhe robërit (të izoluarit, të kapur në luftë, të detyruarit, të pushtuarit etj.)

Fatkeqësish, duke qenë se zhvillimi njerëzorë mori me kohë formatin e "piramidës", këto dy klasa pa statut dhe me statut shoqërorë, ishin gjithmonë shumicë shoqërore. Pra, në çdo formacion shoqërorë. Mund ta merrni me mend zhvillimin e tyre: qoftë nga pikëpamje



mendore dhe edukative, dhe qoftë nga pikëpamja e veprimit dhe e zhvillimit! Dinamika e mëtejme, "koha dhe hapësira" për këto kategoritë, pothuajse nuk ka ekzistuar. Do t'i përkufizoj se do t'i fus të gjitha këto kategoritë shoqërore në një "thes" dhe do t'i quaj ose etiketoj sipas mendimit-shprehjes-fjalës "rob"! Ç'kuptojmë me këtë fjalë?

Fjala "rob" vjen nga periudha e sklavopronarisë, koha kur pronarët dhe skleverit njiheshin si dy kategoritë: të parët sundues, pronarë, dhe të dytë shërbyes, kategoritë pa asnjë të drejtë, skllevërt...! Nezir Myrtë, një publicist, thotë se "fjala rob, rop shpreh vuajtje, ropje lëkure nga puna e vështirë, ropje e deri tek -rob - zoti, rob - shpije, rob - ushtrie, rob - lufte etj" Pra, bëhet fjalë për qenë njerëzore, kategoritë shoqërore pa të drejta, pa liri, i diriguar, i komanduar, i shfrytëzuar etj. Për t'i rënë më shkurt çështjes, derivimi i dikurshëm natyrorë, nuk ka pasur "fat" të mirë kur është në pyetje qenë njerëzore: padyshim, shumica e saj. Ndryshe nga periudha e vrasdhët historike e sklavopronarisë, etapat e ardhshme derivuan në shpresime të tjera, si rriten krijimt e "forçës" si mjet në arritjen e qëllimeve. Luftërat e dominuan tërësinë njerëzore dhe mileniumi i dytë pati si prolog e epilog të përgjithshëm "Zotin e luftës"!

Mileniumi, nënkuptioni një 1000 vjeçar. Mes tij, e gjemjë racën tonë iliro-shqiptare: të ndryshur deri në mbijetesë! Nuk na shkon tjetër gjë, pos fjalës "i robëruar", "robëri", "rob"!... Kot themi ndryshe, pavarësisht se kemi të drejtë kur i referohemi mileniument të parë, ose kohës para Krishtit! Arma, pse të shkojmë që larg? Bile, do doja të nisës nga vitit "1648". Por që do: ne duhet ta shprehim fatkeqësinë kolektive me faktë: viti "1054", përbënë fatkeqësinë më të madhe dhe tposhtëzen pa kthim!

Të përkushtuarit mbi të kaluarën, mbi sakrifitat, fenomenet, historisë etj. i dinë këto data dhe të tjera në mes, ndërsa që periudha e gjatë e rrënimit, nënkuptionet vetëm me shprehjen - fjalën "rob", sepse s'ka tjetër mënyrë për t'u kuptuar e kaluara. Pra, ne ishim "robëri" të një mileniumi, pavarësisht trashëgimisë së madhe në çdo kuptim! Robëria zgjati shumë, aq shumë sa e solli në zgrip të ekzistencës qenën tonë. Është alogjike të themi apo konstatojmë, por ne mbijetuan falë kthimit dhe ndërtimit të lidhjeve me të natyrshmen: pra, me "botën e natyrshme" - me ligjet e saj. Të tjera kohë kur ka filluar mileniumi i tretë? Sillet edhe mirë, madje bashi si një rob: sepse ka problem t'i kuptojë normat dhe ligjet shoqërore, ato juridike, shtetërore. E para, nuk i paguan taksat, sepse ai kujton se ende jeton në kohën e sklavopronarisë dhe, këtë punë ia lë shtetit, ose ankohet te shteti! E dyta, s'kupton nga politika, sepse ende kujton se është në periudhën para shtetërore! E treta, kërkon gjithçka nga tjetri, nga shteti, ankohet, aktron, përbaltë, mashtron etj., dhe të gjitha këto manare e huqe i ka në mendje dhe instinkte, sepse s'ka pasur kurrë shtet të vetin! E katërta, në fund të ditës "të gjitha mëkafet e bëra dhe të pabëra", gjykon t'ia lë si barrë perëndisë - zotit, kuptohet duke u përpjekur ta gjenjë e mashtrojë edhe hyjin! E pesta, robi nuk e do artin, kulturën, të bukuren, të madhërishtmen, sepse ai si ka poseduar ato, si ka shjuar, si pa pasur pronë të tij kurrë! E gjashtë, robi nuk lexon, e keqja më e madhe e tij, dhe ai gjykon se i mjafton një libër: e ai libër, është njëri prej librave të shenjtë! Pra, robi nuk e vlerëson librin, mendim dhe sjellja e tij më e shëmtuara e mundshme dhe kështu, ai nuk ka bibliotekë në shtëpi. E shtata, robi nuk i çmon të arriturat, institucionet, vlerat, cilësitë etj. Robi mjaf-tohet me bukën e përditshme, dhe me ditën që vjen nesër! E teta, robi beson se bota u krijua për shtatë ditë, dhe se në ditën e tetë, bota mund të shkatërrohet që nesër, prandaj ai mjaftohet me botën e përtjejmë...

Nuk është e turpshme të konstatojmë se mezi qëndrojmë në këmbë, rrëzohemi përditë, nuk mendojmë lirshëm dhe kthjellët, nuk sillemi si të ekuilibruar, nuk vendosim me konsistencë dhe drejtë, nuk veprojmë qysh duhet: mbarë, fuqishëm, me gjykim të qartë etj. Vetëmohimi për t'u kthyer të kaluarës, sot nuk kërkohet sepse edhe është i parmundshëm, por "vetëmohimi" për korrigjime dhe redaktime shoqërore e kombëtare, do t'ishte gjëja më sublime. Nuk është e turpshme kujtesa, pendimi, e vërteta, por të turpshme janë aktrimet, improvizimet, mashtimet etj. S'i mund të zbresim në "panteon" ose si mund të kthehemti atje?

Nuk është mizore dhe as antishoqërore, aq më pak antikombëtare ta përdorim logjikën e "shqiponjës", atë "momen-

turnin" e saj kur ajo, në moshën "40 vjeçare", e bënë me fuqi e trimëri "reinkarnimin e dhimbshëm fizik" të trupit të saj! Çfarë dua të them? Se, duke mos e jetuar më tej "manualin" e robit, atëherë na duhet "sakrifica e shqiponjës"!

E kemi shumë më lehtë, absolutisht shumë më lehtë se shqiponja! Qysh e kemi më lehtë? Bie fjala, të mos sillemi si robi: me logjikën dhe filozofinë e tij. E para, të krijojmë 'sjellje dhe rregulla' brenda nesh që janë kompatible me shoqëritë e tjera, ato të përparruarat. Dhe kjo fillon nga dhomat e shtëpisë, aty ku jetojmë, pastaj nga oborri i shtëpisë, banesa, rruga, kafeneja etj. E dyta, pse të fillojmë nga këto celula jetese? Sepse, robi ka problem se si të sillet në shtëpi, në familje, në rrugë, në kafene etj. Pse robi ka probleme të këtilla? Sepse, ai e ngatërron konceptin e lirisë, i ngatërron ligjet natyrore me ato shoqërore, ligjet shoqërore me ato hyjinore etj. Qysh sillet njeriu si rob, ta zëmë në këtë kohë kur ka filluar mileniumi i tretë? Sillet edhe mirë, madje bashi si një rob: sepse ka problem t'i kuptojë normat dhe ligjet shoqërore, ato juridike, shtetërore. E para, nuk i paguan taksat, sepse ai kujton se ende jeton në kohën e sklavopronarisë dhe, këtë punë ia lë shtetit, ose ankohet te shteti! E dyta, s'kupton nga politika, sepse ende kujton se është në periudhën para shtetërore! E treta, kërkon gjithçka nga tjetri, nga shteti, ankohet, aktron, përbaltë, mashtron etj., dhe të gjitha këto manare e huqe i ka në mendje dhe instinkte, sepse s'ka pasur pronë të tij kurrë! E gjashtë, robi nuk lexon, e keqja më e madhe e tij, dhe ai gjykon se i mjafton një libër: e ai libër, është njëri prej librave të shenjtë! Pra, robi nuk e vlerëson librin, mendim dhe sjellja e tij më e shëmtuara e mundshme dhe kështu, ai nuk ka bibliotekë në shtëpi. E shtata, robi nuk i çmon të arriturat, institucionet, vlerat, cilësitë etj. Robi mjaf-tohet me bukën e përditshme, dhe me ditën që vjen nesër! E teta, robi beson se bota u krijua për shtatë ditë, dhe se në ditën e tetë, bota mund të shkatërrohet që nesër, prandaj ai mjaftohet me botën e përtjejmë...


E robi, në këtë rast raca jonë, ka probleme të mëdha të këtilla: qoftë nga trashëgimia e madhe e jetës nën robëri, dhe qoftë nga pasojat e mëdha të robërisë. Të dyja bashkë e përkufizojnë aktualitetin dhe kjo, më në fund, nuk është e turpshme të thuhet saktë. Robi nuk e pranon këtë "manual" dhe kërcen si zorra në prush, në kundërshtim të tij, por gjendja jonë e tregon të kundërtën...

SISTEMI POETIK I DRITERO AGOLLIT

Relacionet personale të poetit vinin qetë dhe natyrshëm në krijimet e tij, çka e bënte vargun më të pushtetshëm, më të ndjeshëm e më të prekshëm nga masa

Majlinda Nana RAMA

Kultura poetike e Agollit vjen si gradacion shpërthyse falë shenjimit të impulseve tropo-analogjike, që ai zoteron. Në këtë lëndë thelbësore, brenda dhe jashtëletrare, qëndron edhe dikotomia e individualitetit të tij, edhe shfaqja si forcë dhe zhvendosje, si i përvçëm dhe përgjithësues, por edhe si ndryshore e konjuguar që mban brenda saj shtypjen dhe vëllimin, konstaten sistematike dhe entropinë, grimcën e brendshme dhe potentialin e masës. Të lexosh veprën, përkatësish poetikën e Dritëro Agollit, është njësoj sikur të lexosh brendësinë e tij, të gjesht njeriun e rrallë dhe shpirtin human që zien atje tej, thellë në qenien njerëzore e krijuese agolliane. Fillim e fund, vepra e tij zbulon identitetin e tij, zbulon esencën, thelbin e paqen që atë e karakterizon. Njeri i mirë e poet i mirë. Një simbiozë e rrallëhasur te personalitetet e shquara të këtij kalibri. Çdo poezi e tij, çdo varg mbart me vete frutat e pjekura të mirësise së autorit dhe aty gjen mesazhin referuar dëshirës së tij të përkorë, për ta parë vendin të begatë dhe njerëzit të lumtur. Agoli është poet i madh i historisë sonë letrare shumëvjeçare, përgjatë dhe pas realizmit socialist; poet që i rezistoi kohës. Qysht në vitet e para të krijimtarisë poetike, ai solli një erë të re në letërsi, me forma krejtësish origjinale, duke u bërë kështu një ndër zérat kryesor të një brezi të ri krijuesish që u shfaqën në vitet '50-të të shekullit XX.



Poezia e Agollit i zgjeroi frymëmarrjen shtratit poetik të letërsisë shqipe, e cila deri në ato vite kishte njohur një skaletë të endur mes tradicionales, trajtave dhe formave standarde, folkut e retorikës së përsëritur herë pas here, pa harruar brendinë e ideologjizuar, ngushtimin e hapësirës poetike dhe ngjasimeve lehtësish të dallueshme mes autorëve të ndryshëm. Kështu, ai themeloi një vlerë të re, mes tabanit popullor dhe modernes, ndërtoi një tangente mes tyre dhe u bë derivat i kohës poetike. Agoli e pasur poezinë shqipe me fjalor të qëmputuar, me stil e me forma të pahasura më herët ose të preku-

ra sipërfaqshëm. Nuk kërkonte rrugë e shtigje të ndërlikuara e, për të nxjerrë unin krijues, ai lëvroi poezi të formatit "mendum i rëndë me fjalë tërësish të thjeshta". I formuar në Rusinë e ftotë e të largjet, Dritëro Agoli provoi se letërsia e një kombi kish si nevojë të parë, përpunimin e lëndës që vrujonte ndër shkuj nga mençuria e popullit dhe, për këtë "histori letrare" shfrytëzoi mirë elementet folkloristike, me domosdoshmérinë e formave të reja të shprehjes së modernitetit.

Letërsia e tij, edhe pse lindi dhe u zhvillua nën trysninë presuese dhe ngurtësise së socrealizmit, asnjëherë nuk humbi logjikën

e poezi së përbotshme, asaj poezie që lexohet qartë dhe mirë në çdo cep të kontinentit. Mendimi i thellë dhe diskursivja e kapçerën trungun e realizmit socialist apo ovacionet brohoritëse të kohës. Ai kalonte përtëj tyre. Egzistanca e individit zberthehet në dimensione të pandeshura më parë. Nëpërmjet filozofisë së qartë të përkufizimit karakterial, Agoli ka ditur të sjellë portretin njerëzor tërësish të gjallë, në gjithë dinamikën e vet. E nis nga vetja, për të mbërritur te vetënjohja e individit, një luftë e hershme dhe e pafund e mbarënjerezimit. Personazhet dhe tablotë e jetës së përditshme janë rruja e gjatë dhe e gjerë e poetikës së Agollit.

Dritëroi bashkudhëtonte me dhimbjen e çdo indi të kombit të tij, brenda vetes mbante aromën e Devollit, thjeshtësinë e komunikimit, ngjyrën e dheut, nuancat e dashurisë për njeriun dhe me këto shtroi udhën e madhe, duke bërë epokë të cilësuar, në letërsinë shqipe. Relacionet personale të poetit vinin qetë dhe natyrshëm në krijimet e tij, çka e bënte vargun më të pushtetshëm, më të ndjeshëm e më të prekshëm nga masa. Agoli do të rritej në një familje që e edukoi me leximin, duke e bërë atë këngëtarin e madh të këngëve të vendlindjes së tij. Ai e mori këtë këngë dhe e përsosi, duke i ngjitur pranë e pranë çdo pëllëmbë toke që i kish prekur këmba. Ajo koshere e vendit të tij do të kthehet universi në një pikë për poetin e madh.

Mbi poezinë e Nurie Emërlahut


KATARSIS SHPIRTËROR PËRTEJ ABSURDIT DHE REALES

Relacionet personale të poetit vinin qetë dhe natyrshëm në krijimet e tij, çka e bënte vargun më të pushtetshëm, më të ndjeshëm e më të prekshëm nga masa

Emrije KROSI

Modelet e gatshme poetike shpeshherë mbeten jashtë vetëdijes së poetit, duke kuptuar edhe distancën artistike në kontekst me komponentët dhe modelet verbale ose jo (në kuptimin intuitiv). Kumtimi dhe qasja ndaj poezi së ndodh në një moment kompleks, jashtë sferës së ligjërimit linear, si për poetin, ashtu edhe për interpretuesin (pra lexuesin), duke përcaktuar në mënyrë specifike edhe karakterin letrar intrasubjektiv (Culler: 1976). Analiza deduktive e një pozie përcaktohet nga: përshkrimi dhe papercaktimi i elementeve poetike, performanca dhe maksimalizimi i hapësirave shprehëse, aspektet e nevojshme të interpretimeve përtëj kodeve gjuhësore, karakterizimi i efekteve poetike aktuale, marrëdhënia e pavetëdijshme strukturore në ekuivalencat kohore të ndryshme. Efektet poetike dhe konteksti i prishmërisë së lexuesit përtëj "kornizave" ku konteksti historiko-kulturor dhe aspekti letrar-estetik, dominon mbi normat dhe vlerat, kur prek vetëm përqendrimin e mesazhit në poezinë "Gjurmë të gjethive" në librin "Për gjysmën tjeter të hënës" (Emërlahu: 2019):

Kthehem këtu për të gjetur
Por asgjë nuk mbeti pasi ti shkove.
Kthehem këtu për të ndjerë erën e duhanit mbi gushë.
Por asgjë nuk ka veç bishtash të vjetruar cigareje.
Kthehem këtu për të ta dëgjuar zërin
Po asgjë s'dëgjoj pos këtij uji
Që s'u ndal edhe pas ikjes sate.
Kthehem këtu për të gjetur
Dhe krejt çka gjejështë unë.
("Gjurmëve të gjethive")
Por, ana tjeter e variacionit kontekstual dhe shumëfishimi i kuptimeve është



invarianti racional, si bazë për kuptimet prej të cilave një shenjë e dhënë mund të dëshmojë në kontekstualizime të ndryshme përmes vargjeve: kthehem këtu për të gjetur/Por asgjë nuk mbeti pasi ti shkove./Kthehem këtu për të ndjerë erën e duhanit mbi gushë. Poezia mëton të sjell një realitet nga përditësia ku askush nuk është i përjashtuar, ku gjithkush është pjesë e realitetit të kotësise, absurdit dhe asgjës. Përsëritja katër (4) herë e vargut: [kthehem këtu] në formën e përsëritjeve dhe anaforës në rotrespektivë: në kthimin, ose tek kujtimet e fëmijërisë, në kthimin tek koha e shkuar, ose në kërkim të dashurisë së parë, pikërisht ky (ri)kthim, poezinë e përdor si katarsis shpirteror (Ajdini: 2021). Aty është përgjithësuar kuptimi, jo vetëm si emëruar i përbashkët i elementeve përquese të njësive stilistikore,

pa marrë parasysh çfarë ndryshimesh ose ndikimesh, përmes kanalesh semike, që mund të përdoren në ndërtimin e mesazheve. Çdo mesazh/shenjë si shumësi komplekse, përfshin elemente të cilat përsëriten, jo detyrimisht, ka njësi dhe elemente kuptimore të cilat komunikohen gjithmonë përmes mesazh-dhënies pavarësisht nëse janë një mënyrë "e nevojshme" apo jo, përmes të gjitha kategorive gjuhësore, më përtëj "trillimeve mimetike", në fikcionin (art real), fikcionet gjuhësore supozojnë një rol të rëndësishëm të gjuhës së përditshmërisë, në lidhje indirekte me të gjitha kategoritë jashtëgjuhësore (Frye: 1957). Përmes vargjeve: por asgjë nuk ka veç bishtash të vjetruar cigareje./ Kthehem këtu për të dëgjuar zërin/Po asgjë s'dëgjoj pos këtij uji gjetja individuale e metaforës së cigares,

aspak krahasim apo ndonjë trop tjetër gjuhësor, përpos cigares si mbetje e veprimit njerëzor të stresuar, të vëtmuar, të frustruar, të nervozuar e bën "veprimi" përmes foljes [kthehem] një esteitezim vepror të realitetit të ashpër vendor, ku poetja derdh edhe pensimizmin e saj, duke lëvizur edhe lexuesin ndaj fenomeneve negative të shoqërisë, ku vetë veprimi në poezi "gris" shpresën për të nesërmen (Aliu: 2021). Mbështetur te modelet, modeli dhe mënyra përmes vlerave poetike, jo vetëm si konstrukt kulturor, por edhe aq si performancë individuale, e lirikës së subjektivitetit/ vëtërefleksivizmit nuk dëgjohet një "unë" e vëtmuar sepse vargjet: që s'u ndal edhe pas ikjes sate./Kthehem këtu për të gjetur/Dhe krejt çka gjejështë unë, ajo gjen aty "Uni-n" poetik duke "kërkuar Uni-n" e saj individual, jo vetëm si proces letrar, por edhe në atë lloj shpirshëmëri përtë artikuluar rrënjen e saj etnike, në gjithë hapësirën dhe dinamikën e jetës dhe kohës që lëviz poezia. Paradigmat lirike, nuk përcaktohen në bazë të ndarjes së modelit logjik (Einarsson: 2012), ku analogjia është e fshehur përmes fenomeneve të vetëdijes dhe përvjoses, përmes mëtimit të një modelli të quartë shkrimit, dëshmon modelin e ndërsjellët të një poezi të "zhveshur" nga tepricat me parimin se në letërsi: gjérat e vogla shihen si të mëdha, gjérat e errëta shihen si të ndritshme.

Sëfundmi: poezia e Nurie Emërlahut është poezi me "gjurmë" individualiste, me motive të ngrrohta nga rrëthinat e vendlindjes së saj. E pagëzuar me AND-në e kodit gjenetik të poezi së një poete relativisht e re në moshë, dëshmon për një nivel të lartë artistik dhe të konkurueshëm mes poetëve/ve të RMV, ajo tashmë ka një vend në shkallinat e poezi së moderne dhe postmoderne gjithëshqiptare.

KUJTESA I LETRARE SI DËSHMI E NJË KOHE

(Arif Molliqi, "Arkivi i letrave të djegura", roman, botues "Armagedoni", Prishtinë, 2022)

Dr. Emin Z. EMINI


I mbrumur me imagjinatë krijuese, romani "Arkivi i letrave të djegura" i Arif Molliqit provon të krijojë një kujtesë letrare për Kosovën e pasluftës. Pavarësisht se autor i mbështet në copëra dëshmish e ngjarjesh të jetuara nga vetë ai, të cilat romanit i jep dimensionin autobiografik, dhe pavarësisht se shkrimtari thirret në disa dokumente dhe faktë jetësore, të cilat romanit i jep elementin e dokumentaritetit, struktura rrëfimtare romanore, para së gjithash, s'është veçse një krijesë mirëfilli letrare, e cila mëton të kthehet vetë si e tillë në një dokument arkivor, për pothuaj të gjitha segmentet e jetës shoqërore, politike, sociologjike, kulturologjike e psikologjike. Kjo, madje, na sugjerohet që në titullin e romanit, sepse duke qenë të djegura letrat e arkivit, shkrimtarit Mulliqi i duhet t'i krijojë ato letra të munguara, t'i krijojë ato dëshmi e dosje të djegura e tashmë joekzistente dhe, kështu, nëpërmjet procesit artistik, të krijojë një arkiv letrar, në rastin konkret për një qytet dhe jo vetëm, të Rrafshit të Dukagjinit, për epokë të caktuar të historisë sonë dhe për njerëzit e këtij nënqelli.

E dyta, edhe pse shkrimtari thirret në disa dosje të gjetura në arkivin e qytetit, duke qenë se ato janë gjysmake, janë ca letra të mykura e gjysmë të kalbura, të palexueshme e të papërdorshme, sikundër edhe në rastet kur thirret, fjalë vjen, në disa fletëza ditari, për ta ndërfutur njësinë e faktografisë e të dokumentaritetit, elemente këto që i gjemjë në përbajtjen dhe strukturën e ramanit, s'janë veçse mjete artistike për të ndërthetur e shtruar rrjedhën fabulare dhe, shi kështu, pra sipas këtij procedeu, përt'i ndërfutur në veprime korrelative personazhet e "Arkivit".

E treta, kur flasim për personazhet, kutoj ata, po ashtu s'janë veçse qenie imagjinare të krijuara sipas modelit të personazheve jetësore, të njojur e të panjohur edhe nga vetë autor i romanit, e të cilët prandaj, për aq sa janë imagjinare, për aq janë dhe personazhe të realitetit jetësor.

E katërt, ashtu siç antropominë që në disa e gjemjë të jetë konkrete në raport me realitetin jetësor, ashtu edhe toponimia (emrat e qyteteve) dhe oronimia (emrat e maleve, fushave, bjeshkëve etj) vijnë domosdoshmërisht si njësi faktike romanore, përfshirë këtu edhe patronimet.

Prozatori Molliqi, sipas prizmit vetjak autorial, por edhe sipas rrëfimeve e historike të të tjerëve nëpërmjet romanit "Arkivi..." synon për ta krijuar dhe ruajtur artistikisht kujtesën tonë kolektive. Kështu, autor i merr rol të dyfishtë në veprën e tij: shkrimtari i cili në roman është shkrimtari që provon të shkruar një pjesë të "biografisë" së qytetit dhe njerëzve të tij dhe është narratori i cili rrëfen në veten e parë. Duke e ndjekur këtë stil krijues, shkrimtari Molliqi ndërron dy linja paralele rrëfimtare: e para është ajo që lidhet drejtë drejt me temën e romanit, pra me nxjerrjen në dritë të të vërtetës së ndaluar në të gjitha dimisionet e saj dhe linja e dytë që e ndjek si hija drithën e së parës, është ajo që ka të bëjë me temën e dashurisë, e cila na vjen nga retrospektiva si një peng, si dashuri e



pambuaruar, si një imazh i burur, si një kujtim i dhembshur e si një erë e mirë e një kohe të ikur e të pakthyeshme, por që ka ngelur përfjetësish tiku në arkivin e shpirtit të personazhit shkrimtar dhe narrator njëkohësisht. Prandaj dhe, emri i ish-të dashurës si personazh është Erëmirë. Kundruar nga ky aspekt, Erëmira duke dalë nga arkivi i shpirtit të protagonistit s'ka si të mos jetë prandaj, grua e cila punon në arkiv. Gjetja rrëfimtare me dy linja strukturore, pra shkrimi i analave të qytetit nga ca letra të djegura arkivore të një arkivi të djegur në njérën anë dhe, dashuria e rigjetur në arkivin e shpirtit njerëzor në anën tjetër, i jep romanit vlerë të veçantë artistike e estetike. Prandaj, romanii Arkivi i letrave të djegura është një shenjë letrare, nëpërmjet të së cilës dëshmohet se kujtesa e gjallë, kujtesa që ruhet në shpirtin e njeriut si individ a në shpirtin e kolektivitetit është i vetmi arkiv që nuk humbet është arkiv të cilin as ka flakë, as zjarr që mund ta djeg e ta zhbjë. Po pse pra, duke qenë kështu, protagonisti i romanit ndihet i kërcënuar nga misioni i tij, pse pengohet në mënyra e forma të ndryshme që të mos zbulojë atë që kishte ndodhur dikur, ose shto këtu edhe pyjeten, pse para tij, edhe Profesori D, personazh tjetër i këtij romanit, që ishte marrë me hulumtimin e arkivit, ishte detyruar ta braktisë këtë mision shkaku i

kërcënimit e frikësimit nga dora e pushtet dhe e njerëzve që rrin nën hijen e tij?

Sepse, me këtë shkrimtari do të na dëshmojë e rikonfirmojë se për aq sa është e rëndësishme për një etnikum që qenien e tij shpirtërore e materiale ta ruaj të gjallësi kujtesë kolektive në arkën e shpirtit, po aq është e rëndësishme të ruhen dokumentet e dosjet origjinale që shënjanë një ngjarje, një epokë, një të të vërtetë, e cila, në rastet kur nuk duhet të jetë publike, si e tillë duhet të klasifikohet, të mbyllët e të ruhet me çdo kusht, aty ku e ka vendin: në arkiv. Prandaj, frikësimi, shantazhimi, kërcënim i personazheve në roman na vjen si produkt i vetëdijes shtetërore për arkivistiken zyrtare, ani pse, shteti, në kohën kur është vendosur ngjarja, s'është veçse, siç thotë autor, nëpërmjet Bardhit "shtet në dorëshkrim" (fq. 32).

Dorëshkrimi i romanit të personazhit shkrimtar rrëzikon të mos kryhet asnjëherë sepse interesimi i tij për të nxjerë në dritë disa nga protagonistët e kohës dhe bashkë me ta edhe veprimet e tyre politike në cilësinë e strukturave përgjegjëse, qoftë të paraluftës, qoftë të pasluftës në Kosovë, mund të shërbijnë si dëshmi të gjalla, për të bërat e dëmshme e ndonjëherë fatale në kurriz të atdheut e të popullit. Po kështu, nëpërmjet dëshmimit, autor i jo vetëm që provon ta ndajë e spastrojë të mirën nga e keqja, ta harr

terrenin e ndërgjegjes si imedicion për ngritjen e vetëdijes kombëtare, por dhe brenda këtij segmenti, natyrshëm ndërron hapin pasues e që vjen si kërkesë për t'i thirrur në përgjegjësi të gjithë ata që kanë hapur plagë e kanë shkaktuar pasoja të pariparueshme ndonjëherë. Skena të tilla në roman janë, fjalë vjen shkuarja e disa shqiptarëve e shqipfolësve, me a pa vetëdije, me hatër a me zor në mitingjet e kasapit të Ballkanit, S. Millosheviqit, në të cilat kërkohet shfarosja e popujve të ndryshëm të ish-Jugosllavisë dhe, veçanërisht e shqiptarëve përtë bërë Serbinë e Madhe, apo pas luftës, bateja për tjetësimin e historisë së Manastirit të Deçanit, së cilat Gjykata Kushtetuese jo vetëm që ia fali me dorën e vet qindra hektarë tokë, por ia dha edhe të drejtën që, citat: "të merrte qellin, aqrin, shiun, diellin dhe hënën, çdo gjë që i takonte qytezës rrëzë bjeshkës" (fq. 53).


Struktura narrative e romanit "Arkivi i letrave të djegura", nëpërmjet ndërtimit pjesë-pjesë të ngjarjeve të periudhave të ndryshme historike, në aspektin e shtrirjes kohore nis nga ditët e sotme dhe lëshohet deri në Betejën e Parë të Kosovës, të vitit 1939, batejë të cilën popujt e Ballkanit e kanë humbur nga Perandoria Osmane, por që serbët e kanë përvetësuar si të ishte sall e tyre. Ashtu siç përvetësimi është falsifikim flagrant i historisë, ashtu dhe festimi i humbjes së betejës nga ana e serbëve janë veprime politike, me anë të së cilave provojnë të dëshmojnë e dokumentojnë se këto treva historikisht iu takojnë atyre. Pra, serbët duan të arkivojnë në shpirtin e popullit dhe në arkivin e shtetit e të kishës gjenjeshtrën e tyre, e cila s'është tjetër pos mjet politik për gllabërimin e asaj që asnjëherë nuk ka qenë e tyre. Manastiri i Deçanit dhe sjellja politike e institucioneve politike e religioze serbe, por edhe e politikanëve të pasluftës e edhe e institucioneve juridike të Kosovës, janë strumbullari, janë dhembja dhe pika neuralgjike e romanit "Arkivi i letrave të djegura" të A. Molliqit. Prandaj arkivat digjen. Digjen arkivat gjithandje edhe në Kosovë, jo vetëm gjatë luftës por edhe pas saj, për çka thirret të hetohet në prokurorinë e shtetit protagonisti i romanit "Arkivi i letrave të djegura".

Nëpër hetuesi e burgje, një pjesë të jetës e ka kaluar edhe Profesori D, i akuzuar se ka pasur lidhje dhe se i ka këshilluar studentët demonstруes, të cilët atëbotë kanë kërkuar të drejtat e tyre dhe avancimin e statusit politik të Kosovës. Histori të ndryshme e copëza biografish të personazheve të romanit "Arkivi..." shpalosen herë pas herë gjatë gjithë zhvillimit të ngjarjes dhe kështu shkrimtari Molliqi ndërron një strukturë narrative me tipare mozaiku, me situata dramatike, ndonjëherë të spërkatura dhe me një tis të hollë të humorit e sarkazmit e të cilat i ndërlidh sipas rastit dhe nevojës.

Romanii "Arkivi i letrave të djegura" ka elemente biografike të autorit dhe dëshmi e fakte të cilat i jep ngjyrin e një roman dokumentar e të cilat, si të thuash, vijnë nga leximi i "kutisë së zezë" të arkivit, pas dëgjies së tij. Nëpërfundimisht, përkundër se autor i ka lexuar "kutinë e zezë" të arkivit të djegur, ai e shkruan një arkiv me kuti shumëngjyrëske.

NJOHURI TË REJA PËR VEPRËN E SANTORIT

Akademie e Studimeve Albanologjike - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, hedhin në qarkullim "Franqisk A. Santori dhe trashëgimia gjuhësore e letrare shqipe" – Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare. Tiranë, 2022



Merita Sauku BRUCI

Viti 2019 shënoi një përvjetor të rëndë-sishëm dhe një ngjarje të shënuar për historinë e gjuhës dhe letërsisë shqipe: 200-vjetorin e lindjes së Franqisk Anton Santorit (Picili), 16 shtator 1819 - Shën Japk, 7 shtator 1894). Personaliteti njerëzor e letrar i Santorit, në gjallje e gati një shekull e gjysmë pas kalimit të tij në arsimshim vazhdon të endet mes kujtesës dhe harresës, mes simpative dhe antipative, mes vlerësimeve dhe paragjykimeve, mes përshtatjeve dhe respektimit të vullnetit të tij aitorial, mes njohjes dhe mosnjohjes. Ky botim i akteve të Konferencës Shkencore Ndërkontinentale me temë: FRANQISK A SANTORI DHE

TRASHËGIMIA GJUHËSORE E LETRARE SHQIPE, organizuar Institut i Gjuhësësë dhe i Letërsisë (ASA) në dhjetor të 2019 sjell të dhëna të zgjeruara mbi atë çka njihet e mbetet për tu rjojur nga krijimtaria e Santorit, rrugën për të depërtuar e pacenuar filologjikisht tek lexuesi (Bruci); mbi vendin e Santorit në letërsinë arbëreshe e shqipe, mbi aspektin social dhe të angazhuar, që ajo shfaq me Autorin tonë, për të cilin arti letrar nuk është vetëm një kërkim i pastër formal; në thelb të tij qëndron impenjimi social për të qenë zëri real karakterizues i personazheve dhe mesazheve që autori dëshiron të japë (Fortino); mbi të dhëna të reja e të panjohura deri më sot për biografinë dhe për jetën e Santorit pas vittit 1860, njeniut e shkrimtarit që kurrë nuk u vepromovua dhe as vepromovoi veprën e tij (Belluscio); mbi shfaqjen e një aspekti pak të studiuar të Santorit, atë të angazhimit social e politik dhe kushtet historike që paraprinë krijimin dhe botimin e himnit Valle harës madhe (Parise); mbi vendin e Santorit ndë mend të popullit (Golemmi).

Ky botim ofron këndvështrime interesante në rrafshin letrar: krijimi i një universi poetik ku bashkohet një vizion i tërë gjithpërfshtirës: dielli, hëna, yjet, tokat - njëherësh si trup qjellor dhe si bazamenti ku gjallojnë mikrokozmoset njerëzore (Smaqi); rileximi në vijimësi i veprës së Santorit rikuptimësi i mesazheve të përçuara përmes saj dhe vlerësimi sérish i vendit të tij në historinë e letërsisë në gjuhën shqipe (Plangarica); shqyrtimi i rapsodive santoriane, i elementeve të ngjashme ose të njëjtë, si dhe përputhjet e tyre me personazhet e Eposit Heroik Shqiptar (Neziri); lëvrimi i "tokave të virgjëra" në letërsinë shqiptare dhe pasurimi i letërsisë arbëreshe dhe shqiptare me gjininë e dramaturgjisë me të cilën Santori i prin zhvillimit të gjinisë në fjalë në atdheun e origjinës (Kodra); rëndësia e romanzenzove në kundrin e vepërës së Santorit dhe të

letërsisë arbëreshe dhe zgjedhjen e ndërgjegjshme që autor i arbëresh bëri me lëvrimin e kësaj gjinje për të komunikuar me lexuesin (Çali); pasurimi i trashëgimisë shkrimore mbi tekstin biblik në arbërishtet dhe shqyrtimi i një arsenali burimor të këngëve fetare dhe të himneve themelore në liturgjinë e krishterë në variantet e ofruara nga A. Santori (Paci); vendosja e përrallézave të Santorit, si njëri prej autorëve më të hershëm dhe më origjinalë në përkthimin, rimodelimin dhe krijimin e fabulës në letërsinë shqipe, brenda marrëdhënieve strukturore dhe tipologjike (Leka).

Drejtimin leksikologji, semantikë e kritikë letrete studiuesit na njeh me: disa fusha fabulat e përkthyera a përpunuara nga Santori të cilat na mundësojnë të njohim jo vetëm evolucionin e gjuhës shqipe [arbërishtes], normat dhe doket kulturore të një diasporë historike por edhe statusin e jetësinë e pasurisë së saj leksikore, sintaksore, e mjeteve të shprehjes poetike - përkrah disa gjuhëve europiane (Lamaj); studimin e vargjeve satirike nga këndvështrimi leksiko-semantic, referuar veçanërisht neologizmave të krijuara nga Santori, të veshura me ngjyresë kuptimore të kushtëzuara nga konteksti humoristik (Kume); mënyrat e vështrimit, metodat e përdorura dhe nivelet e interpretimit nga kritika letrare shqiptare për të analizuar veprën e Santorit dhe risitë që ajo ka sjellë (Gugu). Megjithëse ky botim po del me pak shkëputje kohore për shkaqe objektivisht të njohura, kemi bindjen se ai plotëson dhe ndriçon në shumë aspekte figurën e Franqisk Anton Santorit dhe do t'u vijë në ndihmë studiuesve, historianëve të letërsisë shqipe, hartuesve të teksteve të letërsisë, pedagogëve, studentëve, nxënësve apo edhe lexuesve të interesuar. Jo më kot në këtë botim janë përfshirë me synim pasurues edhe ilustrime të përzgjedhura nga pena e Santorit, brendashkruar kumtesave apo ndërmjet tyre, si një kontakt i drejtëpërdrejtë me autorin dhe plotësim i argumenteve të

botën e dashurisë, leksiku i botës së luftës, leksiku fetar, leksiku etnokulturor, leksiku i gatimtarisë, etnobotanizmat, etnozoologjizmat si edhe dukuri të fjälëformimit dhe ato të sistemësës në fjälëformim që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me këto fusha (Memisha); përpjekjen e vetëdijshme e të suksesshme për krijimin e një arbërishtëje tej caqeve të të folmeve vendore, e cila ngërthen ndërkaq edhe elemente të traditës librore përqendruar në vendin, rolin dhe përdorimin stilistik e si burim neologizmash i greqizmave në veprën e Santorit (Qirjazi); fabulat e përkthyera a përpunuara nga Santori të cilat na mundësojnë të njohim jo vetëm evolucionin e gjuhës shqipe [arbërishtes], normat dhe doket kulturore të një diaspore historike por edhe statusin e jetësinë e pasurisë së saj leksikore, sintaksore, e mjeteve të shprehjes poetike - përkrah disa gjuhëve europiane (Lamaj); studimin e vargjeve satirike nga këndvështrimi leksiko-semantic, referuar veçanërisht neologizmave të krijuara nga Santori, të veshura me ngjyresë kuptimore të kushtëzuara nga konteksti humoristik (Kume); mënyrat e vështrimit metodat e përdorura dhe nivelet e interpretimit nga kritika letrare shqiptare për të analizuar veprën e Santorit dhe risitë që ajo ka sjellë (Gugu). Megjithëse ky botim po del me pak shkëputje kohore për shkaqe objektivisht të njoitura, kemi bindjen se ai plotëson dhe ndriçon në shumë aspekte figurën e Franqisk Anton Santorit dhe do t'u vijë në ndihmë studiuesve, historianëve të letërsisë shqipe, hartuesve të teksteve të letërsisë, pedagogëve, studentëve, nxënësve apo edhe lexuesve të interesuar. Jo më kot në këtë botim janë përfshirë me synim pasurues edhe ilustrime të përzgjedhura nga pena e Santorit, brendashkruar kumtesave apo ndërmjet tyre, si një kontakt i drejtëpërdrejtë me autorin dhe plotësim i argumenteve të traituara në kumtime.

Rilexime

NJË NDJESHMËRI E PANGATËRRUESHME

(Rreth romani "TRANS" të Dashnor Kokonozit)

Keti DIBRA

Të kesh sensin e masës, të jesh i vërtetë e bindës kur trajton jetën me ngjarje të një periudhe delikate të historisë së vendit, që ka kanë lënë shenjë, éshtë meritë. Kjo vërehet menjëherë te romani "Trans".

Jenëre të romanit Trans .
Ndonëse romani nuk është një roman historik, ai jep qartë ngjarje, që do të qartësonin edhe kë nuk e jetoi atë periudhë të vështirë me tërë ankthi, dramën e pasigurinë që kaloi vendi vnpë .

Në roman është dhënë krejt qartë
mashrimi e nëpërkëmbja që iu bë
popullrit në atë vit të mbërapshtë të
'97-tës.

Një "organizim" qëllimkeq e shkatërrues i vlerave materiale dhe atyre shpirtërore, të një populli që sapo kishte dalë nga një vatféri e tejskajshme. Tani vihej në lojë edhe ijetë e tij.

Mjeruese dhe e dyshimtë!
Pse u bë? Si erdhi? Kush e solli? Pse

nuk pati një NDAL?!
Cilat forca politike e kishin dashur
një shkatërrim të tillë?


Në roman thuhet qartë se një popull tē lodhur, tē vuajtur e tē paditur eshtë shumë e lehtë ta gënjenesh e ta flakësh si leckë.

Me syrin e vëzhguesit, autori vë në
teh të ironisë se tij kryetarin e shtetit, i
cili këmbëngulshëm nuk pranonte të
shihte atë gjendje tejet të rënduar, të
një konflikti alarmant, në zgripet e
gjakderdhjes, por i kapur me thonj e
me dhëmbë pas kolktukut të tij, nuk
pranonte humbjen, megjithëse shtetit i
shihei shpërbëria.

Pasi ka dhënë ngjethshëm shpërtyrimin, deri në shtazëri të bandave kriminale, që u krijuan duke shfrytëzuar anarkinë ku kishte rene vendi, autori vë në qendër të këtij ngërçi tëre hipokrizinë e trupës se korrespondentëve të huaj të cilët me cinizëm të paturshëm kishin ardhë pér të përcjellë scoop-e publicitare.

E téré réndesa e ngjarjeve dritëson përmes personazhit të Nikos, i cili është vrojtuesi dhe bartësi i atij tensioni dramatik, qe po kalonte vendi atyre ditëve të vështira. Me Nikon, autori jep përshkallëzimin e rrënimit te mbare vendit. Ai sheh, dëgjon, ndien, vuan dhe pëson. Niko është bartësi tek i cili përplasët tere përbysja sociale e morale e një populli e bashkë me to, rrënimini i tij psikologjik e

Sepse, dramat e mëdha sociale sjellin dhe dramat e forta personale, deri në shkatërrim.



TË VRASIN SHOKËT SE U BËN HIJE

Në letrën amanet nuk përshfaqet vetëm drama e një shkrimtari, i cili kërkon shpëtim tek vdekja, si një shans të fundit që fati i jep për të lehtësuar familjen, por drama e secilit prej nesh

Fatbardh AMARUSI

Në kohën kur, me demek: shkruheshin letra të hapura, letra nga populli, në fakt, ishin ato anonimet që bënin kërdinë apo ekspertizat. Në botën e artit, letrat e shkrimtarëve dhe artistëve janë tjetër gjë, ato zjojnë interes, kthehen në objekt kërkimesh e studimesh, ndaj në botimin e veprave të plota përfshihen dhe korrespondentat. Në vështrimin tim, letra testament, që Mitrush Kuteli i la së shoqes, Efterpit, edhe pse është bërë publike, nuk ka marrë vëmendjen e duhur, ndoshta ngaqë shihet si një letër familjare. Pavarësisht se i drejtohet së shoqes, e pakuptimtë që një burrë t'i rrëfejë gruas jetën e tij në një letër lamtumire, në fakt, ai i drejtohet bashkëkohësve dhe brezave që vijnë. Ka ndodhur e kundërt, që, gra shkrimtarësh dhe artistësh, kanë shkruar monografi për burrat e tyre, sikurse dhe rasti i Helena Kadaresë me librin "Kohë e pam-jafueshme" kushtuar të shoqit. Letra testament e Kutelit ka për të mbetur një dëshmi tronditëse, e cila vazhdimit do provokojë nevojën për reflektim në mjediset artistike, se për katarsis as që bëhet fjalë. ("Vetëm të vdekurit pendohen", do thoshte Skënder Mehmet Buçpapaj.) Në letrën amanet nuk përshfaqet vetëm drama e një shkrimtari, i cili kërkon shpëtim tek vdekja, si një shans të fundit që fati i jep për të lehtësuar familjen, por drama e secilit prej nesh, thënë me fjalët e shkrimtares ruso-amerikane Ayn Rand: "Sa e sa vriten pa ditur se kush i vret." (Më parë se të shpikej arma me selinciator, ishte "komploti i heshtjes", që vriste.) Mjerë kujt i qëllon të vritet prej atij o prej atyre, që hiqen si viktima. Qoftë dhe një viktimi reale, e cila perse-kutorin e konturon me ftyrën tënë. Atij apo të atyre, që të vrasin natën dhe të qajnë ditën dhe fajin ia vënë lotëve të krokodilit. Të atillëve, që, të heqin stolin duke të ofruar me gjasa piedestalin. Të zhulsave, që hapin gropën skeptike, ngaqë qelbin vetë.

Më parë se Kuteli të shkruante letrën amanet, i kushton gruas poezinë me titull "Sime shoqe". "Kaq afër jemi, por kaq larg/Të lutem mos më prit!/Na ndajnë terre rrëth e qark/Dhe yll përmua s'ndrit./Përse ta lidhësh fatin tënd/Me një pafat si unë./Kur di se emri im u shemb/Me dhunë e me përdhunë?" Një emër i shembur me dhunë e përdhunë, por, prej kujt? Për të marrë përgjigjen lexojmë në letrën testament, ku shkrimtari i drejtohet me gjasa së shoqes: "Fëmijët i porosat ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret. Atalanta dhe Pandeliu kanë prirje për letërsi. Le të mbarojnë studimet në ndonjë degë praktike: ajo Fizikë, ay Mjekësi ose ndonjë fakultet tjetër, fjalë vjen, për arsimtar, dhe le të merren edhe me letërsi. Por jo si profesion kryesor. Profesionizmi në letërsi, në vendin tonë, është, hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s'di marifete dhe hipokrizira. Terreni i letërsisë është një tokë tek gëlojnë gjarpërinjtë. Të vrasin shokët, se u bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi." Dihet që hije ka i talentuar, ndaj i turren profilet



folco për tia rrëzuar imazhin, emrin e mirë, sikurse vjeshta rrëzon hijen e lisave. Këta që kanë gjynahë për të larë, erinitë e fateve tona, që s'na lanë të ngrinim kokë dje e kanë për kollaj të thonë se Mitrush Kutelin e vras regjimi. (Kur u krijuar Qeveria e Durrës, Asdrani, kthehet në atdhe me idenë për të kontribuar, por, atdhetarit iu refuzuan shërbimet dhe ai në dëshpërim shkroi poezinë "Çpérblimi". Kryengritësi: "Vij të ndaj fitoren me ju." Paria: "Kush është ay që sot guxon pa leje./na prish dhe prehjen./jetën plot dëfime?/Largojeni se vjen lart e na bën hije!" Kështu që lart nuk ka vend për kryengritësit, inkonformistët, mendjehapurit, novatorët, vizionarët, duke e kthyer meritokracinë në një dekoratë e dhënë pas vdekjes. Pratë hijen e vet?)

Në pritej të vdekjes Mitrush Kuteli shkruan: "Mendjen e kam të turbullt nga pagjumësia, nga èndrrat e këqija. Sikur më ndiqnin gjermanët, që të më varnin. Iknja me vrap, hynja në gropë e puse, dilnja prapë. Fundja u gjenda i ndjekur nga njerëzit tanë... prapë gropë, puse, gremina." I ndjekur e i përndjekur nga armiq e miq, gjermanë e partizanë. I padëshirueshmë për të gjithë. (Thuhet se në kënetën e Maliqit për ta turpëruar e kishin futur në një gropë të gjallë. Mbështetja kjo duhet të jetë arsyaja që ai vazhdimit do përmend fjalen "gropë". Por, vajza e tij Atalanta Pasko, shfaq rezerva për këtë histori poshtërimi. "Edhe kjo është një tjetër histori që ka shumë shtresa... Në atë ceremoni ku mori pjesë dhe z. Tusha (dëshmimtari i historisë) ishin gazetarët që e pyetën, duke i bërë pyetje nga më të çuditishmet, dhe ai edhe pse nuk mbante mend shumë detaje, kur u pyet se si e kishin futur të veshur apo të zhveshur në

gropë, ai u përgjigj të zhveshur. Nuk merr mendja që ka qenë kështu. Më pas kjo u tjerr gjatë nga mediat dhe iu dhanë ngjyra që nuk i kishte si ngjarje." Mesa duket gropaxhinjëve, që ia nxin jetën, u ka interesuar ky version, për të larguar vëmendjen nga bëmat e veta.) Ja dhe vargjet dëshpëruese që kanë shoqëruar dhembjen e shkrimtarit: "Më di a nuk më di se qaj,/më di a nuk më di se vuaj/në orët e thella të natës./kur ngrihem i çmendur të shkruaj/me gjakun e zemrës të shkruaj." Dhe kur qan burri, gjëma është e madhe.

Vazhdon rrëfimi ku èndrra metaforike kthehet në zhgandë: "Kisha shpëtar nga ndjekjet dhe kërkonja ndonjë shtëpi për t'u fshehur. Isha i zbathur, i zveshur. Dikush më thirri: "Qëndro, Dhimitri (Pasko)! Të zumë". Më rrethuan, më zunë dhe po më shpinin të më vrisnin. Unë qeshnja. Kisha qejf të më vrisnin!" Nga të gjitha vdekjet, ajo që ka helmuar shpirtin e tij: është vrasja e shokëve që u bën hije. "Dhe ja, u gjenda në burg. Shumë njerëz. Midis tyre Sofo Çomorra, që ka vdekur. Më shikonte me dhembje. "Si u bë kështu, o Pasko! Ç'ke bërë?" "S'di", "Shiko këtu". Dhe më dha ca shkresa të shkruara bukur: një akt akuzë dhe ca lidhje të tjera. Më quanin bejtexhi. Më thoshin se kisha bërë një vjershë përglyrën me rima italiane." Këta të sotmit të thonë mediokër, ke shkruar për partinë, socializmin, diktatorin, duke kërkuar rrënjet e shkrimtarit si e si të largojnë vëmendjen nga fijet e tyre, që një zot e di, se ku e kanë tezgjahun. (Trashëgimtarët thonë se Dhimitër Shuteriqi ka bërë "një shpifje ahistorike" për Kutelin, si anëtar i Rojës së Hekurt në fashizmin rumun dhe se ka shkuar të luftojë në Stalingrad. (Heroit

ynë Kombëtar në krye të ushtrisë osmane u nis për të mundur Huniadin.) "Me këtë rast dua të shtoj këtu se me kaq fuqi më pat zotëruar dikur verbi i Taras Shevchenko-s sa kisha filluar t'i përvishem-me ndihmën e një fjalori dhe të një miku-përkthimit të disa vjershave të tija në gjuhën rumune. Kjo ngjante në parnverën e vittit 1942, në qytetin Cernauti të Bukovinës, ku dëgjohet edhe ukrainishtja edhe ku një rrugë mban, që në kohën e Austrisë, emrin e poetit"-dëshmon Kuteli, i mobilizuar nga gjermanët si specialist, në atë kohë drejtor banke në Bukuresht të Rumanisë, jo me uniformë ushtari për në Stalingrad.) "Jam shkëputur e kam ikur shumë herë/Nga vendi im për në vende të largët./Për një mot, për shumë vjet, përgjithënjë.../Dhe jam kthyer rishtas e rishtas/Në çerdhen time./Nën qellin tonë të lehtë./Në ajrin e tejdukshëm./Se malli i madh më digjte.../Por kësaj here-më falni./Do ik e s'do kthehem më."-janë vargjet që para-lajmërojnë ikjen e tij nga kjo botë, ku gëlonin gjarpërinjtë dhe ti ishe i detyruar të haje "bukën e hidhur".

Rrëfimi në letrën amanet vazhdon duke krijuar një kontrast me korrupsionin dhe hajdutinë e sotme, ku pushtetarë të lartë akuzohen për vjedhje të florit të Bankës së Shqipërisë dhe, si i tillë, ai përsëri mbetet i padëshirueshëm: "Disa njerëz i dinë përpjekjet e mia kundër kapitalit italian, kundër grabitjeve gjermane. Kam punuar pa interes vetiak. Nuk kam ndjekur kurrë pasurimin tim, sepse ky pasurim mund të bëhej vetëm me dy mjete: me vjedhje (ka njëmijë e një mënyra vjedhje dhe unë s'kam përdorur asnjëren) dhe me tradhti, duke u shërbyer të huajve për të grabitur vendin dhe duke marrë për këtë shpërbirim. Zgjodha rrugën e kundërt: luftën kundër grabitjeve italiane, kundër grabitjeve gjermane, kundër grabitjeve jugosllave. Nuk zgjodha kurrë udhën e rehabilitat vetjak, udhën e "urtë e butë e lugën plot". Ndaj e bija, Atalanta, në një intervistë sqaron: "Ai nuk pranoi që të vinte firmën në një kurs këmbimi që nuk ishte real. Leku nga lufta doli i fuqishëm, sepse në Shqipëri kishte materiale ndërtimi dhe mall, kurse dinari ishte shumë i dobët. Qeveria dante që të firmoste një shkresë që ishte kundër vendit. Por ky nuk ishte precedent i tij i parë. Edhe gjatë pushtimit nazist ai krioi një rast gati sabotimi financiar, aq sa Gjermania nuk arriti të bënte monedhën e pushtimit. Pas kësaj ai iku nga puna atje, por nuk doli në mal me pushkë në krahë, shkoi në zonat e çliruara, ku ndihmoi për çështjet e financës qeverinë e Beratit." Kur punonte në Bankën e Shqipërisë, dikush e gjen në zyrë me këmbët ngritur në tavolinë, ngaqë i mpleshin. Kështu rrinë amerikanët i thotë me të qeshur shokut, i cili e denoncon. Zili do ngjallte dhe orendimi i shtëpisë me gusto, që për kohën të merrej se bëje jetë borgjezi. Letra testament që Kuteli shkroi teksta priste vdekjen ta merrte, nuk i drejtohet së shoqes, Efterpit, por shoqërisë shqiptare të së djeshmes, të sotmes dhe të asaj që do të vijë, për të kuptuar pse vuan ky vend, i cili: kundrejt njeriut që i duhet zgjedh atë që i prish punë. As të qenët patriot, as i ndershëm, as i talentuar nuk i patën duk, edhe pse sot në sheshin e qytetit të Pogradecit ngrijhet monumenti i tij.

NJERËZ ME ZEMËR TERRI

"Në paqe djemt varrosin baballarët e tyre, në luftë etërit varrosin bijtë."

(Herodotus (484 – 425 BCE), The Histories [Book 1, Chapter 87, section 4])

Rashë me fjetë të gjithë po flenë
pos frigës
ajo depérton përmes territ të natës
rri galuc e kercënë si thirmat
dalun nga humnera
e ngjitet në gojët e turmave

friga ajo vjen në mendjen time
si lajm gazete që dëshmon nji hata
dridhet unë gëras

friga ajo braktisë turmat
e tremun nga talismanët hajmalitë tamtamet vjen tek unë si tug
tek secili i vetmuem

m'doket te krejt kundërshtarët
e luftës ndjehet e sigurt dhe gjallë

ka udhëtu që nga vëndet e lirive
n'atdhe friga ka braktisë azganët
bjerrakohës âsht strehu në mue

me gjasë te krejt të arsyeshemit
në botë

prek zemrén nëse më rräh hala
s'e gjâj ajo ka lëviz tashmâ
nga friga âsht bâ njâ me mendjën

e padokshme fluide shtrigane
e përdhunë
banon në kurmin e njerit
që ka frigë budallakun

ajo i nxjerr sytë e mi jashtë t'skuqun
si dy gaca me pa se si turret
shpir i turmatë pa dëshmi
pa mëshirë pa ândrra
pos besimit në marrëzinë
e nji Mesiah a shefi politik
që u ka premtu me u heq frigën

përmes zjarrit i flet botës
për fundin e saj

digje digje dritën që ka mbetur

tashmâ nata po afrohet
kam frigë
ajo ka lânë shumë terr
në mendjen time dhe myk dhe byk

mbetje sharre që prenë të vërtetat
e ksobotshme

due me kânë ândërr fërkoj sytë
leshnat shkuli me provu a jam gjallë
çuet jam e turmat cirren
u bien trumpetave

ndjej se më dhëm
në nji gjendje ferku t'zgjatun

friga se liria munet me u humb
nga injoranca
jo nga nji anmik i mnerë
t'bân t'përvuejtun

lë terr mas në sferat subkoshiente
për shumë breza
na ngrysë tue na bâ njerëz prej terri

E s'e shohim luftën
tue ulurue

Tue agu 29 maji, 2023: 03:30 h

KUR DIGJESHIN LIBRAT

E kisha dikur nji përbledhje tuejen me poezi
"Frymë varresh në dallgore"
ma dogjën milicia serbiane
shkruen lexuesi Isuf Sadriu
nga Besiana

Farën e luftës si gacë e kanë bajtë në kaçep
Zogjt e Stimfalit
Personazhet digjeshin
metaforikisht si drujtë e malit
e avullojshin si tamli n'kusi
tropet piqueshin si mish në zgarë
metonimitë shkrumoheshin
si zemra nanash mas nji fushëbeteje

I tregova se si librat i kam murue
më 1999
pa ditun thminë ku me i strehue

për fat e kisha t'ruejtn kopjen e fundit nga botimi i vitit 1988
i thash se due me ia falë!

po nuk ruejti dhimtat nga flakët
frymë deket po nuk pat
pse shkruhet poezia?

Libri âsht lëkurë e rjepun lexuesish
Atyne u takon!

BUZËPRAMJE N'BREG LIQENI

Natyra âsht art misterioz
pambarueshëm e ndryshon vetën, tue ngjallë adhurim.

Estetikë e frikë!

tue soditë rrafshin e nji kodre metafizike që lundron
pa u zhytë në ujë
erdha në përfundumin logjik
se dritën e ka gdhend uji
tue u nxjerr thelbin shkambijvet
për me dalë nga terri absolut
dhe i paanë e për me kriju sipërfaqë reflektese

ose tue u fërkë grimcat e territ për miliarda vjetë
në kujtesën e ujit ka shkrepun nji shkëndijë!?

Isha ai greku antik që leu dorën
më absidian të lëmuet
apo ai personazhi i Marquez
që mas tre ditëve u tha atyne
t'sh'pisë se e kish gjellitë balena
dhe e kish vjellë në breg

terri bjente mbi liqe

tek tjerrsha mendimet nga syprina e ujit doli nji peshk i madh hata
përpjua pamjet dhe fjalët gazmore
të peshkatarëve

Shikova në retrovizor të veturës
nuk isha askund!

Liqeni i Badocit, 9 qërshor, 2023. Ora 19.

NDËR TË ZANUNIT ROB LUFTE QILLOI EDHE NEMENCI TASIM

Milicia serbiane na urdhnoi
me brimë me ra n'guj
para kâmvet tyne

Në mesin tonë u kenë edhe Tasimi shurdhenëm
met n'kamë hutue derisa oficeri
nisi me gjue me revolver drejt tina

I rrođhi nji vijë e hollë gjaku n'ballë
po hala rrinte n'kamë. E fshiu gjakun me mängë mitani masanej foli.
Po e digjova, ai foli.
- Jam shurdhenëm, i lirë - tha
tue buzqeshun e ra mbi ne
që ishim shtrue përdhë
i lumtun që foli! Ra me fjetë.
Tasimi që s'kish folë kurrë
Për 75-vjet jetë.

DRITHËRIMË



Alma ZENELLARI

Ku t'i gjej fjalët të përshkruaj ashtu si duhet, magjinë e atij çasti, atij takimi midis dy njerëzve që dinë të dashurojnë bukur edhe kur mes tyre ekzistojnë kufij tokësorë, dhe vetëm dashuritë e mëdha dinë t'i bëjnë këta kufij, inkzistentë?..

Ku t'i gjej?.. E nëse i gjej, a do të më mjaftojnë ndonjëherë?..

*
Autobuzi rrëshqiti butë mbi asfalt drejt stacionit të fundit. Përballë saj shtrihej peizazhi i një qyteti të ri, plot èndrra. Diku atje në qendër të atij qyteti, kishte buisur edhe èndrra e saj e cila tanë kishte shpresën e madhe, të lulëzonte me tërë gjelbërimin e vet.

Irida kish ngjeshur ftyrën mbi xham dhe sytë i mbante në prite diku në një sfond të papercaktuar, në prite përt ta dalluar pamjen e Gjergjit që nga larg. Kishë ankth, padurim, emocion. Me gishtat e gjatë prekte xhamin, herë herë duke pëshpëritur pa zë, "ku je, Gjergji?..."

Sa herë ishte nisur drejt tij, sa herë ishte kthyer. Këtë herë, ajo kish guxuar të vraponte drejt tij pa frikë, pa kthim. E ndjente se ai do të ishte aty mes njerëzve duke e pritur. Më në fund autobusi ndali rrugëtimin. E veshur me emocion të ri, me dëshirë të pazakontë, zbriti shkallët, hodhi sytë me drujitje, andej nga duhej të ishte dhei ai.

"Gjergj, ku je?.."- foli sërisht brenda vetes me sytë nga pamja përreth.

Diku e dalloj, buzëqeshi e lumturuar. E priti krahëhapur, e përmallur. Zemra i rahu fort si një zog i hutuar, i frikësuar, që shpupur krahët dhe shpirtin brenda folesë së vet. Drejt saj vinte ai, me hapin e sigurt të burrit, disi të shpejtuar përt ta arritur. Irida iu hodh në qafë si një fëmijë e përkëdhelur ose së thoshte Gjergji, si perëndeshë e lazduar.

I vari krahët në qafë duke i kërkuar vështrimin e kthjellët syve të jeshilët, atyre syve të dashur, të shtrenjtë, shikimi i të cilëve e kishte ndjekur dhe mbrojtur në mënyrë të padukshme edhe përtë kufijve.

I kërkoi sytë përt t'i preku shpirtin. Me drithërimë i preku butë ftyrën me gishta, duke kapërdirë mallin e pamatë. Uli kryet prej pëllumbeshe, mbështeti ballin në mjekrën e tij duke fshehur me kujdes lotët e rënduar nga mungesa e gjatë, e cila shpesh i dukej e pafundme.

Ai ishte aty para saj, shtatlartë dhe i bukur. Prezenca e tij i gjallëroi shpirtin dhe ajo dikur gjeti fjalët përt ta thirrur në emër dashurinë e munguar, mohuar në mënyrën më të dhimbshme, më të padrejtë, larg asaj toke që zhuritej nën flakë. Gjergji i saj, èndrra e saj e vetrme, frymoi përt vite me radhë, prej kohësh

mushkërive, zemrës së copëtar dhe pse larg syve të njeri-tjetrit.

Kishte raste që kaplohej nga frika, trishtimi se bisedat e shpeshta me Gjergjin, do të mbeteshin thjesht biseda, të cilat një ditë do ta humbitnin peshën e çdo gjëje, peshën e atyre gjëratë mbushur me detaje, intimitete, mbushur me shpresën e kthimit, shpresë që s'duhej humbur përsnjë motiv, biseda këto, rrëfyerthënë në mirebesim.

Ndërsa tani ndodheshin përballë, shumë pranë njeri-tjetrit.

Dy qiej ishin bërë një i vetëm.

Kufijtë e tejskajshëm ishin tretur. Kishin humbur a kishin mbetur pas, ç'rëndësi kishte...

Rëndësi kishte ajo orë, ai çast, ai vend, ajo trokitje. Ndodhej para tij e ndrojtur, e brishtë, ledhatare, si një orkide delikate, si një flad i butë, i ngrohtë i ardhur enkas përt tij. Si një dallëndyshe, që kish migruar pak ditë nga vendi i vet, përt të prekur një tokë të re, një qill të ri që do të përndizej sërisht nga duart e tij.

*

Jashtë, mbrëmja kish nisur të binte e butë, të përthyhej e paqtë mes hapësirës së dhomës së tyre. Hëna sillej mbi qytet si një topth i piktuar, diku dhe yjet kishin nisur të feksnit. Dritat shkëlqenin ndryshe a ndoshta u bëhej ashta.

Breda, në hapësirën e dhomës ndihej një ajër i mbushur, i tejngopur emocionesh, ndjesish.

Pas ecejakesh të ngathëta, u gjendën përballë njeri-tjetrit. Gjergji ndali hapin para saj, e tërhoqi lehtë, kujdesshëm pranë vetes, sikur prekte puhinë. Qëndroi ashti i ndrojtur, pa fjalë si një djalosh i ri, por tani më i përbajtshëm, më i kujdesshëm.

Atë çast, Irida ngriti sytë e kaftë drejt tij, i rrëshqiti kujdesshëm mbi portretin e heroit të saj dhe diku thellë, ndjeu trokitjen e një shpirti të braktisur, të lodhur nga pritja e gjatë rraskapitëse.

I ndjeu lotin që derdhej pakuptuar brenda qepallave, brenda guaskës së atyre syve që herë herë rindizeshin nga një flakë e re, e ndritshme.

Nuk ngurroi ta putn në cep të buzëve. Dëshira i diktonte të shkronte më përtëjtë, t'i puthte çdo centim, çdo pore të atyre buzëve, zjarri i të cilave kish filluar t'i kujtonte ekzistencën.

I preku flokët, një kaçurrel rebel të ngritur bukur, që kish filluar t'i zbardhej. E përkëdheli lehtë, i preku ballin e djersë shënuar nga disa rrudha të zbehta, të shkëputura diku në mes. Ftyrën e zeshkët ia përkoi disa herë me gishta ngadalë, në heshtje sikur pikuronte atje, zemrën e vet, ashtu qëtësish pa guxuar ta prish atë çast solemn, po aq të brishtë.

Pas një çasti guxoi t'i futej në kraharon. Priti. Dy duar e shtrënguan me drithërimë.

"Sa kohë, sa vite, mungesë, prite dëshpëuese deri në kufijtë e një lodhje vrastare e kishin larguar prej Gjergjis të saj. Aq sa netëve pa ia diktuar atij gjatë bisedave, mbyllte sytë duke qarë me dënesë, duke mërmëritur, "do vdes pa të të parë, Gjergj".

Pastaj i drejtës zotit, "o zot, më lër një çast të vetëm ta prek, pastaj le të mos jem."

Netëve shpresa i vdiste, ditëve ai ia ringjallte sërisht prej së largu si një diell që ngritet horizontit dhe ngroh, e sheh që larg si një sy i zjarrët, gjigant.

Tani ishte aty, me 'të. I ndjente frymëmarrjen.

I pëshpëriti supeve duke e shtrënguar :

- Gjergj, Gjergji im, të preka. Të preka, zemrë. Jam e lumtur.

- Dhe unë më në fund... - dëgjoi përmes flokëve, zérin e tij.

- Vërtet? - ngriti kokën dhe e pyeti.

- Po!.

Mbështeti sërisht kryet mbi kraharonin e tij të gjerë. Si në èndrrë vazhdoi t'i diktonte fjalët e pathëna. "Sa shumë, sa shumë më ka marrë malli përt tij."

Ndërpren fjalët, e pa në sy dhe meraku i saj e pyeti, - po përsë më duket se je tretur?!

Përgjatë flokëve ndjente dorën e dëshiruar të burrit që dashuronte, ndjente prekjen e duarve përgjatë trupit, ndjente forcën e dashurisë së tij të madhe të cilën helmi, hidhërimi i një lufte të gjatë, tinëzare, të padrejtë, nuk e kishte mbetur dot, s'kishte mundur ta asgjësonë kurssesi.

Kjo i jepte siguri. Duart e fortë të Gjergjis që lëviznin kujdeshëm mbi trupin delikat të Iridës, kishin filluar të zhdukni që dilenë, që enigmë, që larg-ikje, që prite. Ato duar kishin filluar në mënyrë të padukshme të zërthenin kodin e fshehtë, "TI MË PËRKET"

Sy mbyllur i kërkoi duart, trupin, lëkurën, aromën, parajsën.

Dhe ai po ashtu.

E putni gjatë mbi buzë, ndjeu lëvizjen e beftë të gjakut. Putni gjatë dy bozhuret e saj të përflekura. Heshti mbi to si të thithë energjinë e munguar, si të mbushtë mushkëritë me ajër të ri, të ngrohtë.

Heshti mbi sytë e saj të përlotur duke dashur të kuptojë shpirtin e gruas që kishte pranë, zemrën që regëtintë.

- Kisha frikë Gjergj, - foli zë-ulët Irida, gati si një pëshpërimë mbi sytë e tij, - frikë se nuk do të shihja kurrë më... Madje nuk e besoja se do më prisje këtu, në stacion.

Ai e shkëputi nga vetja, i preku mjekrën, i putni lotin që ra faqeve, duke i folur bindshëm.

- Kushdo që do të më thërriste sot, nuk do të kisha shkuar. Nuk do të kisha shkuar askund, përsnjë arsyë në botë. Por përt tij, po ...

Gruaja e bukur buzëqeshi mbështjellë në krahët e tij. Qau dhe e putni. Ishte e sigurt se edhe zemra e tij ish trazuar nga emocioni, nga lotët, por forca e burrit i kish gjelltitur. E putni pandalur si ai.

*
Fjalët heshtën, humbën, diku u strukturën në një qoshe të dhomës. U tretën, u bënë të parëndësishme. Ajri mbi pezull midis tyre. Malli u shpërbë në mes. Duart që preknin si lira e trazuar e Orfeut, zgjonin mbi poret e lëkurës së saj, një melodi të pakënduar. Ca tinguj të beftë, të këputur, delikatë treteshin ajrit. Ajo kish mbyllur sytë, e dehur, e parfumuar nga lumturia.

Klithëtë ëmbël, si klithma e një zogu që

hap e mbyll krahët mbi detin e tij, mbi qellin e tij të pamatë. Dhe ky det dhe ky qell kishte emrin e tij, "GJERGJ".

Diku hapej një lëndinë yjesh dhe ajo vraponte të prekte yllin e saj. Ai ishte aty i prekshëm, i magjishëm, fërgëllues.

E èndrrët, i puthte kraharonin, mbi të cilin duke se shihi hieroglifët e përflekura, të përgjakura të Kosovës së tij. U mbështet aty. Aty, tek ai ishte magjia e saj dhe kjo e drithëronte. Të dy brenda një çasti, u përhumbën në një oazë lumturie, një oazë i paqtë, mbështjellë nga një aureolë drite e bardhë qumësh-tore, që sapo kishte nisur të përndritej, të merrte formë.

Ndjente diku një dallgë plot zhurmë që rritje, ngrëhej drejt një skaji të padukshëm e sërisht zbriste duke e kthyer në tokën e tij. Ai ishte shkëmbi, toka, ajri dhe qelli i saj i pamatë.

Ky ishte veçse fillimi. Zbratzëtia e ekzistencës së tyre kish filluar të mbushtet me jetë.

*
Në mëngjes kur u zgjua, ajo pa qellin e Prishtinës që përndritej, dhe për herë të parë i duk i bukur, i kthjellët.

Një tingull mesazhi e largoi nga dritarja.

"Mirëmëngjesi engjëllushe. Jam duke të pritur, zbit!..

U vesh me shpejtësi. Një tualet i thjeshtë, një shkëlqyes buzësh, kaq i mjaftonte përt të rendur drejt tij. Lu afroa e ngazëlyer, e dashuruar, e gjallë. I buzëqeshi në ecje dhe ai shihe në atë buzëqeshje, gruan e re, të paqtë me veten, të dëshiruar prej tij. Sytë e tij e prisni me tjetër shkëlqim, me një tjetër përndritje. Pas një kohe kaq të gjatë, të dy ndiheshin të përtërirë. Gjithçka kishte mbetur krahëve, orët, ditët, lotët, zënkat, plane, dëshira të thëna të parealizuara, të papërmëbushura.

Tani qđ gjë po merrte trajtë, formë, hapësirë. Koha ishte tjetër kohë dhe ajo i ishte mirënjohëse fatit. E shihe me adhurim burrin që kishte në krahë, i gëzohej pamjes, fjalëve të shqiptuara kujdeshëm prej tij edhe gjatë orëve që kaluan mes miqsh.

Në tryezën e përbashkët, kur ai fliste, Irida e dëgjonte, e ndiqte me sy, me adhurim. Diku në cep të buzëve, në skaj të qerpikëve të tij, kish kuptuar se i endej lumturia, një lumturia e re, që mbante emrin e saj. Besonte me shpirt se ishte ajo, lumturia e tij.

Në heshtje iu kujtuan fjalët e Gjergjis kohë më parë, kur ai e kish lënë me dhimbje përtëj kufirit shqiptar, me zemrë të copëtar, "ti je Helena ime, Troja ime dhe përt të dashur ty, më duhet të vras dhe demonin e fundit."

Dhe ai e kishte vrarë atë demon, djallin shekullor e kish djegur më në fund.

Shpirti i saj e vështronët e qetë, e thërriste pa zë, brenda gjakut të saj.

"Je i gjallë shpirti im, i mençuri im. Ti je heroi im, luftëtar, kosovari im i shtrenjtë."

*
Nën qellin e Prishtinës të buzëqeshat, dëgjova zérin tënd që tingllonte shpirtit tim, melodi. Eca me ty, preka çastin e paprekur në një ditë qershori. Lu afrova butë butë magjisë tënde, èndrruar prej kohësh, si një zanë që hesht, pret përgjon frysëmarrje. Ti ishe frysëmarrje.

Të preka, u mbusha me jetë nga Ti. Nëse një ditë do të më pyesin përsë e do kaq shumë Kosovë, zemra ime do të donte t'u rrëfente e lumtur, sepse aty je ti, nën qellin e saj, jeton ti, ecën, flet, èndrron. Gjithë jetë jeta jote rrjedh, pulson nën atë qell, gjallon, përndritet nën diellin e Prishtinës.

Shkrimtarë të shquar

BABEL DHE "KALORËSIA E KUQE"

Teki Dërvishi ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm me përkthimin e tij, (i vetmi gjer më sot në gjuhën shqipe sa e di) ku hyjnë novelat e tregimet e famshme si: "Kripa", "Letra", "Mbreti", "Vdekja e Dollgushevit", etj

Bujar MEHOLLI


Isaac Babel është njëri ndër prozatorët më të mëdhenj hebrejn. Lindi në qytetin e vjetër të Odesës. I shquar si shkrimtar, dramaturg, përkthyes letrar e gazetar. Shtëpia botuese, ikonike, "Rilindja" u përkujdes që t'i sjellë lexuesve shqiptarë gjithë veprën e autorit ku përfshihen tregimet nga "Kalorësia e kuqe", "Tregime nga Odesa" dhe "Tregime të tjera", nën përkthimin e intelektualit të shquar Teki Dërvishi, viti 1986. Babel është ndër stilistët më të mëdhenj të shekullit XX. Mjeshtër i prozës së shkurtër në të cilën trajton tema nga lufta polako-sovjetike ku ai kishte rolin e gazetarit dhe orvatej ta demaskonte realitetin e hidhur gjatë konfliktit. Temët jetër me peshë të madhe në prozën e tij është antisemitizmi. Gjithherë në rritje, stereotipizimi i çifutit mori përmasa të mëdha deri te trajtimi më mizor në historinë e njerëzimit.

I guximshëm për t'i tejkaluar konditata e ngushta të realizmit socialist, Babeli, u kritikua (Maksim Gorki e kritikoi më vonë për "frymë bodleriane" te drama "Maria") dhe pravate tij u hoqën nga qarkullimi përtu rikthyer tek pas njëzet viteve kur ra regjimi autokratik i Stalinit. Por Babeli nuk shpëtoi. Arrestohet nga NKVD-ja, i akuzuar për terrorizëm dhe spiunazh ekzekutohet.

Në autobiografi, tregon se mësoi gjuhën hebraike, Biblën dhe Talmudin si dhe u

interesua për ta studiuar muziken në një jetë dinamike me vrell të madh përmësim dhe përvetësim të shkathtësive. Në "Shkollën tregtare të Odesës", Babeli pati rastin të mësoi nga M. Vadoni gjuhën frëngje. Kështu leksi klasikët francezë, madje nisi të shkruajë tregime të shkurtra në këtë gjuhë. Në vitin 1915 fillova t'ua dërgoj redaksione tregimet e mia letrare: të gjithë redaktorët më këshillonin që të merrem me tregti e jo me letërsi, por unë nuk e dëgjoja këshillën e tyre, kështu që kah fundi i vitit 1916 ia dola të takohem me Maksim Gorkin. Këtij takimi çdo sukses i imi i mbetet borxh. Ai i pari ma batoi një novelë në numrin e muajit nëntor të revistës "Letopis". Kam punuar edhe si reporter në Petrograd dhe në Tbilis, isha ekspeditor në shtypshkronjën numër shtatë të Odesës, dhe vetëm në vitin 1923, mësova t'i shpreshë mendimet e mia qartë dhe pa zvarritje të tepruar", rrëfen ai.


Teki Dërvishi ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm me përkthimin e tij, (i vetmi gjer më sot në gjuhën shqipe sa e di) ku hyjnë novelat e tregimet e famshme si: "Kripa", "Letra", "Mbreti", "Vdekja e Dollgushevit" etj. "Rilindja" është, padyshim, institucioni më i madh, titan, i kulturës mbarëshqiptare me përkthime të panumërtë, dhe shumë cilësore, me objektivin e madh: njohjen e lexuesit shqiptar me penat e mëdha botërore që ndryshuan botën me artin e tyre të përjetshëm.



Shkrimtarë përfëmijë

REXHEP HOXHA, AUTRO I VARGJEVE TË LËMUETA

Kujtesa poetike e Rexhep Hoxhës ishte një produkt interesant që duhet studiuar për specifikën e saj



Xhahid BUSHATI

Rexhep Hoxha, shkrimtar nga Kosova, ndërrroi jetë në moshën 90-vjeçare (1929 - 12.07.2019). Ai ishte shkrimtar më i moshuar i Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Po t'i kërkojmë rrënjet dhe fillet e tij letrare, do të thonim se Hoxha i takon brezit të parë të shkrimtarëve shqiptarë në Kosovë, me një herë pas Luftës së Dytë Botërore.

Shkrimtar Rexhep Hoxha e batoi librin e parë me vjersha "Gjethet e reja",

70-vjet më parë. Në librat që shkroi më pas, si edhe tek poemat, si edhe tek fabulat; solli përherë "gjelbërim" poetik në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj. Erdhi me një profil të veçantë. Shquhej për një gëzim të brendshëm krijimi i tij, të cilin e ruajti kurdoherë të tillë në të gjitha botimet e mëvonshme. Në udhëtimin e këtij gëzimi dhe këngëzimi, rrezet e diellit të poetëve të Rilindjes ia shndritnin here pas here vjershat, por pa i cenuar personalitetin artistik. Me kohën lidhi një pakt që, gjithashtu nuk e ndry-

shoi. Ai ishte: Rrëfimi i natyrshëm, pa sforço e i dinjitetshëm i lirizmit poetik. Po ashtu edhe hapësirat e Attheut gjetën rrëfimin e poetit, ku folën trimat, plagët, dhimbjet, dashuritë, èndrrat, amanetet, ... Këto tematika mbeten piketat kryesore, pa të cilat nuk mund të kuptohet poetika e tij. Ndaj, kujtesa poetike e Rexhep Hoxhës ishte një produkt interesant që duhet studiuar për specifikën e saj.

Njohu për së mbari botën e psikologjinë e fëmijës dhe elementet edukative të kësaj moshe. Jo më kot, vjershat në palcët e tyre kanë: kureshti, lojë, humor, fjalë pafund onomatopeike, lirizëm, gurre folklori, etj. Përdorimi i atyre emërtave që po i përmend, që nuk janë gjë tjetër veçse kodet e përkdhelive të botës fëmijërore dhe domethëniet e zemrës së poetit, si: Picimuli, Mbi krahët e fluturës, Pika vese, Lulëzo vendi im, Micimiri, Piperku, Zogu i qillit, etj. Në lidhje me veçoritë e krijimtarisë poetike të Hoxhës, paraqesin interes edhe dy shayrtime, nga ana e studiuesit Ramazan Çadri dhe e shkrimtarit Anton Pashku. Ramazan Çadri shprehet: "... vjershat e R. Hoxhës fitojnë gjallërinë dhe freskinë e nevojshme poetike në sajë të konkretësisë së rrëfimit e përshkrimit të dukurisë a ngjarjes në frymën e këngëve popullore, tek të cilat ai u mbështet për të marrë më shumë sesa motivet, thjeshtësinë e të shprehurit, mënyrën gazmore të të rrëfyerit, karakterin lodrues të veprimit si dhe muzikalitetin e ritmit të tyre." Kurse Anton Pashku e cilëson magjinë e

poetit në këtë mënyrë: "Kudo nëpër poezitë e tij gjemjë vargje të lëmueta, tinguj që kumbojnë freskët, vjersha që në vjetvete kanë ritëm të mrekullueshëm e humor jashtëzakonisht të qëlluar."

Prozatori Rexhep Hoxha është autor edhe i romaneve "Lugjet e Verdha" (1959), "Verorja" (1984), "Ermali" (2000). Këto tre romane, më shumë i pari dhe i dyti, më pak i treti, kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe krijuesve, të cilët here pas here në kohë kanë dhënë mendimet e tyre. Mendoj që marrëdhënie e tyre (studiuesve) lidhur me sagën romaneske të Rexhep Hoxhës, duhet grupuar në këtë mënyrë: - autorë që janë ndalur tek përbajtja (subjekti) e librit dhe e kanë rrëfyer atë shpesht intësish, - autorë që tentuan të hynin në tipologjinë e romaneve të autorit, - autorë, - dhe kjo me vlerë, - që këndvështruan statusin e romaneve të Hoxhës, si veçori bindëse.

Me botimet e tij letrare, shkrimtari i talentuar Rexhep Hoxha i dha vertikaltet Letërsisë shqipe përfëmijë e të rinj. Romani i tij "Lugjet e Verdha" ishte një befasisim për kohën, kur u shkrua. Vlerat që mbarte vepra kapërcyen kohën e botimit. Edhe sot mbetet një vepër e frymëzuar dhe e shkruar nga një dorë mjeshtri. "Lugjet e Verdha" zgjoi dhe interesin e studiuesve dhe kritikëve, të cilët e bënë objekt shqyrtimi.

(Shkodër, maj, 2023)

"LETRA BORGESIT"



Grigor JOVANI

Kur kishte mbushur 83 vjet, në tetor të vitit 1982, Horhe Luis Borges, i cili ishte i verbër qysh 30 vite përpara, mblodhi 60 miq në Nju Jork për një party ditëlindjeje.

Shkrimtarja dhe mikja e tij e afërt, Suzan Santog, ishte e pranishme.

E intervistuar pak më vonë për këtë festë miqsh të Borgesit, ajo tha: "Nuk ekziston shkrimtar që rrон sot, i cili të jetë kaq i rëndësishëm për shkrimtarët e tjere, se sa Borgesi. Shumë njerëz do të pohonin që është shkrimtarë më i madh në të gjallë. Shumë pak shkrimtarë sot nuk kanë mësuar prej tij ose nuk e kanë imituar..."

Horhe Luis Borges u nda nga jetë katër vjet më vonë.

Dhjetë vjet pas vdekjes së tij, Santog iu kthye veprës gjeniale të shkrimtarit dhe trashëgimisë kulturore dhe artistike që ai la pas, me një ese të mrekullueshme, të titulluar "Letra Borgesit". Kjo ese, e cila bëri bujë në botën letarë të kohës, u shkruajt më 13 qershori 1966 dhe u përfshi më 2001 në librin e shkëlqyer me ese të shkrimtares, "Where the Stress Falls" (Atje ku bie stresi).

Disa pasazhe, nga eseja-letër, dërguar (pas vdekjes) Borgesit:

1. "Ishim produkt i epokës suaj, i kulturës suaj, por ju e dinjt si të tejkalonit kohën tuaj, kulturën tuaj, me një mënyrë që ngjan krejt magjike. Kjo kishte të bënte me çiltërsinë dhe bujarinë e vëmendjes suaj. I dashur Horhe, ishe shkrimtarë më pak egocentrik, më i tejdukshmi, si edhe më i talentuar. Kishte gjithashtu të bënte edhe pastërtia e natyrshme e shpirtit tënd."

2. "Kishe një ndjeshmëri të kohës, që nuk e kishin njerëz të tjerë. Idetë e zakonshme të së shkuarës, të sotmes dhe të ardhmes duke shumë para vështrimit tënd. Të pëlgente të thoje se çdo çast i kohës përmban të shkuarën dhe të ardhmen, duke cituar (me sa mbaj mend) poetin Browning, i cili shkruajti se "e sotmja është çasti kur e ardhma përmbyset tek e shkuara..." Kjo, natyrisht, ishte pjesë e modestisë tënd: shija jote për gjetjen e ideve të tua tek idetë e shkrimtarëve të tjerë."

3. "Një shkrimtar - dhe besoj gjithë të tjerët - duhet të besojë se çdo gjë që i ngjet është një burim. Të gjitha gjërat na janë dhënë për një qëllim dhe një shkrimtar duhet ta ndjejë këtë më ndjeshëm. Gjithçka na ndodh, duke përfshirë këtu edhe poshtërimet që na bëhen, edhe dëshimetona, të gjitha na jepen si lëndë parë, si brumë, me të cilin do të mbrujmë artin tonë."

Dhimitris Angelis

DJE

Dje u gjenda në një hënë dhe fillova ta unë dhe macet e mia.

Dje kërkoja shtëpinë brenda fërmijës, por ishte fshehur në dollapin e kujtimeve.

Dje vura në frigorifer i hutuar elektrikun e dorës, nuk kishte më shteg të ndriçoja as laps numër 11 të shkruaja.

Dje lexoja buzët e tua teksha më bëje kafe në një qytet të largët dhe kalendari në mur tregonte 13 mars, ndërsa këtu është tashmë dhjetor.

Për fat të mirë dje nuk vdiqa, dje dashuroja.

II.

ATË PASDITE

Kjo poezi përmban:

një plazh dimri me pulëbardhë
një pernë që fotografova para se të vije
dritat e krishtlindjeve në shtëpinë tënde

dy njerëz që ecin shkujdesur në rrugë
(këndej nuk dallohen plagët e çdokujt,
moshat, emrat, hiri)

Tani poezia është ngarkuar:

këpucët tona janë mbushur me rërë (ose pluhur hënë)
shohim në det vende ku nuk do të na shohim bashkë
ndoshta dëgjohen të qeshura - nuk kam vdekur ende
ndoshta dëgjohen zëra - shumë lehtë do të më harrosh

Më thua se nuk bleve sivjet pemë për Krishtlindje,

në vend të permës zbukurove dy drurë deti

në perëndim dielli djeg një qytetërim,
peizazhi turbullohet përséri
vjen çasti kur futemi në makina
përhëndetemi formalistë dhe humbe-
mi

Fjalët në të cilat ecën atë pasdite
ishin peizazhe, dete, shkretëtira
ishin premtimi që nuk gdhimë
prandaj askush nuk kujtohet të na ketë
parë
atë pasdite
bashkë

III.

NJERIU ME VALIXHE

Mendo edhe mua, tha, në këto peizazhe
të verdha
në këto kantiere të ndryshkura, në fabri-
kat e shkreta
që u bënë fole lejlekësh dhe makinash të
vjetra

Mendo edhe mua pranë dordolecëve me
zile,
të njëjtat fantazma - lebrozësh - sa
mund të duroj
mendo dhe atë kalë që erdhë në ballko-
nin tonë dje në mëngjes
dhe na trokiti në derë, njeriu
me pizhamet lejla që priste na stacion
dhe na fali një bukë,
mendo koshore

Mendo edhe mua, tha, pas çarçafëve të
bardhë që vari dikush
në një litar të kapur në trarët e një porte
futbolli të sajuar në kopshët,
mendo edhe mua
përballë kësaj buke të mjaftueshme
përse lutem

IV.

Shkruaj, vesë mëngjesi, duke u larguar,

ata që do të vdesin sot

dhe mes tyre shto edhe këtë tym sakri-
fice që hidhet përpjjetë para meje
është nga vargjet që nuk shkrova dhe u
mbyt para kohe në kafenë time
është nga vargjet që nuk deshe as sot të
lexoje me mua, Maria.

Shkruaj, vesë mëngjesi, dhe shqetësimin
e Maries teksha pret autobusin në shi

dhe autobusi rënduar me frymë
njerëzore vonon,
bën ftotë dhe ka dy fatura në çantë për
të paguar

një makinë e kuqe kalon pranë, dikush e
thërrët brenda
dhe ajo zhduket për njëzet vitet e
ardhshme.

Shkruaj edhe për atë frikën time të
përditshme mos humbet përgjithmonë
Maria

në një vend pa shi, një mëngjes pa
vargje.

V.

Premtimet e vetme të demokracisë janë
bankat.

Vendimet e vetme të qeverisë janë për
armët.

Dhe ti vjen një të shtunë të gabuar të më
takosh
duke mbajtur rubla për të paguar pijet
tona

dhe duke recitar vargje nga Majakovski.

Sonte, nata e Vinit të Ri me ty
nuk është festë në shesh. Janë bankat
që na mbytin dhe një trup - barrikadë.
Është buka e mykur e Akhmatovës.
Është ai dre i bardhë që përlotet
në shtratin tim.

(Përktheu Alma BRAJA)



Dhimitris Angelis u lind në Athinë (1973). Poet dhe eseist, ai është redaktor i revistës Frear. Ka botuar tetë përbledhje me poezi, ese, studime dhe tregime. Është nderuar me çimin Lambros Porfiras të Akademisë së Athinës për përbledhjen e tij poetike "Përvjetor", me çimin e përkthimit të Fondacionit Corda, me një çimim shtetëror për poezinë për përbledhjen e tij poetike "Një dre përlotet në shtratin tim" dhe me çimin Makis Lahanas, për veprën e tij të përgjithshme. Librat e tij "Aniversario" ("Përvjetor"), "Siempre llueve en la cabeza del perro" ("Gjithnjë bie shi mbi kokën e qenit") dhe antologjia e tij me poezi "Si fuera tu noche" ("Nëse do t'isha nata jote"), janë botuar në spanjisht. Ka shërbyer si kryetar i Rrethit të Poetëve dhe drejtës i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë në Athinë.

DUARTROKET OSE FISHKËLLEN RASTËSISHT



Në shumicën e rasteve, artisti ka turp nga vetvetja dhe privilegjet e tij, nëse ka të tillë. Përparrë së gjithash, atij i duhet t'i përgjigjet pyetjes që shtrohet: a është arti një luks gjenjeshtar? Përgjigja e parë e ndershme, që mund të jetet, është kjo: në fakt, ndodh që arti të jetë një luks gjenjeshtar. Ne dimë se në urën e galerave, gjithmonë e kudo, mund t'i këndohet yjësive, ndërkokë që të dënuarit me punë të detyrueshme vozisin dhe lodhen në hambarin e anijes; mund edhe të regjistrohet biseda mondanë që vazhdon në shkallët e cirkut, ndërkokë që viktima jep shpirt në gojnë e luanit. Dhe është e vështirë ta kundërshtosh këtë art, i cili në të shkuarëna ka njohur arritje të mëdha. Një nga akuzat që mund të ngresh kundër tij, është se gjërat kanë ndryshuar paksa dhe, në veçanti, se numri i të dënuarave me punë të detyruar dhe i martirëve është rritura shumë në sipërfaqen e globit. Përparrë një mjerimi kaq të madh, ky art, nëse dëshiron të jetë një luks, sot duhet të pranojë të jetë gjithashu edhe një gjenjeshter.

Por përfshirë do të fliste ai? Nëse i përshtatet

kërkeseve të shoqërisë sonë, në pjesën më të madhe do të jetë argëtim pa kurrëfarë rëndësie. Nëse e refuzon atë në mënyrë të verbër, nëse artisti vendos të izolohet brenda ëndrrës së tij, ai nuk do të shprehë asnjë tjetër përvëçse një refuzimi. Në këtë mënyrë do të kishim një prodhim argëtueshëm ose gramatikanësh të formës që, në të dyja rastet, ka si rezultat një art të shkëputur nga realiteti i gjallë. Përreth thujse një shkull, ne jetojnë në një shoqëri që nuk është, madje, as edhe shoqëria e parasë (paraja ose ari mund të njallin pasione mërshore), por ajo e simboleve abstrakte të parasë. Shoqëria e tregtarëve mund të përkufizohet si një shoqëri, ku gjërat zhduken në dobi të shenjave. Kur një klasë drejtuese nuk i mat pasuritë e saj, duke u bazuar në sasinë e tokës apo në numrin e shufraive të arta, por në numrin e shifraive që i përkijnë idealisht njëfarë numri operacionesh shkëmbimi, ajo përpinqet në të njëjtën kohë që ta rrethojë përvojën dhe universin e saj me një lloj mistifikimi. Një shoqëri e bazuar te shenjat, në thelbin e saj, është një shoqëri artificiale, ku e vërteta mërshore e

individit është e mistifikuar. Kështu që nuk do të habitemi, kur të shikojmë se kjo shoqëri ka zgjedhur si fë një moral me parime formale dhe sesi ajo i shkruan fjalët liri e barazi si në burgje, ashtu edhe në tempujt e saj financiarë. Por, në të njëjtën kohë, nuk mund të luash me fjalët pa undëshkuar.

Sot vlera më e përgojuar është ajo e lirisë. Disa njerëz të cekët (gjithmonë kam menduar se ka dy lloj mençurish, mençuria e zgjuar dhe zgjuarsia e trashë) kanë nxjerrë doktrinën se ajo nuk është tjetër, veçse një pengesë në rrugën e progresit të vërtetë. Por ka qenë e mundur të thuhen budallallëqe kaq të mëdha, sepse për njëqind vjet shoqëria tregtare e ka përdorur lirinë në mënyrë përashtuese e të njëkanshme, e ka konsideruar atë si një të drejtë e jo si detyrrë, dhe nuk ka pasur frikë të vendoste një liri në parim në shërbim të një shtypjeje që mbretëronte në të vërtetë. Duke u nisur nga ky fakt, përsë të habitemi nëse kjo shoqëri nuk i ka kërtuar artit të jetë një instrument çlirim, por një ushtrim po pasojat të mëdha dhe një zbavje e thjeshtë. Tërë ajo botë që karakterizohej nga kokëçarjet për shkak të parave, por mbi të gjitha nga taksiratet për shkak të dashurisë, gjatë shume vitesh ishte e kënaqur me shkrimitarët e saj mondanë dhe me artin më po vlerë që mund të ekzistonte, ai përfshirë cilin Oskar Uaildi, duke menduar përfshirë vreten e tij përparrë se të kishte njohur burgun, thoshte se vesi më i keq ishte të qenit i sipërfaqshëm.

Fabrikuesit e artit (ende nuk kam thënë artistët) e Evropës borgjeze, përparrë dëshmi 1900, kanë pranuar në këtë mënyrë papërgjegjshmérinë, pasi parapërgjegjshmëria nënkuptione një shkëputje rraskapitëse nga shoqëria e tyre (ata që janë shkëputur me të vërtetë qusheshin Rembo, Niče, Strinberg dhe të gjithë e dimë shumë mirë çmimin që kanë paguar). Teoria e artit përfshirë arti, që në fakt nuk është tjetër veçse marria përsipër e kësaj papërgjegjshmërie, i përket kësaj epoke. Arti përfshirë art, zbavitja e një artisti të vëtmuar, është me të drejtë arti artificial i një shoqërie të rremë e abstrakte. Kurorëzimi i tij i logjikshëm është arti i salloneve ose arti tërësisht formal, i cili ushqehet me preciozitet e abstraktione dhe që ka si rezultat shkatërrimin e çdo realiteti. Disa vepra, ashtu si dëshmi disa njerëz të mrekullojnë, por në të njëjtën kohë ka edhe shumë shpkikë të ndyra që dëmtojnë shumë të tjera. Si përfundim, arti krijuhet jashtë shoqërisë dhe shkëputur nga rrënjet e saj të gjallë. Pak nga pak, ndonëse në majë të suksesit, artisti është vëtem, ose të paktën njihet nga kombi i tij vëtem me ndërmjetësinë e shtypit të gjerë apo radios, që do të jepin përfshirë idët përshtatshme e të thjeshtuar. Me specializimin e artistit, bëhet i nevojshëm edhe vulgarizimi. Kështu, shumë e shumë njerëz do të kenë përshtypjen se e njohin një artist të caktuar të epokës sonë, megjë kanë mësuar nga gazetat se ai

rrit kanarina ose se nuk martohet asnjëherë përfshirë se gjashtë muaj. Sot të jesh i famshëm do të thotë të admirojnë ose të të urrejnë, pa të lexuar. Çdo artist që do të jetë i famshëm në shoqërinë tonë, duhet të dijë se nuk është ai që do të jetë i tillë, por dikush tjetër me emrin e tij, i cili nuk do të ketë asnjë përbashkët me të dhe ndoshta do të vrasë një ditë brenda tij artistin e vërtetë.

E si është e mundur të habitemi, po të mendojmë se krijimet me vlerë në Evropën tregtare të shekullit nëntëmbëdhjetë e njëzet, për shembull në letërsi, janë ngritur kundër shoqërisë së kohës së tyre! Mund të thuhet se deri pak para Revolucionit francez, letërsia që lëvrohej ishte kryesisht një letërsi miratuese. Duke u nisur nga çasti kur shoqëria borgjeze e dalë nga revolucioni u stabilizu, u zhvillua një letërsi që karakterizohej nga sensi i revoltës. U mohuan në këtë mënyrë vlerat zyrtare, për shembull te ne, qoftë nga mbartësit e vlerave revolutionare, nga romantikët te Remboja, qoftë nga atë që ruanin vlerat aristokratike, nga të cilët mund të përmendim Vinjinë e Balzakun. Në të dy rastet, populli dhe aristokracia, që janë dy burimet e çdo qytetërimi, radhitën kundër shoqërisë së rrreme të kohës së tyre. Por ky refuzim, që me kalimin e kohës u ngurtësuat, u bë i rremë dhe çoi në një lloj tjetër steriliteti. Tema e poetit të mallkuar që lindi në një shoqëri tregtare (Shatertonit është shembulli më i mirë), bëri te vetin një paragjykim, sipas të cilit një artisti i mirë duhet të ngritet gjithmonë kundër shoqërisë së kohës së tij, cilado qoftë ajo. I ligjshëm në origjinën e tij, kur po hohet se një artist i vërtetë nuk mund të bjerë në ujdi me botën e parasë, parimi u bë i rremë kur prej tij nxorën idenë se artisti mund të afirmahej si i tillë vetëm duke qenë kundër gjithçkaje në përgjithësi. Kështu, shumë nga artistëtanë duan të jenë "të mallkuar", i vret ndërgjegjë kur nuk janë të tillë dhe dëshironin në të njëjtën kohë si duartrokjet, ashtu edhe fishkëllimat.

Natyrisht, duke qenë i loddur ose shpëfillës, sot publiku duartrokjet ose fishkëllën rastësish. Intelektuali i kohës sonë nuk pushon së ngurtësuari përfshirë qenë i madh. Por, duke mohuar gjithçka, deri edhe traditën e artit të tij, artistit bashkëkohor i formohet iluzioni se po krijon irregullat e veta dhe arrin deri aty, sa të mendojë se është Zoti. Kështu, ai pandeh se është në gjendje të krijojë realitetin e tij. Por, larg shoqërisë, ai do të krijojë vëtem vepra formale dhe abstrakte, prekëse si përfjetëme, por pa pjellorinë që është karakteristikë e artit të vërtetë, prirja e të cililit është të mbledhë. Si përfundim, ndryshimi ndërmjet stërhollimeve e abstraktioneve bashkëkohore dhe veprës së një Tolstoi ose një Molieri do të jetë po aq i madh, sa edhe ndërmjet tregtisë së shpresuar të një gruri të padukshëm dhe vëtë dherave të prekshëm të hullisë.

Lou REED

SHTËPIA IME

Imazhi i poetit në puhi
Patat kanadeze fluturojnë mbi pemë
Mjegulla butësishët varet mbi liqen
Shtëpia ime është shumë e bukur gjatë natës
Miku dhe mësuesi im zë dhomën e lirë
Ai ka vdekur – në paqe më në fund Çifuti Endacak
Miq të tjerë i kishin vënë gurë varrit të tij
Ai ishte njeriu i parë i madh që kisha takuar ndonjëherë
Silvia dhe unë nxorëm tabelën tonë Ouija
Për të thirrur një shpirt – ai u ngrit në dhomë
Ne ishim të lumtur dhe të mahnitur me atë që pamë
Flakërues qëndronte emri krenar dhe mbretëror Delmore
Delmore, më kanë munguar të gjitha

mënyrat tua qesharake
Më kanë munguar shakatë dhe gjërat e shkëlqyera që ke thënë
Dedalusi im përf Bloomin tënd, ishte një zgjuarsi kaq e përsosur
Dhe të gjëj në shtëpinë time i bën gjërat perfekte
Përnjëmend kam jetë me fat
Shkrimi im, motoçikleta ime dhe gruaja ime
Dhe mbi të gjitha, një frymë e pastër poezie
Po jeton në këtë shtëpi prej guri dhe druri me mua
Imazhi i poetit në puhi
Patat kanadeze fluturojnë mbi pemë
Mjegulla butësishët varet mbi liqen
Shtëpia jonë është shumë e bukur gjatë natës
Përktheu: Fadil Bajraj



MONUMENTET E FUNDIT TË JUGOSLLAVISË

Josip Broz Tito parashikoi një mit të ri të stilit sovjetik për Jugosllavinë - një mit i rrënjosur në utopizmin futurist...



Christopher LINFORTH

Asgjësimi i "spomenikëve" filloi pak më shumë se një dekadë pas vdekjes së Mareshalit Tito në vitin 1980. Presidenti i Jugosllavisë kishte porositur ndërtimin e këtyre monumenteve të epokës së hapësirës pas pushtimit brutal të atdheut të tij nga Boshti. Tito parashikoi një mit të ri të stilit sovjetik për Jugosllavinë - një mit i

rrënjosur në utopizmin futurist. Përqafimi i kësaj estetike, ndoshta të pazakontë për dikë të lindur në fshatin e vogël të Kumrovecit, ndihmoi përpjekjen e tij prej dekadalash për të bashkuar popullin e tij. Duke përdorur parimet brutaliste të dizajnit, arkitektët e Titos përkujtuan të vdekurit e Republikës federale socialiste dhe ata që luftuan pushtimin: ushtrinë e tij partizane.

Përgjatë tridhjetë vjetesh, mijëra prej këtyre "spomenikëve" të mëdhenj të betonit u shfaqën nëpër peizazhin jugosllav. Të ndërtuara shpesh në vende të largëta, në vende beteje ose në vende të heroizmit patriotik, këto monumente i zbehën rrithinat e tyre. Në Republikën Sérpska të sotme, Monumenti i Betejës së Sutjeskës në Tjetishtë ndodhet në një lugine të gjelbër të këndshme, e vizuar herë pas here nga nxënës shkollash dhe alpinistë me fytyrë të mërzitur që kërkojnë të pushtojnë majën e afërt të Snijezhnicas. Krahët e dyfishtë të dhëmbëzuar të këtij "spomeniku", secili rrëth nëntëmbëdhjetë metra i lartë, ngajnjë me një copë gjigande guri gjelqeror të shtruesuar të ndarë në dysh. Brenda fasadës së derdhur të betonit shtrihet një strukturë e padukshme e armaturës në formë kagjeli.

Jo shumë larg në formën tjetër të entitizuar të Bosnjë-Hercegovinës, mbetjet skeletore të një "spomenikut" tjetër ulen në majë të malit Makljen. Monumenti i betejës për të plagosurit (ngan-

jëherë i rjohur si Grushti) përkujton ushtarët partizanë që mbrohin kalimin malor nga trupat e Boshit. Grushti abstrakt i blokuar u ngrit në një lartësi prej katërbëdhjetë metrash dhe u lye me bardhë - një simbol i kundërshtimit kundër pushtimit fashist. Dekada më vonë, në vitin 2000, vandalët vendas i vunë dinaritin "spomenik-ut"; ata shpërtheny predhën e betonit dhe lanë vetëm një platformë me armaturë që digjel.

Në shtëpia e shumë njerëzve, shkëltimi i realizmit socialist utopik të Titos u zbeh në mënyrë dramatike gjatë luftërave jugosllave. Thirja tubuese e një shteti të vetëm silav ndihej e zbratzë, e pakuptimt, me kaq shumë të vdekur. Dhe "spomenikët" ishin një kujtesë e unititetit të rremë të së kaluarës. Në të vërtetë, mendjemadhesia e këtyre monumenteve ishte qartësish e dukshme. Luftërat ringjallën fraksionet historike të Ballkanit - serbët, kroatët, kosovarët, maqedonasit, boshnjakët, slovenët, malazezët - për të ngritur përsëri inatet e së kaluarës dhe spektrin e nacionalizmit të përgjakshëm. Në buzët e qytetarëve të kësaj republike të shpërbërë ishin vendet e vdekjes masive dhe të spastrimit etnik: Batajnica, Vukovari, Bihaçi, Srebrenica.

Gjatë viteve 1990 dhe 2000, qindra "spomenikë" u vandalizuan, ose u shkatërruan, ose u lanë të shkërmogen. Viziton Koshuten, Dërvoran ose Kamenskan për të parë plakat e betonit

të thyer të shpërndara nëpër peizazh. Grafitet shumëngjyrëshe janë e vëtmja shenjë që njerëzit ende i vizitojnë këto zona. Në vende të tjera, disa "spomenikë" janë zëvendësuar me kisha ose monumente të reja që dokumentojnë viktimat e luftërave. Plakat në këto monumente të reja shpesh rishikojnë pakënaqësitë e ish-Jugosllavisë. Trauma e pazgjidhur shfaqet plotësisht.

Vitet e fundit, ka pasur një interes në mbarë botën për "spomenikët" më të famshëm, siç është monumenti i stilizuar me krahë në Podgoricë, një memorial i një rebelimi vendas kundër ustashëve fashist. Njëkohësisht, brenda ish-Jugosllavisë, një dashuri në rritje për republikën mund të shihet në kafe-baret moderne, ekspozitat e artit, madje edhe në televizioni e realitetit. Titostalgjia bazohet në një pamje rozë të dashamirësisë së Titos: endrra e tij futuriste për një Jugosllavi largpamëse dhe të fuqishme. Brezat e rinj kanë filluar të vlerësojnë jetën dhe veprën e tij; ata imaginojnë një epokë të artë të kohërave më të mira dhe kur njerëzit thoshin "vëllazërim dhe bashkim" pa një ndjenjë ironie.

"Spomenikët" flasin për këtë enderrimtarë. Këto monumente të fundit tregojnë rrugën drejt pojtimit: një e ardhme për të gjithë ata. (worldliteraturetoday.org)

(Nga anglishtja Fitim Nuhu)

Mes mitit dhe legjendës

NJË FOTO E RE E RIMBAUD-it?!

Për djaloshin e Charleville-s është thënë gjithçka. Engjell, djall, i mallkuar, përbindësh, gjeni, revolucionar, populist, mistik, fetar



Artur SPANJOLLI

Kaos, rrëmuje dhe dritë në trurin e këtij gjeniu të parakohshëm. Veç 16 vjeçar Rimbaud, pati vërtetë momente kulmore në krijimtari. I parakohshëm, si një meteor i cili ndrin dhe digjet shpejt, ai dha dhe tha gjithçka, në harkun e 3 viteve të adoleshencës. Te personi i tij u mblodh së bashku gjeniu dhe mëkatari, i krisuri dhe vizionari, i zemëruari dhe i paadaptueshmi, homoseksuali dhe reformuesi. Krenar, përcmues dhe mospërfillës, Rimbaud jo vetëm që e kritikoi dhe e urreu hipokrizinë borgjeze parisienë, por ai e shmangu atë që fuqishëm sa shkoi deri në Abisini,

drejt një primitivizmi origjinal, duke ndërruar deri edhe fenë. Më në fund, i lodhur së ecuri, nga Parisi në Brindizi në këmbë, po nga këmbët e tij vdiq së e kishte parashikuar në një poezi. "...Dhe të braktisë këmbët e tij! O mrekulli!" Poezia: Turpi.

Nuk ka asnjë rast tjetër në letërsinë botërore që një poet i mallkuar kaq i ri, të akumulonte aq shumë sintezë letrare dhe të kishte një pjekuri letrare aq të parakohshme. Veç në moshën 19 vjeçare.

Poeti, shkruan Rimbaud, bëhet largpamës veç përmes një rrëmuje të gjatë, të arsyetur dhe totale të ndjenjave.

Produkt i një epoke të turbullt, - luftërat Franko-Prusiane, - Rimbaud shfaqet si një uragan konfuz dha largpamës, poezia e tij është si një magnë gjithmonë në përvëlim, nga llava e të cilit do të dilte dritë e re mendimi. Askush si ai nuk e kërkoi aq ngulshëm të vërtetën në poezi dhe në jetë. Antikonformist i tërbuar,

provokator dhe rebel, ai nëpërkombi, pështyu, talli me sarkazmin e tij të helmet gjithçka mediokre dhe fallce.

Për djaloshin e Charleville-s është thënë gjithçka. Engjell, djall, i mallkuar, përbindësh, gjeni, revolucionar, populist, mistik, fetar, largpamës, blasphem, sodomit, sifilit, morracak, nevrostenik, shenjtor, tregtar armësh, moralist, dashnor i tërbuar, hero, lypës, heretik, vizonar, profet, drogaxhi, i ndriçuar. E kanë dashur dhe urryer pa masë, e kanë ekzaltuar, ofenduar, lartësuar dhe përbaltur pa fund. Ka sa të duash përtë. Prapë ai mbetet një figurë mahnitëse dhe intrigante, për t'uzbuluar magjia e tij shumëkohëshe.

Një foto e re e gjetur kohët e fundit e Arthur Rimbaud-it?!. E njëjtë hundë e hollë, të njëjtët sy enderrimtarë, i njëjtë qëndrimi prej engjelli në mërgim. Ky ishte pra, poeti fëmijë, revolucionari dhe largpamësi i pakrashueshëm, i cili preku skajet e së pamundurës, të mitit dhe të legjendës.

NUMRI I ARDHSHËM MË 5 KORRIK

HEJZA

20 QERSHOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000